



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 DHE 25 QERSHOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. I 25. JUNA 2015. GODINE**

**QERSHOR - JUNI
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për markat tregtare,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
10. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014,
11. Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014,
12. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014,
13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014,
14. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija ministra Spoljnih poslova Republike Kosova, g. Hashim Thaçi, u vezi sa procesom demarkacije granice između Republike Kosova i Republike Crne Gore,
5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o opštem upravnom postupku ,
6. Prvo razmatranje Nacrt zakona o Kosovskoj Akademiji nauka i umetnosti,
7. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakna o patentima,
8. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakna o trgovackim markama,
9. Razmatranje Izveštaja Komisije za zakonodavstvo, mandate, imunitete, Poslovnik Skupštine i nadgledanje Agencije protiv korupcije, o nadgledanju Zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
10. Razmatranje Izveštaja Institucije Narodnog advokata za 2014. godinu,
11. Razmatranje Izveštaja Radio televizije Kosova za 2014. godinu,
12. Razmatranje Izveštaja Kosovske agencije za imovinu, za 2014. godinu,
13. Razmatranje Izveštaja Nezavisne komisije za rudnike i minerale, za 2014. godinu,
14. Razmatranje preporuka Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju u vezi biznijskih sporova i njihovog adresiranja u sudovima.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
I nderuar zëvendëskryeministër dhe Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Urdhëro Donikë, por kemi folur në Kryesi, ku keni qenë edhe ju të pranishëm. Urdhëro!

DONIKA KADA BUJUPI: Për çështjen e interpelancës, për shkak se Grupi Parlamentar i Aleancës do të lirohet për të marrë pjesë në protesta për kthimin sa më të shpejtë të liderit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, në shtëpi, ne kërkojmë që kjo rezolutë, e cila është parashtruar për ministrin e Punëve të Jashtme shumë kohë më parë dhe i cili ka munguar më shumë se dy herë dhe sot po shihet që ka ardhur, sepse zoti Haradinaj nuk është këtu, të shtyhet për seancën e radhës, kur zoti Haradinaj do të jetë këtu si propozues dhe iniciues i kësaj interpelance.

Prandaj, kërkojmë që kjo interpelancë të shtyhet për seancën e radhës për shkak të rrethanave të krijuara dhe mungesës së propozuesit dhe iniciuesit të saj. E kam fjalën për interpelancën lidhur me demarkacionin ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës.

KRYETARI: Zëvendëskryeministri e ka fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Donikë, unë kisha ftuar, se moti kështu s'jemi ballafaquar, të mos e keqpërdorësh mikrofonin dhe rastin e Ramushit, se nuk të ka hije, e para.

Sa i përket ballafaqimit, merrini krejt mëhallët e juaja politike, nuk e kam problem. Ti e di këtë.

Sa i përket interpelancës, unë zyrtarisht, në mënyrën më të rregullt të mundshme, i jam drejtua Kryesisë së Kuvendit për mundësinë që ta kemi një ballafaqim të argumenteve sa i përket asaj çështjeje që ju e keni kërkuar. Por, po ta jap përgjigjen edhe ty, edhe sqarimin për gjithë opinionin publik dhe për ju, deputetë të nderuar.

Çdo vendim që Qeveria e Republikës së Kosovës merr për këtë çështje, siç e kemi përmbyllur në përputhshmëri të plotë me Kushtetutë dhe me ligjet e Kosovës, çështjen e demarkacionit me Maqedoninë, po ashtu dua të ju siguroj edhe ju, si zë i shqetësuar për çështje politike, e jo kufitare, më shumë të politikës ditore, se nuk do ta kisha atë kënaqësi askënd ta akuzoj, sepse edhe çështja e vijës kufitare, e demarkacionit ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Malit të Zi do të zgjidhet në përputhshmëri me Kushtetutën e vitit 1974, në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, në përputhshmëri me Marrëveshjen e Kumanovës, nëse nuk e di çka është ajo, merre lexoje, në përputhshmëri me dokumentin e presidentit Ahtisari, në bazë të të cilit edhe e kemi shpallur Kosovën të pavarur dhe sovranë.

Prandaj, gjithçka çka diskutohet jashtë këtyre dokumenteve ka qenë dhe do të mbetet e papranueshme edhe për mua, edhe për Qeverinë, edhe për Parlamentin. Tek e fundit, ratifikimi në fund do të ndodhë këtu, e jo prej institucioneve tjera, do të thotë nga Parlamenti i Kosovës.

Por, diskutime ka pasur edhe për çështjen e demarkacionit kur është diskutuar me Maqedoninë, dhe i kemi tejkaluar. Unë jam në favor të asaj që kemi arritur në një nivel që të fillojmë me lehtësimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe ta zgjedhim një herë e përgjithmonë edhe çështjen e demarkacionit ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë dhe të ndodhë njohja reciproke. Pastaj ne të anëtarësohemi në OKB dhe të lëvizim shpejt drejt NATO-së dhe Bashkimit Evropian. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit!

Ne kemi hy në seancë të rregullt. E drejta për mocion është në pikën e tretë të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

E ftoj zonjën Musliu që ta marrë fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Qytetarët dhe shoqëria në Kosovë kanë filluar të jenë të frikësuar dhe të shqetësuar nga e ardhmja, dhe kur shoqëria vjen në këtë pikë, duhet të jemi pikërisht ne ata të cilët duhet të jemi zëri i tyre, duhet të jemi ne ata të cilët duhet të reflektojmë t'i mobilizojmë të gjitha kapacitetet për ta krijuar një klimë të qetë, të qartësojmë dhe t'i orientojmë qytetarët e Republikës së Kosovës,

Nisur nga këto premisa, nga të cilat duhet të nisemi secili prej nesh, sot parimisht dua të flas për gjykimin e fundit të EULEX-it, gjykim i cili përfundimisht ka arritur shkatërrimin e besimit tonë në drejtësi.

E them qëllimisht gjykim, sepse më vjen keq që në këtë kontest ta përdor fjalën drejtësi.

Gjykimi i fundit e vë në pyetje serioze qëllimin e këtij misioni.

Gjykimi i fundit nuk pasqyron gjë tjetër, vetëm se drejtësia e të fortit është prioritare dhe së dyti çdo hipokriti i ka krijuar një terren shumë pjellor për hakmarrje personale.

Të dyja këto aspekte janë vdekjeprurëse për gjyqësinë në Kosovë dhe gjyqësinë, në përgjithësi.

Ajo që ky vend më se paku e ka pritur nga EULEX-i dhe ajo për të cilën më së paku ka pasur nevojë, janë proceset e tilla të montuara dhe gjykimet politike.

EULEX-i duhet të japë llogari, nëse jo para qytetarëve të Kosovës, të paktën para qytetarëve të BE-së për shpenzimet e pamëshirshme të parave të tyre për fabrikime faktesh e procesesh në emër të vlerave evropiane.

Dhe, nëse vendimet e tilla janë vlera evropiane, nga kjo foltore unë ju lus t'i mbani për vete ato vlera.

Organeve vendore dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse u bëj thirrje ta drejtojnë kurrizin, ta luftojnë seriozisht krimin, por të mos lejojnë fabrikime e gjykime politike, denigrime e linçime të qytetarëve të Kosovës, kushdo qofshin ata.

Se gjyqësia në vendin tonë ka dështuar, këtë më ua ka ngulitur në tru edhe foshnjave në djep. Por, nëse kjo qëndron, atëherë bashkë me gjyqësinë tonë kanë dështuar edhe OKB-ja, edhe BE-ja në Kosovë, sepse pikërisht në këtë sektor ata i kishin frerët në dorë.

Në këtë betejë nuk ka fitues, prandaj duhet t'i bartin edhe pasojat, e jo të bëjnë përpjekje sistematike për t'ia mbyllur gojën secilit që merr guxim për të kundërshtuar.

Gjykimi i të ashtuquajturit 'Grup i Drenicës', e që në realitet janë: Sylejman Selimi, Sami Lushtaku, Jahir Demaku, Zeqir Demaku, Nexhat Demaku, Fadil Demaku, Hysni Thaçi, Agim Demaj, Selman Demaj, Bashkim Demaj dhe Driton Demaj, është bërë në mënyrën me makabre që mund të bëhej, duke i shkelur parimet themelore të drejtësisë.

Andaj, të nderuar deputetë,

Nëse më të vërtetë duam ta dënojmë krimin, atëherë duhet të fillojmë pikërisht nga ata që e morën këtë vendim, sepse ky është një krim i vërtetë. Ne të gjithë e kemi obligim ta kundërshtojmë këtë gjykim. Ky kundërshtim nuk ka asgjë personale. Ky kundërshtim është dhe duhet të jetë tej përtej parimor për faktin e vetëm se më këtë nivel i gjyqësisë ka zbritur në nivelin e gjyqësisë mesjetare.

Të nderuar kolegë dhe ju kolege,

Mos e largoni asnjëherë nga mendja, qoftë ne si vendorë, apo edhe ndërkombëtarët, se nesër drejt nesh mund të kthehet një gisht akuzues dhe dëshmitë mund ta kenë humbur vlerën e tyre e tyre atëherë.

Gjyqi duhet të ishte përballje faktesh dhe argumentesh, ndërsa gjyqi ndaj 'Grupit të Drenicës' ishte thjesht përballje forcash.

Prandaj, është e pakuptimtë që nuk u është shqiptuar dënimi që ditën e parë, pasi, siç duket, nuk kanë nevojë për fakte dhe dëshmi të vërteta.

Edhe për ata te cilët këtë gjykim e pranojnë si padrejtësi absolute, në njërën anë, dhe në të njëjtën kohë distancohen nga ata që ngrenë zërin kundër, do të ishte më mirë t'i thërrisnin ndërgjegjes dhe të pushonin së luajturi hipokritin.

Sepse në njërën anë thoni keni të drejtë, sepse është vërtet absurd një vendim i tillë e, në anën tjetër, 'ju ju kemi miq dhe duhet të pranojmë krejt çka ju kërkon'.

Dhe, në këtë rast, miqtë janë të fortit, ndërsa hipokriti mbetet vetëm hipokrit. Na ka rastisur shpesh të dëgjojmë se janë procese dhe duhet të sakrifikohemi për Kosovën.

Po, të nderuar, janë procese, ama askush s'ka të drejtë, sot 16 vjet pas luftës, të kërkojë nga tjetri ta sakrifikojë lirinë dhe jetën e tij për hir të askujt dhe asgjëje.

Nëse kërkohet dhe po u dashka sakrifika, atëherë ju që kërkonit urdhëroni si patriotë që jeni faljani lirinë tuaj, vitet e jetës, proceseve të Kosovës dhe gjyqit të montuar në Kosovë.

Meqë jam në këtë foltore dhe meqë sot është dita e parë e Ramazanit, dua ta shfrytëzoj rastin që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të gjithë besimtarëve islamë t'ua uroj Muajin e Shenjtë të Ramazanit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të gjithë besimtarëve myslimanë ua urojmë Muajin e Shenjtë të Ramazanit dhe u dëshirojmë agjërim të lehtë!

Unë dua ta ngre një çështje që tregon për një krim të madh që po përgatitet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Merreni me mend, brenda hapësirës së QKUK-së po ndërtohen spitale private! Ky është një skandal i përmasave të mëdha, duke filluar që nga viti 2003 ky proces u iniciua nga pushteti i atëhershëm i Komunës së Prishtinës, duke ia mundësuar spitalit privat që të fillonte së ndërtuari në tokën komunale. Nuk ishte në fillim i konceptuar si spital privat, dhe ky ishte justifikimi i komunës atëherë, por mashtrimi filloi duke ia mundësuar këtij spitali statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Në vitin 2007, për shkak se dukej që prapa kësaj mund të qëndrojnë përfitime shumë të mëdha edhe të politikanëve edhe të pushtetarëve, Qeveria e atëhershme e kryeministrit Çeku e pat anuluar këtë vendim të komunës për t'ia dhënë hapësirën e cila ndodhte brenda Qendrës Klinike Universitare këtij spitali privat për ta ndërtuar objektin e vet. Dhe, kështu, në qershor të vitit 2008 veproi edhe ish-kryeministri Thaçi. Pra, e konfirmoi vendimin e Qeverisë Çeku që të mos lejohet ndërtimi i një spitali privat brenda spitalit publik, por në qershor të vitit 2009, gjithçka ndryshoi. Qeveria Thaçi e anuloi vendimin e mëhershëm të Qeverisë Çeku dhe ia mundësoi në mënyrë të lirshme këtyre spitaleve që ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre drejt krijimit të një spitali brenda spitalit publik që është QKUK-ja.

Pra, kjo në njëfarë mënyre ndodhi pasi u krijua ai koalicioni PDK-LDK, i vitit 2008, dhe tash kjo çështje u hesht dhe spitali privat brenda QKUK-së po tenton të bëhet një fakt i kryer. Kundër këtij spitali privat kanë protestuar edhe vetë punonjësit e Qendrës Klinike Universitare disa herë. Shtrohet pyetja kush janë qeveritarët që kanë realizuar përfitime personale për t'ia mundësuar spitaleve private operimin brenda spitalit tonë publik, ashtu që ata t'i fitojnë milionat.

Ky është një dëmtim i rëndë i interesit tonë publik, ky është një shkatërrim i sistemit tonë të shëndetësisë. Dikush prej pushtetarëve siç duket e ka vërejtur që tash po përgatitet skema e sigurimeve shëndetësore aty janë dhjetëra miliona euro dhe po përgatitet plani kriminal që këto para të qytetarëve të Republikës të qytetarëve të varfër të Republikës tu jepen profiterëve privatë, të cilët janë miqtë të qeveritarëve dhe me të cilët ata sigurisht që ndajnë edhe përqindjen e përfitimeve.

Si mund të kemi shëndetësi publike kur qeveritarët i kemi në funksion të spitaleve private. Këtu dëgjojmë shpesh edhe programet e partive politike, kur dalin nëpër fushata zgjedhore prioritet mbi prioritete aty e kanë, ne do të angazhohemi për shëndetësi të mirëfilltë publike, kurse krejt çka bëjnë ata, krejt investimin ku e orientojnë është që pikërisht këtë hapësirë të shëndetësisë publike ta shkatërrojnë dhe brenda bile hapësirës së saj të krijojnë edhe spitale private, të cilat do t'i vjelin sigurimet shëndetësore së pari dhe e dyta do të jenë vende të përshtatshme për rekrutimin e mijëra dhe mijëra pacientëve, të cilët do t'i orientojnë aty njerëzit që janë të lidhur me pushtetin brenda Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës.

I bëjmë thirrje Prokurorisë së Shtetit ta hetojë këtë rast dhe mundësisht të na tregojë kush janë këta qeveritarë që po ndërtojnë spitale private brenda Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë vërtet nuk e di kush janë po e di që ka gjëra që nuk shkojnë në shëndetësi, qysh kanë shumë fusha, por diçka desha të ta tërheq vërejtjen. Unë nuk e di qysh e ka vendimin ai spital, por në qoftë se ai është me vendim Qeverie dhe ne e bllokojmë, duhet ta kemi parasysh që ai ka të drejtë ta padisë Qeverinë e Kosovës sipas asaj marrëveshjeje që e ka dhe mund t'i kushtojë pastaj Qeverisë së Kosovës, ku me ditë se sa e paguan.

Sidoqoftë, unë nuk kam asnjë informacion dhe hajde Glauk, një sqarim!

GLAUK KONJUFCA: Vetëm edhe një sqarim shtesë, njëra prej vegëzave më të rëndësishme që krejt ky proces është në kundërshtim me ligjin ka të bëjë edhe me ndërrimin radikal të destinacionit të këtij spitali.

Ky në vitin 2003 u planifikua si Spital i Kardiokirurgjisë, operimit të zemrës dhe këtij iu kanë ndryshuar destinacioni dhe tash po përfundon si spital privat, jo publiko-privat po si spital privat krejtësisht i përgjithshëm, i cili do t'i bëjë konkurrencë Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës brenda hapësirave të saj.

Kjo është një shkelje e rëndë, e dyta kontrata i skadon në 2016, kontrata i skadon këtij spitali më 2016, se ka qenë prej 2006 për 10 vjet, e më 2016 i skadon. Dhe, janë të gjitha parakushtet që të mos i vazhdohet kontrata.

KRYESUESI: Bazohuni që Spitali Amerikan funksionon në oborrin e Spitalit Ushtarak në Tiranë me leje, e kanë marrë ndërtesën me qira, ai funksionon normalisht dhe nuk e di, por në qoftë se ka vendim Qeveria është problem, në qoftë se s'ka vendim Qeveria mirë është ta ngre, pse jo.

Fjalën e ka zonja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe

Ju kolegë deputetë,

Po ashtu, edhe unë dua t'u uroj qytetarëve të Republikës së Kosovës Muajin e Shenjtë të Ramazanit dhe agjërime të lehtë.

Të dashur deputetë,

Dua të diskutoj me ju bashkë për një çështje shumë shqetësuese, asaj të humbjes së jetës së fëmijëve si rezultat i mosefikasitetit dhe papërgjegjësisë institucionale në Kosovë.

Të martën, në fshatin Serbicë e Ulët e Prizrenit, e humbën jetën dy fëmijë të moshës 9 dhe 10 vjeç si pasojë që ata ranë në një pusët ujë, pusët kjo e cila kishte qëndruar e hapur për disa muaj duke shkaktuar rrezik të vazhdueshëm për banorët e deri në fatkeqësinë e dy fëmijëve.

Ku janë institucionet lokale ata, të cilët menaxhojnë me rrugët dhe janë përgjegjës për mbylljen e pusetave. Kush duhet të japë përgjegjësi për rastet e tilla fatkeqësie, të nderuar kolegë deputetë, siguria e fëmijëve në Kosovë çdo ditë po cenohet. Para disa muajve, fëmijët në Fushë-Kosovë dhe Ferizaj janë rrezikuar seriozisht nga qentë endacak edhe duke marrë jetë fëmijësh dhe sa e sa fatkeqësi të tjera do të mund të kenë ndodhur si rezultat i neglizhencës së institucioneve shtetërore për të garantuar siguri të madhe të fëmijëve tanë.

I thërras sinqerisht komunat me departamentet përgjegjëse në kuadër të shërbimeve publike që të jenë më vigjilentë dhe vetëshërbimeve që ofrojnë dhe të kenë më ndjeshmëri të lartë rreth sigurisë së fëmijëve në qytet apo fshatra që hyjnë nën kompetencën e tyre menaxhuese. Evitimi i rreziqeve në rrugë, menaxhimi i qenve endacakë, sigurimi i trotuareve për ecje për fëmijë, vendosja e semaforëve për siguri në kalim të rrugëve, si dhe siguria në shkolla duhet të kenë prioritet adekuat.

Edhe një herë, ju ftoj, anëtarë të Kabinetit qeveritar, por edhe institucionet lokale, që të jenë më të përgjegjshëm, sepse fëmijët tanë janë e ardhmja e Kosovës dhe duhet të kemi kujdes për sigurinë e tyre në Kosovë. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kadriu-Ukelli.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë, që më qenkeni pakësuar bukur shumë.

Përderisa, Kosova vlerësohet si vendi me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë, zyrtarë të lartë të institucioneve shtetërore nuk e kanë fare problem të gjejnë, të zaptojnë dhe të mbajnë deri edhe në gjashtë vende pune dhe të paguhen nga buxheti i shtetit.

Nga 4 200 zyrtarë të lartë të Kosovës, çdo i treti prej tyre ushtron funksione të shumëfishta. Sipas të dhënave të Agjencisë Kundër Korrupsionit janë identifikuar mbi 1 500 zyrtarë të lartë që ushtrojnë më shumë se një funksion shtetëror dhe publik.

Derisa shumë zyrtarë të lartë mbajnë prej 2-6 vende pune, pagat e të cilëve sipas formularëve të deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, sillen prej 1 200 e deri në besa 2 800 euro në muaj, shkalla e papunësisë dhe e varfërisë në Kosovë është shumë e lartë dhe po rritet përditë.

Kosova po vazhdon të ketë politika hipokrite, korruptive, të padrejta të punësimit në sektorin publik dhe kjo falë ndërtimit të një sistemi tepër klientelist dhe zhvatës të buxhetit të shtetit. Përderisa qindra e mijëra zyrtarëve u është mundësuar të mbajnë nga dy, tre, katër, pesë, besa edhe gjashtë pozita publike, ndërkohë rrugëve na sillen vërdallë plotë të rinj me diploma universitare.

Sipas asaj që është deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, janë të paktën më shumë se 2000 vende pune që do të liroheshin, nëse ndërpritet me ligj punësimi i shumëfishtë në sektorin publik. Me këtë punësim të shumëfishtë që tejfavorizon një pakicë njerëzish të rrethuar nga luksi, pushteti dhe paraja, po vazhdojnë të dëmtohen një shumicë e madhe që mezi gjejnë ose nuk gjejnë dot një vend pune për vete dhe për familjen e vet.

Edhe pse mund të ketë kualifikime të duhura, shkollimi përkatës është e pamjaftueshme të zësh një pozitë publike, po nuk pate lidhje korruptive apo politike. Zakonisht, gjatë çdo fushate zgjedhore partitë politike nga nevoja e madhe për votën e çdo qytetari i lodhin duke u trokitur derë më derë dhe duke i joshur qytetarët me premtime të rrejshme për hapje të vendeve të reja të punës, me zotimet e tyre për kinse meritokraci, drejtësi, zbatim ligji dhe të kriterëve, por zakonisht, çka kemi parë së paku deri më sot, sapo të hipin në karrigen e pushtetit, premtimet bien në ujë si gjithmonë.

Pasi draftligji i ri për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, do të jetë shpejt në duart tona, e ngre si çështje t'ua rikujtoj se është detyrë jona si deputetë të Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të qytetarit të këtij vendi, që t'i ndalojmë përfundimisht dhe përgjithmonë padrejtësitë e tilla, që një zyrtar shteti, kudo qoftë dhe kushdo qoftë dhe në çfarëdo pozite është, nuk do të ketë të drejtë dhe nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,
Fillimisht ju uroj të gjithë besimtarëve islam muajin e shenjtë të Ramazanit, duke u dëshiruar agjërim të lehtë.

Sot, dua ta ngre një çështje, e cila ka të bëjë me liqenin e Ujmanit, apo emri i më hershëm Gazivoda. Arsyeja pse po e ngre këtë çështje janë deklaratimet e ditëve të fundit të kryeministrit të Serbisë lidhur me atë se nuk do të lejohet që ky liqe të mbetet nën sovranitetin e Republikës së Kosovës. Sa për informatën e qytetarëve, po jap një informatë të shkurtër rreth ndërmarrjes publike “Ibër-Lepenc”.

Ndërmarrja publike “Ibër-Lepenc” është themeluar me vendimin e Kuvendit të Kosovës, më 28 shkurt të vitit 1967, me seli në Prishtinë. Ndërmarrja është konstituuar në vitin 1986 si ndërmarrje shoqërore, me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së këtij sistemi shumëfunksional.

Ndërtimi i këtij sistemi është paraparë të jetë në dy faza, të cilat kanë qenë të dy projektet me rëndësi të veçantë për vendin: faza e parë - Ibri dhe faza e dytë - Lepenci.

Faza Ibër ka përfunduar në vitin 1986, kurse faza e dytë Lepenci edhe pse janë projektet e janë bërë disa tentativa nuk është realizuar, sepse janë ndërprerë në atë kohë investimet për shkaqe politike dhe mendoj se është projekt i domosdoshëm që duhet të ndodhë në vitet e ardhshme.

Ndërmarrja publike “Ibër-Lepenc” është ndërmarrje publike qendrore me aksionarë 100% Qeverinë e Republikës së Kosovës. Për momentin e ka një rëndësi shumë të veçantë, ku bëhet furnizimi me ujë industrial: KEK-un, “Ferronikelin”, Ujësjellësin e Prishtinës, Ujësjellësin e Mitrovicës, kemi ujë në 8 komuna, ndërmarrja ka para kontratë me ndërtimin e Fabrikës së Ujit në Shkabaj për Prishtinën, Fabrikës së Ujit në Vushtri dhe me projektin Kosova e Re e ka parapëlqimin nëse projekti do të ndodhë.

Kapacitetet e këtij liqeni janë shumë të mëdha, ku penda e Ujmanit akumulon 375 milionë m³. Është liqeni më i madh në Republikën e Kosovës, është më e larta pendë - 107 m, Hidrocentrali i Ujmanit ka kapacitete 2 gjeneratorë me 17,5 MW gjithsej 35 MW, kurse ka liqenin tjetër Pridvoricën, me kapacitete 480 000 m³.

Vlen të theksohet që gjatë vitit 2004-2005, komuna e Tutinit ka bërë në pjesën ku shtrihet, se liqeni shtrihet mbi 70% në Republikën e Kosovës, kurse edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kolegë deputetë,
Sot dua të flas për sektorin e blegtorisë, që për vendin tonë paraqet sektorin më të rëndësishëm të bujqësisë, që në kushte normale do të mund të ndihmonte zhvillimin ekonomik të vendit dhe të ulë shkallën e papunësisë.

Mirëpo, përkundrazi, ky sektor në këta tre muajt e fundit rrezikon të shkatërrohet plotësisht si pasojë e konkurrencës së padrejtë nga kompanitë importuese të qumështit dhe produkteve të tij, të cilat kanë përmbajtje të dyshimta sa i përket cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Qumështi i importuar, qumështi pluhur dhe produktet e tij me përmbajtje të vajrave me origjinë bimore, që imitojnë djathërat origjinalë, kanë kosto më të lirë të prodhimit dhe si pasojë, këto produkte jo vetëm që po i dëmtojnë prodhuesit dhe përpunuesit vendor të qumështit, por dëmtojnë dhe rrezikojnë shëndetin e popullatës sonë.

Ndërsa, nga pikëpamja tregtare ligjore, ato përbëjnë mashtrim për konsumatorin dhe dëmtojnë kompanitë vendore duke konkurruar pandershëm.

Përfaqësuesit e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit u janë drejtuar shpeshherë institucioneve tona, me kërkesa të qarta e legjitime, por institucionet tona asnjëherë nuk u morën seriozisht me kërkesat e tyre.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkon që të bëhet aplikim i tarifës së integruar të Kosovës, sikur që bëjnë vendet e BE-së dhe vendet e rajonit me qëllim të mbrojtjes së produkteve vendore.

Pra,

1. Të bëhet zbatimi i përpiktë i Ligjit anti-damping;
2. Të bëhet kuotizimi i importeve të qumështit dhe produkteve të tij;
3. Të bëhet hartimi i një baze ligjore që rregullon importin e produkteve të qumështit dhe atyre me yndyrë bimore duke i shtuar taksë shtesë;
4. Të lirohet repromateriali dhe lënda djegëse për prodhimin nga taksat e importit;
5. Të bëhet përkrahja e sektorit të qumështit me subvencione të djathit në njësi të prodhimit 50 centë për kg djathë në muajin prill deri në muajin gusht;
6. Të ndryshohet Ligji i prokurimit, i cili në mënyrë diskriminuese përjashton prodhuesit vendorë që të marrin pjesë dhe të bëjnë furnizim në institucionet publike, sepse tenderët për furnizime të tilla u janë përshtatur kërkesave të tregtarëve importues dhe produkteve të huaja.

Përndryshe, në këto kushte nuk ka asnjë kuptim që në njërin anë Ministria e Bujqësisë nga buxheti i shtetit të ndajë grante për ndërtimin e stallave dhe shtimin e fondit në këtë blegtoral, e në anën tjetër në mungesë të politikave të mira fiskale dhe lidhjet klienteliste ndërmjet bizneseve importuese dhe qeveritarëve, praktikisht për ta shkatërruar këtë sektor.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” kërkon nga organet përgjegjëse, që të ndalet urgjentisht importi i prodhimeve të tilla në kushte të mungesës së plotë të bazës ligjore dhe të shpëtohet ky sektor i rëndësishëm për bujqësinë e Kosovës dhe për ekonominë e vendit, sepse nuk ka ndonjë

mekanizëm që mund të stoposh prodhimin e qumështit vendor dhe ta shtysh atë për një afat të caktuar, përveçse do t'i detyroni prodhuesit e qumështit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izma e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Edhe unë filloj me urimin për muajin e shenjtë të Ramazanit për të gjithë myslimanët, duke uruar që së paku më shumë në këtë muaj të kemi humanitet ndërmjet vete.

Unë sot kam zgjedhur një temë sociale. Në bazë të dhënave që ka nxjerrë Agjencia e Statistikave të Kosovës, vendi ynë në skema sociale ka të përfshirë gjithsej 29.538 familje me gjithsej afërsisht 120 mijë anëtarë familjarë. Numri më i madh i familjeve përfituese nga kjo skemë është në komunën e Mitrovicës, me gjithsej 2047 familje, përafërsisht është e njëjtë edhe komuna e Vushtrisë, pastaj edhe kategoritë tjera, siç janë pensionistët kontributdhënës dhe pjesa tjetër përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara ndaj të gjithë këtyre kemi një çështje për të cilën ende s'kemi arritur si institucione të përmbushim një nevojë në mënyrën e duhur.

Në bazë të obligimeve ligjore të gjitha këto kategori kanë obligim që në qendrat përkatëse sociale të paraqiten fizikisht dy herë në vit, për t'u lajmëruar se janë gjallë, një detaj aspak etik dhe human, sepse të jesh pensionist është vetëm një pushim nga obligimet e punës e nuk determinon logjikën, si një person që po i afrohet pra, përfundimit të jetës.

Pra, nëse ne i detyrojmë nga ditë që fillon koha e pensionimit të tyre të lajmërohen këta dy herë në vit në qendra, se janë ende gjallë, kushtimisht i bie që pas gjashtë muajsh ata mund të jenë të vdekur. Është e vërtetë që pensionistët tanë nuk i kanë kushtet e kolegëve të tyre në shtetet e zhvilluara, të cilët kur arrijnë këtë moshë shëtisin botën me grupe turistike. Pensionistët tanë ende s'kemi mundur t'i trajtojmë me dinjitet, në sferën pra të kompensimeve materiale.

Problem tjetër është se ndër pensionistë edhe ndër personat me aftësi të kufizuara, ka të tillë që vërtet janë të sëmurë, disa e kanë të pamundur edhe të ecin e me gjithë këtë gjendje, këta duhet të shkojnë të presin në radhë të gjata, për të dëshmuar prezencën fizike, pra faktin se janë ende gjallë.

Dinamika e jetës e ka bërë sot që disa nga ta e kanë të vështirë të gjejnë edhe shoqërues për t'i përcjellë në qendrën sociale dhe këta detyrohen në atë gjendje, të shkojnë vetë aty, sepse humbin pagesën mujore.

Kërkesa ime, si deputete e këtij Kuvendi është që Qeveria dhe Ministria përkatëse të shikojë mundësinë që qendrat sociale të organizojë ekupe mobile, ku dy herë në vit t'u shkojnë këtyre personave vetë në shtëpitë e tyre për verifikim, e jo ata të detyrohen të vijnë në qendër.

Po ashtu, ministritë përkatëse të bëjnë një incizim të gjendjes lidhur me plotësimin e infrastrukturës të përshtatshme për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, por edhe për të sëmurët, pleqtë e lodhur, e tjerë, e kam pra, fjalën për shkallët ndihmëse që këta i kanë të vendosura për karrocën e tyre.

Dy herë në vit, pra, ekupe mobile të shkojnë tek personat të cilët familjarët i kanë të paraqitur paraprakisht në qendrat përkatëse sociale, ndërsa të tjerët që janë të shëndoshë, këtë lëvizje e bëjnë pa ankesë, sepse edhe ashtu është një rutinë, e cila i plotëson në jetën e tyre pensionale.

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Në qoftë se më lejohet të vazhdoj për dy minuta më gjatë, përndryshe e lëmë për herën e ardhshme. Faleminderit! Atëherë, herën e ardhshme, ose ndoshta më lejohet të flas në emër të Grupit, apo në emër të gjitha grupeve, sepse është tema shumë interesante.

KRYESUESI: Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Jemi në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 18 pyetje parlamentare. Unë kaloj. Kur nuk është deputeti ose përfaqësuesit e Qeverisë, ne vazhdojmë. Në qoftë se deri në fund nuk vjen as deputeti, as përfaqësuesit e Qeverisë, mbetet për seancën e radhës.

Deputeti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa; deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi; deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku, ministri është këtu. Nuk mund të ankohen deputetët, deri në fund e presim zotin ministër, në qoftë se vjen, ia japim të drejtën prapë. Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa; deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami; deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministren Hikmete Bajrami; deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Ferid Agani; deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa; deputeti Pal Lekaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa; deputeti Daut Hrradinaj, pyetje për ministrin Lutfi Zharku; deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

I nderuar zoti Zharku,

Ju keni parasysh që magjistratja Prishtinë-Shkup ku bënë pjesë edhe Ferizaji, Kaçaniku, Elez Hani është një prej rrugëve të cilat janë bukur shumë të qarkulluara dhe është një prej rrugëve e cila është bukur shumë e dëmtuar dhe nuk është riparuar asnjëherë. Ka shumë ankesa prej qytetarëve të cilët dëshirojnë të dinë se a është në plan, a ekziston një plan që kjo rrugë gjatë vitit të ardhshëm të rregullohet pavarësisht nga fakti që do të bëhet autostrada por megjithatë prapë rrugë do të ketë nevojë edhe më tutje.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Topalli,

Rruga Prishtinë - Hani i Elezit, në bazë të numrit të automjeteve, është një ndër rrugët më të ngarkuara me qarkullimin rrugor.

Kjo situatë rëndohet edhe më tepër nëse e marrim parasysh edhe numrin e madh të automjeteve të transportit me pesha të rënda që qarkullojnë në këtë rrugë që lidh Kosovën me Maqedoninë.

Ministria e Infrastrukturës ka përgatitë dokumentacionin e nevojshëm për rehabilitimin e kësaj rruge që përfshinë rishtresimin e saj me shtresë të re të asfaltit me trashësi mesatare prej 6 cm.

Vlera e parashikuar e projektit është rreth 2 milionë e 754 mijë euro. Projekti ishte i ndarë të realizohet në dy segmente. Segmenti i parë është nga rrethrotullimi i QMI-së deri në Gërlicë dhe segmenti i dytë nga Gërlica deri në Hanë të Elezit.

Projekti është shpallur më datën 25 mars 2015 në procedurë të hapur të prokurimit dhe ka qenë i hapur për konkurrim për operatorët ekonomikë të interesuar deri më 27 maj 2015.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë gjithsej 15 kompani.

Ministria e Infrastrukturës më datë 29 maj 2015, ka caktua komisionin profesional për vlerësimin e këtij projekti dhe brenda afatit ligjor do të procedoj me shpalljen e rekomandimit për dhënie të kontratës dhe nënshkrimin e kontratës.

Me përfundimin e këtij projekti do të përmbyllet rehabilitimi dhe sanimi i kësaj rruge me çka do të krijohet komplet infrastruktura e re nga QMI-ja deri në Han të Elezit. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Po, vetëm shkurtimisht, kur do të fillojë realizimi i projektit?

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Po sa të nënshkruhet kontrata, ajo që e përmenda sipas afateve ligjore, 30 ditë zgjat vlerësimi nëse ka eventualisht ankesa për çështje tjera. Në momentin që nënshkruhet kontrata, unë besoj se gjatë verës do të fillojë realizimi i këtij projekti.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Deputeti Lah Ibrahimaj, pyetje për ministrin Memli Krasniqi; deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Bleran Stavileci; deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Deputet, dëshiron ta bësh pyetjen, apo kur të vijë ministri? E presim, në qoftë se nuk vjen, ju vendosni si dëshironi. Deputetja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

AIDA DËRGUTI: Unë kisha me ngritë vetëm si shqetësim në këtë rast, domethënë për këtë periudhë tremujore nga 101 pyetje sa i janë parashtruar Qeverisë, 78 prej tyre kanë mbetur pa përgjigje dhe mendoj që kjo formë e përgjigjes në raport me Kuvendin është shqetësuese dhe mirë domethënë llogaridhënia para Kuvendit.

Unë nuk po e lexoj sot pyetjen, le të mbetet për seancën e ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Nëse vjen ministri unë parashtroj pyetjen më vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Salih Salihu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Do ta parashtroj pyetjen kur të jetë ministri këtu.

KRYETARI: Ne në fakt e përfunduam këtë pikë të rendit të ditës në këtë mënyrë. Do të mbetet kjo situatë, të cilën realisht e kemi.

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit, kurse Zyra për Informim e Kuvendit e lëshon një njoftim për media brenda 24 orëve. Neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit. Duhet shikuar me rregulloren e re dhe sanksionua në mënyrë më specifike.

Deputetë të nderuar,

Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se në ndërkohë, pas caktimit të rendit të ditës për këtë seancë, ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, zonja Hykmete Bajrami ka kërkuar që pikat 7 dhe 8 të rendit të ditës të shtyhen për seancën tjetër të radhës.

Pra,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta, dhe

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për markat tregtare.

Arsyeja e shtyrjes është se ministrja gjendet në udhëtim zyrtarë jashtë vendit.

Atëherë i shtyjme këto dy pika të rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 4 qershor 2015? Urdhëroni, në qoftë se ka dikush vërejtje. Nëse nuk ka, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 4 qershor 2015.

Pika e katërt e rendit të ditës - Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, është shtyrë, me kërkesën e propozuesit.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Në bazë të nenit 56 të rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ja ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin Mahir Yagcilar që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj një prej ligjeve më të rëndësishme sa i përket funksionimit të Administratës shtetërore Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative. Në vazhden e reformave në administratën publike dhe me qëllimin që ligjet e Republikës së Kosovës të rregullohen në mënyrë sa më të avancuar të gjitha raportet e shoqëruara që i përgjigjen rrethanave dhe kërkesave të reja, si dhe standardeve të legjislacionit evropian është dhënë nevoja e hartimit të Projektligjit për procedurat administrative.

Procesi i hartimit të kornizës ligjore të procedurave administrative dëshiroj t'ju informoj se ka filluar nga viti 2010. Së pari është iniciuar nga Ministria e Administratës Publike, por ka qenë fillimisht si plotësim dhe ndryshim i ligjit aktual. Duke e ditur rëndësinë e këtij ligji, ministri i Administratës Publike në bashkëpunim me SIGMA nga..., të financuar edhe nga Komisioni Evropian në fund të vitit 2010 ka përgatit një dokument i cili përveç që përbënte një vlerësim të ligjit aktual në të njëjtën kohë përbënte edhe një dokument analizash dhe rekomandimesh mbi bazën e të cilave duhet të rregullohen procedurat administrative.

U vlerësua se do të ishte më se e vështirë të përmirësohet ligji aktual me amendamentet selektive, sepse në ligjin aktual janë të mëdha këto nevojitet përmirësime të mëdha dhe sistematike. Në fakt, sa i përket përmbajtjes rregulluese të dispozitave individuale amendamentet do të ishin të mundura, mirëpo qasja e përgjithshme legjislative, struktura hutuese, si dhe zbrazëtitat do të kërkonin aq shumë ndryshime në tekstin aktual sa që në fund të gjitha përpjekjet për plotësimin e ligjit struktura do të jetë e pakuptueshme, jo konsistente dhe jo gjithëpërfshirëse.

Për këtë arsye është propozuar hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për procedurat e përgjithshme administrative. Procesi i hartimit të ligjit fillojë në vitin 2013 nga ministri i Administratës Publike në bashkëpunim me ekspertët nga SIGMA dhe ekspertët tjerë vendorë.

Procesi që nga hartimi deri te finalizimi i tij kishte një transparencë të lartë duke u karakterizuar me konsultime të gjëra publike, përfshirë institucionet e nivelit qendror dhe lokal, gjykata dhe shoqërinë civile dhe qëndrimi është se vendimmarrja administrative dhe ofrimi i shërbimeve administrative duhet të përshtaten nevojave të reja.

Thjeshtësia dhe qartësia, pjesëmarrja, reagimi dhe performansa e orientuar drejt qytetari duhet të jetë esenca e ndryshimeve. Në këtë kontekst projektligji propozuar për procedurën e përgjithshme administrative ka për qëllim të rregullojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbimin të interesit publik duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave.

Fushëveprimi i këtij ligji shtrihet mbi të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë administrative duke rregulluar në mënyrë moderne dhe gjithëpërfshirëse aktin administrativ, kontratën administrative dhe aktin real. Projektligji përmban 10 parimet administratës së mirë të procedurave administrative, si: parimi i ligjshmërisë, parimi i proporcionalitetit, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimi, parimi i objektivitetit dhe paanësisë, parimi i pritshmërisë të ligjshme dhe të arsyeshme, parimi i administratës së hapur, parimi i deburokratizimit dhe eficiencës të Administratës Publike, parimi i informimit dhe ndihmës aktive, parimi i mos pagimit të procedurës dhe parimi i drejtës për mjete juridike.

Sipas këtij projektligji, organi publik gëzon fleksibilitet në përzgjedhjen e formave të veprimit administrativ si: shtrirja e hetimit administrativ, mjetet e provës, mënyrën e komunikimit etj. Projektligji i propozuar synon të thjeshtësojë sa më shumë procedurat administrative, të jetë më efikase dhe shpejtë me një mekanizëm administrativo-ligjor i ndihmës aktive administrative do të sigurohet bashkëpunim jo burokratin dhe ndihmë e mbështetje të ndërsjellët të autoriteteve administrative ndaj qytetarëve.

Në anën tjetër, organi publik do të hetojë faktet relevante të një vendimi administrativ ‘ex officio’, obligim ky që buron nga sundimi i ligjit posaçërisht nga parimi i ligjshmërisë dhe shton sigurinë dhe besueshmërinë e ligjit dhe besimin publik në administratën publike.

Një instrument që buron nga parimi i demokracisë, si dhe nga e drejta për proces të drejtë është e drejta në këshillim dhe informim, pasi që jo secili qytetarë është i njoftuar me ligjin ose me procedurën administrative, në këtë aspekt organi publik do të informojë palën mbi të drejtat dhe obligimet e veta në procedurë dhe t’i shpjegojë pasojat ligjore të aktiviteteve apo lëshimeve, do të lejojë paraqitjen apo korrigjimin e deklaratave apo aplikacioneve kur është qartë se këto nuk janë dorëzuar apo janë dorëzuar gabimisht vetëm për shkak të ndonjë gabimi apo mos njohurie.

Me këtë projektligj një akt administrativ mund të bëhet efektiv vetëm nëse njoftohet pala së cilës i drejtohet akti dhe cila preket nga ai. Si rregull akti administrativ me shkrim duhet të shoqërohet nga një deklaratë e materialeve kryesore dhe arsyeve ligjore që kanë shtyrë autoritetin publik të marrë vendimin e vetë.

Këto dy kërkesa të njoftimit dhe deklarata e arsyeve janë elemente esenciale të sistemit të mbrojtjes të së drejtave të qytetarit. Në anën tjetër, nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkuar dhe organi publik nuk njofton një akt administrativ brenda afatit fillestar

dhe nuk njofton shtyrjen, apo nuk njofton aktin brenda afatit të shtyrë kërkesa e bërë nga pala do të lëshohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë e miratuar.

Ky rregullim është huazuar nga direktiva e shërbimeve të Komisionit Evropian dhe është mekanizëm i cili po gjen zbatim në shumë shtete evropiane. Megjithatë, te miratimi në heshtje mund të përjashtohet në rastet kur ligji i veçantë parasheh mos aplikimin e këtij mekanizmi. Parimet e qasjes së pikës së kontaktit të vetëm dhe komunikimit përmes teknologjisë informative në mes autoritetit administrativ dhe qytetarëve, po ashtu janë të rregulluara në projektligj sipas direktivës së shërbimeve të Bashkimit Evropian në mënyrë të përgjithshme, në mënyrë që detajet t'ju mbeten ligjeve special apo akteve nënligjore.

Në këtë projektligj, masat e administrative ligjore nuk janë vetëm instrument në duar të qytetarit për të mbrojtur të drejtat e tij apo saj kundër një organi administrativ. Ato janë gjithashtu edhe mjet i vetë kontrollit të autoriteteve administrative, pasi u jep atyre mundësinë e identifikimit të gabimeve sistematike dhe këssoj përmirësimit të praktikës administrative në përgjithësi lidhur me rastet e ngjashme.

Prandaj, qëllimet kryesore të mjeteve juridike në Ligjin e procedurës administrativ janë të krijojë një mënyrë efektive të lehtë dhe të lirë për mbrojtjen e të drejtave ligjore të palëve para ankesës në gjykata për çështje administrative, të ofrojë mundësi dhe obligim të vetë kontrollit efikas të autoriteteve administrative, t'i lirojë gjykatat për çështje administrative nga ngarkesa duke i zgjidhur rastet nëpërmjet procedurave të mjeteve juridike.

Të nderuar deputetë,

Për dallim nga rregullativa e mëhershme, për herë të parë është bërë një rregullim i plotë dhe konciz i institutit të ekzekutimit të detyrimeve financiare dhe jofinanciare, të cilat dalin nga aktet administrative të ekzekutueshme. Projektligji në fjalë është, relativisht i shkurtër krahasuar me ligjet tjera procedurale për degët tjera të së drejtës. Ligji ka prioritet rregullimin dhe terminologjinë e qarë dhe transparente. Kjo vlen posaçërisht për kompetenca dhe përgjegjësi, nenet kanë tituj të shkurtër dhe preciz që të ndihmojnë në implementimin e ligjit të kontribuojnë në kuptueshmërinë e tij për qytetarët dhe të ngritin nivelin e sigurisë ligjore.

Projektligji për procedurat administrative përbën 9 pjesë në të cilat janë sistemuar gjithsej 162 nene, projektligji nuk ka elemente diskriminuese, projektligji është në pajtim me kushtetutën dhe sipas deklaratës së lëshuar nga Ministria për Integritet Evropian nuk i cenon nga parimet e përgjithshme të 'acquis communautaire'.

Duke pas parasysh rëndësinë e këtij projektligji është paraparë se ligji do të fillohet të zbatohet në tërësi pas një viti, pas dekretimit, pikërisht hyrjes në fuqi me qëllim që të përgatiten nëpunësit civil për zbatimin e tij, të hartohet një manual për zbatim, të realizohen të gjitha përgatitjet e nevojshme, si dhe të njoftohen qytetarët dhe bizneset me risit që do të sjell ky ligj.

Të nderuar deputetë, duke u bazuar në rëndësinë e Ligjit për funksionimin e administratës shtetërore, sfidat nga Raporti i Progresit evropian dhe konkluzionet nga grupi i veçantë për reformën e administratës publike ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj në parim, ndërsa

sugjerimet dhe propozimet së bashku do të shqyrtojmë edhe në Komisionin Parlamentar për Administratën Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani e ka radhën kryetari i Komisionit FunkSIONAL, atëherë urdhëro në emër të komisionit, zoti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Të nderuar kolegë,

Pra, në cilësinë e nënkryetarit të Komisionit për Administratë, Pushtet Lokal dhe Media, i njëjti komision ka bërë shqyrtimin e projektligjit 05-L31, më 3 qershor 2015, dhe të njëjtin ia rekomandon seancës për miratim. Me çka komisioni edhe njëherë e konstaton se janë përmbushur kushtet e nenit 54 të Rregullores së Kuvendit. Pra, edhe njëherë thërrasim Kuvendin që ta miratojë në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Tani e kanë radhën grupet parlamentare. Xhevahire IzmaKu, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për procedurat e përgjithshme administrative dhe e kemi këtë sugjerim: një sfidë e re dhe shtesë për Administratën Publike është përgjigjja ndaj ndryshimeve rrënjësore, sociale, kulturore, dhe ekonomike që kanë ndodhur gjatë dekadave të fundit. Këto ndryshime i prekin të gjitha vendet dhe sistemet shtetërore, por janë të rëndësishme veçanërisht për vendet në tranzicion dhe vendet potenciale kandidate për BE.

Projektligji i procedurave të përgjithshme administrative është një ligj modern dhe konciz për nga rregullimi i cili përmban në vete zgjidhjet e fundit që janë aplikuar nga shumë shtete, të cilat janë pjesë e BE-së, por edhe të shteteve të cilat presin të jenë pjesë e BE-së. Ky projektligj ka rregulluar në tërësi materien e procedurave administrative duke filluar nga qëllimi dhe fushëveprimi i gjerë që përmban dhe në tërësi rregullon veprimtarinë administrative duke parashikuar rregullim përveç aktit administrativ dhe të kontratave pra administrative dhe akteve tjera reale.

Në përgjithësi, ky projektligj është një ligj modern dhe i kohës, i cili synon që të rregullojë në përgjithësi procedurat administrative duke paraparë rregulla për thjeshtësimin e tyre, por edhe realizimin efektiv të autoritetit publik duke garantuar në të njëjtën kohë edhe mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve. Ne si grup parlamentar sigurisht që kontributin do ta japim në vazhdimësi, mirëpo kemi vërejtje posaçërisht te harmonizimi në të tri gjuhët zyrtare, i cili, siç shihet, gjatë shqyrtimit në komision ka hasur në disa pengesa.

Unë ju ftoj të votojmë dhe grupi ynë do të votojë për në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Pra, edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe edhe pse ky projektligj vërtetë ka gabime drejtshkrimore dhe ka lëshime të mëdha në përkthime dhe mos përputhje në versionet në gjuhët e ndryshme që nuk ka ndodh shpesh që nga kjo ministri të vijnë kaq ligje të dobëta teknikisht të punuara, por shpresojmë që kjo është rast i vetëm ngase s'kemi pas dhe shpresojmë që s'do të ndodh. Paraprakisht paralajmërojmë se pikërisht për këto arsye jo esenciale të ligjit ky ligj do të ketë amendamente më tepër se që keni parë ndoshta ndonjëherë në përqindje të amendamenteve.

Pra, do të ketë shumë amendamente mirëpo ne duke e parë nevojën që të përshejtohet një ligj kaq i rëndësishëm që lidhet edhe me avancimin e administratës edhe me përmbushjen e të gjitha objektivave që i kemi edhe si Kosovë, por edhe si ministri, ne do ta votojmë sot në parim këtë ligj, do të punojmë dhe do të bashkëpunojmë me gjithë aktorët që ky ligj të vjen sa më shpejtë dhe në variantin më të mirë, por nuk do të thotë me vetëdije nuk duhet të çuditemi asnjë se do të ketë amendamente tepër shumë. Por, besoj se këtë ligj do ta sjellim në nivelin e pranueshmërisë dhe në përmbushje të ideve që i kemi për ta rregulluar, pra për ta bërë një ligj të mirë që lidhet me procedurat administrative.

Dhe, si grup parlamentar në parim do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Nocioni i shtetit ngërthen në vetvete autorizimin e ushtrimit të pushtetit shtetëror duke ia njohur kompetencën e përgjithshme që aparati shtetëror ta vë në lëvizje sa herë që të paraqitet nevoja.

Dhe, vënia në lëvizje e aparatit shtetëror vepron brenda koordinatave që përcaktohen nga rendi juridik, i cili përbëhet nga aktet që shprehin vullnetin e brendshëm të ushtrimit të sovranitetit për popullin, sipas konditave që janë të përcaktuara në tërësinë juridike të këtij rendi shoqëror, i cili materializohet në formë të normave juridike. Janë këto norma juridike që përbëjnë kufirin e veprimit dhe hapësirën e pushtetit shtetëror, përbrenda të cilit ai vepron dhe ushtron kompetencat e besuara sipas rendit juridik.

Në këtë kuptim administrata shtetërore është forma thelbësore, me të cilën pushteti realizon marrëdhënien e drejtpërdrejtë me qytetarët e Republikës. Duke qenë se kjo marrëdhënie është e dyanshme, ndërmjetësuesi kryesor në mes pushtetit dhe qytetarëve është rregullimi juridiko-administrativ, i cili paraqet shprehje të veçantë të kufizimit të arbitraritetit shtetëror dhe formës së realizimit të të drejtave të qytetarëve sipas mënyrës dhe formës së caktuar në bazë të kushteve ligjore.

Njësoj edhe Republika e Kosovës si Republikë parlamentare, me rregullimin e saj kushtetues pozitiv, bazohet mbi premisën juridike që kompetencat e organeve shtetërore ushtrohen mbi

parimin e ligjshmërisë. Kjo shprehje e formës së ushtrimit të pushtetit shtetëror nënkupton përputhshmërinë e plotë në mes të veprimeve të organeve të administratës shtetërore, të formës së caktuar me rregullimin juridik që është në fuqi.

Karakteri pozitiv i konstruktit legal është garanti kryesor i realizimit të të drejtave kolektive dhe të të drejtave individuale. Në këtë kontekst realizimi i të drejtave kolektive nënkupton realizimin e të drejtave të komunitetit që duke u bashkuar realizojnë përfaqësimin e drejtë kolektive, si shprehje e ushtrimit të lirisë për të qenë të përfaqësuar dhe për të përfaqësuar, ndërkaq, realizimi i të drejtave individuale nënkupton realizimin e standardit themeltar për të drejtat dhe liritë elementare të njeriut.

Nga konteksti i interesit të përgjithshëm shoqëror, unë mendoj që Ligji i procedurës së përgjithshme administrative paraqet rregullimin më të rëndësishëm në Republikën e Kosovës, pas Ligjit penal.

Rregullimi proceduralo-administrativ është garanti kryesor i parandalimit të tejkalimit të arbitraritetit të pushtetit shtetëror, karshi realizimit të të drejtave të qytetarëve në raport me administratën publike. Kjo sepse të drejtat dhe liritë elementare të njeriut nuk mund të shkelen nga individ, ato shkelen zakonisht nga pushteti. Shkeljet e tilla nga individ quhen cenim i të drejtave subjektive, ndërkaq shkeljet nga organet shtetërore, janë shkelje të të drejtave themeltare, që i gëzon qytetari në cilësinë e subjektit të së drejtës.

Në këtë drejtim, rregullimi i përgjithshëm i veprimeve dhe autorizimeve të organeve shtetërore dhe të subjekteve të tjera juridike, që ushtrojnë autorizime publike është i një nevojë jetike për ekzistimin e shtetit të së drejtës si të tillë.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto, projektligji i sjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Qeveria, e cila e sponsorizon ligjin, nuk e shpreh as qëllimin e saktë e as natyrën juridike për të cilin duhet të ekzistojë një konstruksion i tillë legal. Raporti në mes ligjvënësit dhe zbatuesit të ligjit shprehet tek qartësia, e cila shërben për zbatimin e ligjit.

Ky projektligj nuk përmbushë kriteret minimale të hartimit standard, legjislativ që ekziston në Republikën e Kosovës. Problemi thelbësor i këtij projektligji qëndron si në aspektin formal të hartimit të tij, por jo më pak, le të themi, ngecje ka edhe në aspektin përmbajtjesor. Gjuha dhe semantika e gabuar juridike e vështirëson kuptimin e dispozitave të këtij projektligji, ndërkaq, përmbajtja e tij nuk i mbulon kërkesat e plotësimit të ligjit në fuqi, për procedurën e përgjithshme administrative.

Mungesa e instituteve, e akteve dhe mjeteve të caktuara juridike janë shkaqet kryesore që ky projektligj nuk paraqet kualitetin e kërkuar juridik, për të arritur qëllimin kryesor që e ka. E në anën tjetër, qëllimi kryesor i këtij ligji është rregullimi i tërësisë standarde të veprimeve dhe të mënyrave të ushtrimit të autorizimeve publike nga ana e organeve të administratës publike dhe subjekteve juridike, të cilave u besohen këto autorizime publike.

Siç duket, hartuesi më shumë është rrëmbyer nga, le të themi, vëllimi i ligjit se sa nga përmbajtja e tij, kur e ka propozuar për miratim. Kemi përpara një propozim, me të cilin kërkohet rregullimi

tërësisht i ri i kësaj fushe ligjore, e në anën tjetër, rregullimi aktual ligjor, ndonëse edhe ai me mangësi të evidentuara, është më i mirë dhe më mirë i përgatitur dhe më i qartë në raport me projektligjin, që po na propozohet sot.

Qëllimi kryesor i nxjerrjes së rregullimit të ri është përsosja e rregullimit dhe përgjigja për kërkesat reale shoqëro-organizative, gjë që ky ligj nuk ka të bëjë fare me to apo ka të bëjë në mënyrë shumë të mjegullt me to. Kjo është arsyeja pse Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta votojë këtë projektligj në parim dhe, me këtë rast, i ftojme edhe deputetët tjerë të Kuvendit të Kosovës, duke u bërë thirrje që do të ishte shumë më mirë që ky ligj t’i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ç’rast të njëjtin ligj të fushës së njëjtë ta përgatisë në formën më përmbajtjesore dhe më cilësore dhe jo në këtë gjendje siç është sjell tani përballë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Berisha në emër të Grupit Parlamentar të Nismës. Nuk ka të paraqitur të tjerë në emër të grupeve parlamentare.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë se në Komision u debatua shumë gjatë rreth këtij projektligji dhe në fakt, ka pasur vërejtje shumë të arsyeshme dhe të argumentuara, për të cilat edhe vetë ministri është pajtuar, bile në disa edhe nuk ka mundur të japë përgjigje.

Ajo që mbetet shqetësuese, është se si shumë ligje të tjera edhe ky ligj ka ato defektet gjuhësore, domethënë mospërputhje ndërmjet gjuhës shqipe, angleze dhe serbe, që besoj se janë të tejkaluara. Në fakt, unë në Komision kam abstenuar, sepse thjesht nuk ka qenë në gjendje ministri të japë përgjigje në atë se ky ligj i ri bie ndesh me ligjet tjera, që e rregullojnë këtë fushë, sepse në rast se bie ndesh atëherë është dashur të hyjnë në pako ndryshimet ligjore, sa u përket procedurave të përgjithshme të administratës. Dhe, ajo që mbetet e paqartë në këtë ligj është rreth kostos financiare të ligjit, domethënë pasi të hyjë në fuqi, që nuk ka detaje dhe deklarata financiare.

Si do që të jetë, mendoj se meqë jemi këtu ku jemi, Kosova ka nevojë për ligje të mira, por besoj se deputetët sinqerisht do të angazhohen që brenda dy leximeve të japin kontributin dhe ligjin ta bëjnë ashtu, siç e kërkon edhe nevoja në shtetin tonë.

Me një fjalë, ne do ta mbështesim në lexim të parë me shpresë se shqetësimet tona dhe të deputetëve, që me të drejtë kanë reaguar edhe në Komision, do të merren parasysh dhe ligjin do ta bëjmë funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi vetëm edhe dy deputetë të paraqitur për diskutim. Në emër të grupeve parlamentare më nuk ka. Shqipe Pantina nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe Zenun Pajaziti, të bëhet gati.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Hartimi i legjislacionit dhe konformiteti i aktit të përpilimit, të përpiluar me akte tjera që janë në fuqi, është standardizim i legjislacionit. Ky standardizim shërben në rend të parë për unifikimin e

legjislacionit, si rend unik i juridiksuar dhe së dyti, është në shërbim të zbatimit të lehtësuar të aktit përkatës ligjor në veçanti dhe legjislacionit në përgjithësi.

Projektligji për procedura të përgjithshme administrative, të cilin sot jemi duke e shqyrtuar në lexim të parë është krejtësisht në shpërputhje me standardin legjislativ të Republikës së Kosovës. Gjuha e përdorur gjatë hartimit, përmbajtja dhe mënyra e përgjithshme e përpilimit të projektligjit nuk i përgjigjet, as standardit legjislativ e as materies të cilën duhet ta trajtojë ky ligj.

Në vijim po i paraqes në përgjithësi kritikën lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji. Duke filluar nga dispozita e parë, e cila në parim duhet të përmbajë nocionin e përgjithshëm të projektligjit, përkufizimi i tillë që gjendet në projektligj, respektivisht neni 1, nuk është as i drejtë e as i bazuar në vetë natyrën e të drejtës administrative, si degë e veçantë e të së drejtës. Qëllimi i këtij ligji duhet të jetë rregullimi i tërësisë së ushtrimit të kompetencave ligjore, që i janë besuar autoritetit publik, ose ndonjë subjekti tjetër, që ushtron këto kompetenca në bazë të autorizimeve ligjore, e jo siç është përkufizuar në këtë mënyrë.

Meqenëse, projektligji duhet të përmbajë një përshkrim diapozitiv mbi objektin e procedurës administrative, në kuptimin e përgjithshëm, pra çështjes administrative, ky projektligj nuk përmban fare një përkufizim të tillë. Mangësia e një përkufizimi të tillë është tregues më i mirë për cilësinë përpiluese dhe përmbajtjesore të këtij projektligji.

Për më tej, ky projektligj jo që nuk e ka të përkufizuar çështjen administrative, si objekt i procedurës administrative, por nuk i trajton as termit dhe akronimet e mundshme që mund të përdoren brenda tekstit ligjor, se çfarë kuptimi do të kenë në kontekstin e këtij projektligji.

Problemi tjetër konsiston në mangësinë e disa mjeteve procedurale, që do të ishin në shërbim të zhvillimit të procedurës. Ta zëmë, në këtë projektligj nuk është fare i paraparë konkluzioni si mjet procedural, i cili do t'i shërbente subjektit që zbaton procedurën administrative në procesin e nxjerrjes së aktit administrativ. Nuk janë paraparë as mjetet e ndërmjetme, siç është kërkesa për rishqyrtimin e aktit administrativ, procedurë kjo e cila do të ishte në ndihmesë të palës, ku pa shtjerrë mjetin e rregullt, do të thotë ankesën, do të kishte mundësi që në instancë remonstrative të kërkojë që akti i nxjerrë të shqyrtohet nga organi, i cili ka nxjerrë aktin ndaj të cilës është paraqitur kjo kërkesë.

Në këtë projektligj nuk janë paraparë as mjetet e jashtëzakonshme. Pikërisht, mangësia kryesore e ligjit aktual për procedurën administrative është mospërfshirja e mjeteve të jashtëzakonshme, si mundësi e posaçme procedurale. Kjo në masë të madhe do të ishte në përputhje me qëllimin eficient të procedurës, duke mbrojtur interesin e palës, që mos t'i shkaktohen shpenzime gjyqësore me rastin e kontestimit të ligjshmërisë së aktit.

Në anën tjetër, mjeti i jashtëzakonshëm do të mundësonte mbikëqyrjen instancionale të procedurës administrative, ku në një mënyrë kjo do t'i shërbente edukimit administrativ të organeve të administratës publike.

Mangësia tjetër konsiston në mos kategorizimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ. Me ligjin aktual me konsideratë dhe me mbështetje të teorisë juridike, mendoj se është në funksion të

zhvillimit të një procedure të drejtë, që të bëhet klasifikimi i pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative. Kjo do të vinte në veprim edhe organin administrative, por edhe palën në procedurë që të kujdesen dhe të jenë vigjilente, që arsyet për nulitetin e aktit administrativ të kujdesen që të dyja palët për pavlefshmërinë absolute, ndërsa të kujdeset 'ex officio' organi administrativ. Ndërkaq, për pavlefshmërinë relative të kujdeset vetë pala.

Në projektligj dispozitat të cilat rregullojnë legjitimacionin procedural, referenca është bërë drejtpërdrejt në të ashtuquajturin legjislacion civil. Ky lloj i referimit e tregon një cektësi profesionale dhe teorike, nga se në mënyrë të parazonuar ky referim nuk është i drejtë. Nëse flitet për trajtimin nga ana e legjislacionit civil, duhet specifikuar se aspekti i njohjes së aftësisë procedurale dhe aftësisë së veprimit në përgjithësi duhet t'i referohet legjislacionit që ndërlidhen me procedurën kontestimore dhe atë jo kontestimore.

Mirëpo, në instancë të fundit, çështja në fjalë do të duhej të rregullohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projektligji, duke marrë parasysh natyrën e veçantë të procedurës administrative. Projektligji tek neni 25 nuk flet për verifikimin dhe konfliktin e kompetencës. Duhet të kihet kujdes për rastet e konfliktit për kompetenca ndërmjet disa organeve, që për nga organizimi dhe themelimi nuk janë pjesë të së njëjtës hierarki, duke pasur parasysh ndarjen e pushtetit, në kuptimin e koncentrimin të kompetencave.

Këto dhe probleme të tjera, të cilat tashmë u përmendën edhe nga deputetët tjerë, sidomos ato gjuhësore, e bëjnë këtë projektligj që t'i kthehet sërish Qeverisë, në mënyrë që të gjitha këto mangësi të korrigjohen dhe pastaj të kthehet në Kuvend për miratim. Prandaj, si të tillë ne nuk mund ta votojmë.

KRYETARI: Zenun, të lutem, urdhëro!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Ministra,

Mendoj që amendamentimi i këtij projektligji nënkupton një fazë të rëndësishme të procesit të reformimit të administratës publike. Pajtohem plotësisht që ky është një lloj kodi, një lloj Kushtetute për administratën publike, por ne nuk kemi fare një fazë ku po mendojmë për ta ndryshuar konceptin ose modelin e Administratës Publike dhe për këtë besoj jemi të vetëdijshëm të gjithë.

Zoti Ferati ju shpjegoi në emër të komisionit që kemi pasur ndoshta në mënyrë të pazakontë një projektligj me disa apo numër më të madh të gabimeve teknike. Mund t'ju them këtu në seancë plenare se ka qenë këmbëngulja e ministrit dhe vendosmëria e tij që ta çojë agjendën e tij përpara për t'u përkushtuar më shumë për reformën e administratës publike. Pra, në komision jemi pajtuar bashkërisht që me një mbështetje shtesë teknike që do ta marrim edhe nga Qeveria pse jo, të punojmë që pavarësisht se do të ketë amendamente më shumë, kryesisht të aspektit teknik, këtë projektligj ta bëjmë më të mirë në mënyrë që të ketë mundësi Ministria përkatëse, gjegjësisht Qeveria, të përkushtohet më shumë në reformën e administratës publike, si një çështje që është goxha e ngutshme dhe po ashtu është një kriter në proceset tona integruese.

Personalisht kam marrë pjesë në një nga takimet ku partnerët si Komisioni Evropian, kanë kërkuar kryerjen e detyrave ose janë përkujdesur që të dimë e të marrim informata nga institucioni i ekzekutivit dhe institucioneve tjera për masat dhe zotimet që i kanë marrë për t'i kryer këto reforma.

Ky ligj është një prej ligjeve të rëndësishme dhe besoj se një zotim i yni që ta bëjmë me kohë nuk do të thotë që është edhe kjo mundësi e mirë që bashkërisht të bëjmë punën tonë.

Zoti ministër, ne kemi pasur edhe raste të tjera ku kemi pasur ligje ku më shumë se gjysma ndoshta janë amendamentuar dhe në këtë rast nuk kemi amendamente që janë debatuar në Komision që thelbësisht ndryshojnë konceptin, por janë kryesisht teknike dhe shikimet i kemi pasur të tilla, pavarësisht deputetët ose grupet që edhe nëse nuk e votojnë këtë projektligj, unë i lus që në komision të vijnë dhe t'i sjellin amendamentet e tilla, madje nëse ka edhe ide që versioni i parë qenka më i mirë se sa me këto propozime, ne nuk duhet të paragjykojmë se do t'i miratojmë ose jo ato amendamente, por megjithatë pajtohem plotësisht se ky ligj është ndër ligjet thelbësore, ndryshimi i të cilit mund të ndihmojë në reformën administratës publike, gjegjësisht mund të na mundësojë që të kemi një administratë më të mirë publike në vendin tonë. Ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Agim Ademaj e ka fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe kolegët deputetë,

Projektligji për procedurën e përgjithshme administrative konsideroj që nëse e heqim këtë pjesën e gabimeve ose teknike që po i quajmë, është projektligj i hartuar mirë dhe unë nuk mendoj se duhet apriori të hidhet, përkundrazi, është bindshëm më i mirë se ligji aktual i procedurës administrative që e kemi në zbatim që nga viti 2006 dhe ka risi në këtë projektligj.

Është e vërtet se ia vlen që ky ligj të plotësohet ndërmjet dy leximeve, sepse ka mundësi që të bihet në veti edhe më mirë, por jam i bindur se nuk do të ketë shumë amendamente në këtë projektligj, po them hiq ato teknike, se vërtet ka shumë gabime teknike dhe në përkthime.

Diku te neni, saktësisht neni 42 që flet për vendimmarrjet e organit kolegjal, te vendimet me procedurë qarkulluese përmendet edhe abstenimi dhe vota e paplotësuar që mendoj se këtu duhet të kemi kujdes që ta sqarojmë këtë nen, do të thotë nenin 42 se çka do të kuptojmë me votë të padeklaruar dhe abstenimi- thotë që merret votë kundër. Ishte dashur të sqarohet kjo situatë.

Edhe tek afatet ligjore në procedurë, duhet të kihet kujdes te festat zyrtare dhe ditët e vikendit, nuk përmenden atje se cila është dita pasuese.

Gjithashtu i mungon një institucion bazik, mendoj unë, është barazimi administrativ që nuk përmendet në këtë projektligj e që duhet të futet, sepse ndihmon shumë procedurat administrative.

Po e them prapë, në përgjithësi ligji është i punuar mirë. Kjo që kërkohet një vit, pasi të jetë i plotfuqishëm dhe të hyjë në zbatim, mendoj se është periudhë e gjatë, edhe pse organet

administrative duhet të përgatiten për zbatimin e tij, mirëpo periudha njëvjeçare mendoj se është e gjatë, nëse kemi parasysh që nuk ka kosto bazë, kosto financiare, atëherë mund të futet në zbatim pas 6 muajve, prej ditës së plotfuqishmërisë së tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi më deputetë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë, e dëshiron prapë fjalën? Jo!

Atëherë, të nderuar deputetë, në princip do të duhej në vazhdim të kërkohet deklarimi për votim për miratimin në parim të Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative, por do ta lëmë kështu, në orën 18 do të kemi votim për të gjitha projektligjet.

Kisha lutur shefat e grupeve parlamentare nëse ka mundësi, e ne do të shkojmë në diskutim në parim të projektligjeve dhe në orën 18:00 do të jetë votimi, se s'kemi kuorum. Aktualisht, vetëm mund të futemi në votim, por janë të pranishëm 51 deputetë. Në orën 18:00, pra...

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin Arsim Bajrami që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni zoti ministër.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që të bëj prezantimin e parë të Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Projektligji për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës është rishikim i ligjit të mëparshëm i cili është miratuar në vitin 2004 dhe 11 vjet paraqet një bazë të mirë për avancimin e standardeve të punës kërkimore-shkencore dhe ngritjen e krijimtarisë shkencore.

Ky projektligji në radhë të parë definon statusin e Akademisë, rolin e Akademisë, misionin e Akademisë, organizimin e saj si dhe funksionet tjera të Akademisë.

Më lejoni fillimisht t'ju theksoj se në bazë të këtij ligji Akademia definohet si institucioni më i lartë i shkencës dhe artit në Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, Akademia definohet si institucion i mëvetësishëm i cili për punën e vet i përgjigjet opinionit dhe Republikës së Kosovës.

Puna e Akademisë së Shkencës dhe Arteve mbi bazën e këtij ligji shpallet si punë me interes të veçantë publik. Interesi i veçantë publik konsiston në rolin prijës të Akademisë në nxitjen, zhvillimin dhe harmonizimin e punës kërkimore- shkencore dhe krijimtarisë artistike në Republikën e Kosovës.

Me rastin e hartimit të këtij ligji është ndjekur një praktikë e mirë legislative dhe parlamentare, sepse ky ligj gjithë kohën është hartuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve, pra institucionit të cilit ligji i dedikohet dhe institucioni, i cili do të merret me zbatimin e këtij ligji.

Ne si Ministri kemi shqyrtuar dhe kemi marrë parasysh shumë modele të akademive evropiane. T'ju kujtoj të nderuar deputetë se Akademia e Shkencave nga viti 2004 është anëtare e Akademive Evropiane, anëtare e Rrjetit 'Alea' dhe ky ka qenë ndoshta një sukses, sepse ende dhe shumë akademi nuk janë anëtarë të Akademisë.

Kemi marrë për bazë standardet e avancuara të rolit të akademive të Bashkimit Evropian, në mënyrë të veçantë kemi konsultuar modelin sloven me të cilin Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës ka një lloj binjakëzimi apo një lloj partneriteti në zhvillimin strategjik.

Ky ligj vendos shumë risi tek Akademia e Shkencave dhe Arteve duke e vendosur veprimtarinë e saj në disa institucione, fillimisht nëpërmjet seksioneve, nëpërmjet qendrave studimore. Për herë të parë parashihet themelimi i instituteve shkencore brenda akademive, si dhe përcaktohen një varg masash me të cilat do të avancohet puna kërkimore-shkencore e Akademisë.

Gjithashtu ka disa risi, disa kufizime, sepse kemi përcjellë debate publike, nganjëherë edhe joprofesionale për Akademinë dhe kemi vendosur disa kufizime që unë do t'i prezantoj dhe që paraqesin risitë kryesore të këtij ligji.

Risia e parë ka të bëjë me kufizimet sa i përket moshës për pranimin e anëtarëve të Akademisë dhe kemi vendosur një limit të moshës që pas moshës 65-vjeçare nuk mund të pranohet askush në Akademi. Kjo është në kuadër të përpjekjeve për t'i dhënë shans brezit të ri shkencor dhe për ta bërë Akademinë tonë me njerëz sa më të ri. Pra, askush në Akademi nuk do të pranohet pas moshës 65-vjeçare.

Është edhe një kërkesë e Rrjetit Evropian të Akademive që akademitë të jenë sa më shumë me njerëz të rinj, me shkencëtar të rinj në mënyrë që atyre t'u jepet një kohë që ata të kontribuojnë për shkencën dhe për shtetin duke qenë të rinj në akademi dhe duke kontribuar.

Pastaj e kemi vendosur limitin e moshës kur anëtarët e Akademisë mund të kenë funksione udhëheqëse dhe kemi vendosur se pas moshës 75-vjeçare, asnjë anëtar i Akademisë nuk mund të ketë funksione udhëheqëse në Akademi, siç është kryetari i Akademisë, nënkryetari i Akademisë apo udhëheqës i seksionit në Akademi.

Dhe kufizimi i tretë, është kufizimi që askush që është në poste politike nuk mund të ketë asnjë funksion udhëheqës në Akademi.

Këto tri kufizime vijnë si rezultat i bashkëpunimit tonë që e kemi me Akademinë Evropiane të Shkencave dhe janë plotësisht me trendet evropiane.

Vlerësojmë se ky ligj promovon plotësisht autonominë dhe mëvetësinë e Akademisë, që është një institucion specifik, një institucion që praktikisht duhet t'i përgjigjet masës kritike shkencore,

por jo politikave dhe institucioneve shtetërore. Pra, vlerësojmë se këto ndryshime krijojnë një ekuilibër të mirë, midis asaj çka është interesi publik në fushëveprimin e Akademisë dhe punës shkencore, duke rregulluar këtë krejt në çështje parimore por në hapësirë të mjaftueshme që nëpërmjet akteve të brendshme të Akademisë, siç është Statuti i Akademisë, rregulloret e Akademisë, të rregullohet funksionimi i pavarur i kësaj Akademie duke filluar nga procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, që janë procedura krejtësisht të brendshme e deri te organizimi dhe funksionimi i tri organeve kryesore të Akademisë, fillimisht Kuvendit të Akademisë që është organi kryesor, pastaj Kryesisë së Akademisë dhe kryetarit të Akademisë dhe çdo kund në trendët evropiane dhe në Akademistë Evropiane këto janë çështje të brendshme dhe lejohet plotësisht mundësia e akademive të shkencave që këto çështje t'i adaptojnë sipas traditave të veta shtetërore.

Vlerësoj se ky ligj do të paraqesë një bazë të mirë edhe për ngritjen e standardeve të punës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve, për ngritjen e produktivitetit, për ngritjen e krijimtarisë shkencore, sepse Akademia është një institucion i themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe i financuar nga buxheti i Kosovës dhe është në obligim të Akademisë të arsyetojë punën e vet shkencore me kërkime shkencore, me kërkime produktive, me kërkime që nisen me iniciativën e vetë Akademisë, me iniciativën e shoqërisë po pse jo edhe me iniciativën e institucioneve shtetërore të cilat në projekte kapitale shkencore mund të kërkojnë edhe mendimin e Akademisë.

Andaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta votojmë në leximin e parë këtë projektligj dhe pastaj të punojmë së bashku me Komisionin parlamentar i cili e ka përkrahur në parim, anëtarët e Komisionit janë në një vizitë zyrtare në Gjermani dhe nuk janë sot të pranishëm, por ata e kanë përkrahur në parim dhe jemi të gatshëm si Ministri të përfshijmë të gjithë aktorët dhe gjatë leximit të dytë ta avancojmë edhe më tepër këtë projektligj dhe të sigurojmë vërtet një ligj të mirë i cili do të mundësojë një zhvillim afatgjatë të Akademisë së Shkencave dhe një përparim të standardeve të punës kërkimore- shkencore dhe të krijimtarisë artistike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Të nderuar deputetë, pas këtij prezantimi të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim. Kryetari i Komisionit funksional nuk qenka këtu. Glauk, a jeni ju në Komision? Për Komisionin, kush e do fjalën? Askush nuk është. Komisioni ka shkuar në udhëtim.

Shkojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose kryetarët. Nezir Çoçaj, nga Partia Demokratike e Kosovës, është lajmëruar.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe si të tillë do ta përkrahë dhe miratojë.

Po ashtu, në fazën e më tutjeshme, do të japim kontributin tonë gjatë amendamentimit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka fjalën Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!
Si lojtar rezervë që jam, do të shprehem shkurt!

Unë e përshëndes ministrin që e ka proceduar këtë ligj. Këto tentime e kanë pasur edhe një historik. Më vjen mirë që kjo formë e hartimit e ka krijuar një pajtueshmëri.

Ne kemi pasur diskutim edhe në grupin parlamentar dhe kemi shprehur përkrahjen tonë në qasjen që e ka ministri. Ne do të bashkëpunojmë dhe sot si Grup Parlamentar i LDK-së do ta votojmë ligjin në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Problemi më i madh i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në të kaluarën dhe deri sot, kurrë nuk ka qenë le të themi një ligj jofunksional, apo problematik. Problemi më i madh dhe fundamental i Akademisë së Shkencave ka qenë që shumë më tepër se sa e rregulluar nëpërmjet ligjit, aty kanë vendosur disa lidhje miqësore apo raporte të caktuara ndërmjet akademikëve, shumë më tepër se sa që i ka rregulluar këto çështje ligji. Dhe, unë mendoj që prej kësaj ka vuajtur shumë Akademia e Shkencave, thënë të drejtën.

Por, sa i përket ligjit, i cili na është sjellë këtu përpara, edhe ai nuk është pa defekte, të cilat janë më shumë të karakterit të mungesës së shpjegimeve më të thella.

Për shembull, neni 6, ku flitet për statutin, e bën një prerje shumë të fortë ndërmjet të statutit edhe Ligjit për Akademinë e Shkencave, duke thënë që gjithçka sa i përket organizimit, mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve, organeve dhe strukturës së Akademisë do t'i lihet statutit. Unë mendoj që nuk është mirë kështu, sepse do të ishte e nevojshme që ligji të përfshijë më shumë prej këtyre tri fushave të përmbledhura në mënyrën më themelore, të përshkruara në ligj se cilat janë këto organe, qysh është mënyra e zgjedhjes e të tjera, dhe statuti vetëm t'i zbërthejë ato në hollësi të mëtutjeshme, e jo që gjithçka t'i lidhet statutit, sepse atëherë mendoj që do të kemi probleme, ngase statuti i Akademisë nuk vjen në Kuvend. Kështu që po i lihet shumë mundësi, ma merr mendja, edhe Ekzekutivit në këtë mënyrë të vendosë shumëçka për akademinë pa e pasur mundësinë vetë Kuvendi që ta japë mendimin për këtë çështje.

Sa i përket nenit 6, pika 3, thuhet që Akademia ka akte të tjera të përgjithshme me të cilat në harmoni me statutin e saj i rregullon çështjet e rëndësishme për punë dhe afarizëm. Thënë të drejtën, nuk më duket hiç që fjala “afarizëm” i shkon Akademisë. Fjalët “afarizëm” e “komercializëm” nuk shkojnë bashkë me Akademinë e Shkencave dhe Arteve, thënë të drejtën. Ma merr mendja se duhet të gjenden terma më të përshtatshëm, të cilët nuk nënkuptojnë veprimtari përfituese profitabile, apo sido që t'i quajmë ata.

Sa i përket nenit 10, pika 1.5 dhe 1.6, kur shpjegohet se cilat janë ato fushat e angazhimit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në pikën 1.5 dhe në pikën 1.6 përmendet zhvillimi i vlerave kulturore dhe trashëgimia gjuhësore, kurse në pikën 1.6 përmendet zhvillimi i kulturave të Kosovës. Këtu po përdoren disa terma shumë abstraktë dhe shumë të përgjithshëm - kultivimi i gjuhëve dhe zhvillimi i kulturave të Kosovës. Çka janë kulturat e Kosovës? Domethënë, është termë shumë i përgjithshëm. Shumë abstrakt.

Mua ma merr mendja që Akademia e Shkencave, ajo çka i ka munguar deri më tash, është le të themi një fokusim në fushat deficitare, ku ne kemi deficit, thënë të drejtën, edhe të aspektit profesional, edhe të analizave të mirëfillta e të thella për Kosovën. Ta zëmë, njëra prej tyre është ekonomia. Ne nuk kemi studime shumë të thella ekonomike për Kosovën, të cilat janë të nivelit akademik, të cilat mund t'i përkthesh edhe në gjuhë të tjera, që edhe të tjerët ta dinë strukturën ekonomike të Kosovës, zhvillimin e saj, traditën e saj, e kështu me radhë. Për shembull, pse të mos përmenden këto fusha në mënyrë eksplicite, ku ne jemi deficitarë në përgjithësi.

Pastaj, në vazhdim, te neni 11.6, për shembull, kur flitet për mënyrën e organizimit të strukturës së brendshme të Akademisë, thuhet “punën e njësive shkencore dhe artistike instituteve hulumtuese dhe qendrave të tjera studimore e drejton drejtori, ose organi përkatës drejtues”. Mua ma merr mendja që disa terma tjerë më shumë i shkojnë Akademisë, për shembull “jo drejtorët e Akademisë”, Akademia me drejtorë, por me drejtues. Dhe, “të njësive shkencore” është shumë më mirë, kurse “të njësive artistike” po më duket shumë problematike. Çka janë njësitë artistike? Në Akademi ekziston një njësi artistike. Njësi artistike mund të jetë një orkestër, një trupë e baletit, a një ansambël e kështu me radhë, ama “njësi artistike” po më duket pak si termë le të themi paradoksal dhe problematik, nëse duan ta përshkruajnë një departament. Nëse e përshkruan një departament të një institucioni, qysh është në këtë rast Akademia e Shkencave, “njësia artistike” nuk më duket gjetja më e duhur.

Pastaj te neni 14.1, thuhet që miratimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera normative, që e rregullojnë marrëdhënien e caktuar nga veprimtaria e Akademisë, këtu kur po thuhet “akte të tjera normative”, mendoj që është lënë një hapësirë shumë e madhe me të cilën nuk po them që manipulohet, por mund të manipulohet.

Dhe, çështja e ligjeve është që të mos lihen mundësi, sepse kur lihen mundësitë, pastaj edhe ngjarjet zakonisht ndodhin.

Kështu që duhet të ceket se çka janë këto “akte të tjera normative”. Qysh ka kompetencë Akademia edhe për këto akte të tjera normative?

Te nenin 15.2, thuhet kështu: “për miratimin e statutit të Akademisë, për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit shkencor të Akademisë, për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë dhe të anëtarëve të jashtëm të Akademisë, është e nevojshme shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë”.

Unë mendoj, meqë këtu edhe vetë ju jeni dëshmitarë si deputetë dhe si ministra, qysh kemi pasur shumë problem edhe në Kuvendin e Kosovës nëse nuk precizohet bash saktë, çka është ajo, qysh votohen ligjet, qysh votohen vendimet? Në këtë rast, qysh merren vendimet dhe qysh zgjidhen kryetari e sekretari në Akademi, me çfarë lloj shumice absolute, të kualifikuar, të thjeshtë, të të gjithë të pranishmëve, të të gjithë anëtarëve, pavarësisht nëse janë të pranishëm apo jo, e kështu me radhë. Nëse nuk i specifikojmë shumicat, mendoj që ju dalin probleme siç na kanë dalë edhe neve këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mendoj që ka hapësirë për stërhollime aty, të cilat janë shumë të nevojshme.

Neni 16.5 thotë që “drejtues në Akademi apo në funksione udhëheqëse nuk mund të jenë anëtarët e Akademisë, të cilët kanë moshë më të vjetër se 75-vjeçare”. Po ma merr mendja që ky është një diskriminim, për arsye se unë mendoj që në këto institutet, akademitë e ndryshme të shkencës, të arteve, vlerësimi fundamental do të jetë zotësia dhe kompetenca. Nuk ma merr mendja që në Akademi duhet të jetë kriter moshë, në kuptimin e të qenët edhe të pasurit të drejtë për të kandiduar dhe për t’u zgjedhur. Ma merr mendja që është një kufizim i paarsyeshëm edhe duke pasur parasysh që, le të themi, karriera akademike pak e kërkon edhe njëfarë përvojë dhe është e vonshme në jetën e njeriut, le të themi, sepse arritjet priten që të jenë për disa dekada që, më në fund, të bëhesh akademik. Kështu që mendoj që nuk më është dukur e drejtë që të jetë një kriter i vendosjes të kufirit të moshës sa i përket të drejtës për të kandiduar dhe për t’u zgjedhur.

Dhe, në fund, te neni 19.3 thuhet kush mund të zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave. Aty është një përcaktim, që mua më duket problematik në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia mos ia ndal, për çështje akademike e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: ...më duket problematik në kuptimin se kush i vendos kriteret, se këtu shkruan për shembull “punonjës të shquar dhe me peshë”. Tash kjo “të shquar dhe me peshë” - kush është ai që vendos kush është i shquar dhe kush është me peshë, dhe kush nuk mund të anëtarësohet në Akademi, sepse është i papeshë dhe i pashquar?

Unë mendoj që këtu duhet të gjenden formulime më elegante, le të themi, në kuptimin e kriterëve se këtu diqysh po më duket sikur këtë ligj ta ketë shkruar dikush që veten e konsideron shumë të rëndësishëm aty dhe e ka shkruar këtë ligj për të tregua që pa qenë si unë me peshë dhe i shquar askush nuk mund të bëhet anëtar i Akademisë. Kjo ma merr mendja që është problematike, në përgjithësi, prandaj duhet të ndryshohet.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro! Shqip Muja e ka fjalën.

SHAIPI MUJA: Mundësisht, pasi është çështja akademike, Sekretaria të mos na e ndërpres fjalën, se do të shkojmë pak më ngadalë. Mund t’ia qëllojmë ndoshta diçka, se unë jam i befasuar që erdhi ligji këtu, sepse zoti Bajrami e pati tërhequr ligjin pa e pyetur askënd në emër të grupit parlamentar në mandatin e kaluar dhe duke e lexuar ligjin e kaluar dhe këtë sot, unë mendoj se dy herë e ka pasur më drejt që sot ta tërheqë këtë ligj, të mos vinte ky ligj fare.

Janë disa arsye pse unë po e them këtë, ndoshta jam i gabuar, por më pastaj kur u tërhoq ligji, zoti Bajrami u shpërblye si anëtar, edhe zoti Isa Mustafa, si anëtar i Akademisë dhe duke e parafrazuar Rexhep Qosjen që thotë ‘zgjidhen akademikë pa vlera akademike’, hyra në ‘Google Scholar’, e nuk i kap as ajo askund shpjegimet, apo botimet e tyre, që janë bërë anëtarë.

Prandaj, Akademia e Shkencave mendoj se sot është duke bërë anëtarë për qëllime klanore dhe ne duhet të shohim si obligim që po e formojmë një institucion për interesin e dikujt.

Nëse lexohet me vëmendje, duke filluar nga politika e financimit të Akademisë, siç quhet për shembull nga aspekti juridik, edhe zoti ministër është jurist, dhe me ligjet e Kosovës nuk ka shpërblim në njësitë publike të Republikës së Kosovës, por ka pagë, e cila është e përcaktuar me ligj, ose pagë primare dhe pagë sekondare.

Prandaj, çështja e shpërblimit, 'de fakto' ia jep një autonomi dhe raportimi financiar i Akademisë nuk paraqitet askund, por aq më shumë edhe nga problemet tek auditimi.

Në pikat e zgjedhjes së seksioneve, kjo akademi sot momentalisht ka 80% gjuhëtarë dhe shkencat, meqë po flasim shumë me gojën plot për Bashkimin Evropian, shtetet që aty kanë sot emër shkencor dhe që referohen me universitetet e veta kanë 60 deri në 70% akademikë të shkencave të forta të natyrës, të teknikës, të mjekësisë dhe të arteve. Kurse te ne është e kundërta, e me këtë është bërë një lloj uzurpimi i Akademisë, i cili ne edhe me këtë ligj, derisa të vdesin gjithë këta akademikë, nuk mund t'i zhvendosim, e po flasim që do t'i sjellim të rinj.

Prandaj, ligji i kaluar ka qenë më i mirë se ky. Ju e keni tërhequr pa bazë, sepse ju vetë i dini arsyet kur është caktuar në sesione. Pse të mos jenë 12 anëtarë të seksioneve të shkencave të forta, të shkencës së natyrës, të teknikut dhe të mjekësisë. Pse të mos jenë katër anëtarë të arteve, siç kanë qenë në ligjin e kaluar. Këto janë çështje të cilat ne duhet t'i diskutojmë dhe t'i bashkëbisedojmë këtu.

Dhe, pastaj kufizimi i numrit të anëtarëve. Sa anëtarë duhet të jenë aktivë dhe sa anëtarë duhet të jenë me korrespondencë. Siç tha Glauku, edhe çështja e anëtarëve me korrespondencë në votimin e emërimit mund të bëhet me pazare ditore, të cilat njerëzve u interesojnë për vota.

Pastaj te çështja e përzgjedhjes së kandidatëve në Akademinë e Shkencave, pse asnjë akademik sot në Republikën e Kosovës në recension të mos përcaktohet me ligj që ta ketë edhe nga një akademi, meqë po thirremi nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për zgjedhjen anëtar i Akademisë? Pse? Sepse frikohemi se s'kemi çfarë t'i japim shkencës. Ne kemi çfarë t'u japim vetëm klubeve që të bisedojmë vet me vete. Pse unë e kundërshtoj, ndoshta jam i gabuar, por unë nuk e di që Akademia si njëri ndër institucionet avangarde të dijes duhet të jenë sot edhe botues i shumë udhëzimeve shoqërore, politike, ekonomike në Republikën e Kosovës. E ajo, jo që s'është udhëzuese, por ajo nuk ka prodhuar asgjë.

Unë mendoj që këta akademikë që do të më shohin sigurisht do të bëjë dikush reagim, siç bënë para do viteve për Ramë Vatën, kur kryetari Akademisë i reagoi për turp, duke iu drejtuar se 'kush je që të më reagosh t'i mua', por 'unë jam ai që t'i po ma kërkon votën dhe kur e kërkon votën ta kthej shpinën dhe s'ta jap as mundësinë që të angazhohesh'. Do të thotë, ti sot e kërkon nga unë votën dhe po thua të mos më kontrollojë askush. Kjo akademi duhet të kontrollohet. Jo të kontrollohet që të ndryshojë nga misioni i vet, por me këtë ligj t'ia japim një luks kësaj akademie, e cila jo që do ta keqpërdorë më shumë, por do ta klanizojë edhe më shumë Akademinë, seç ishte deri më tani.

Më thuaj, zoti ministër, cili është materiali, me cilin ju mburreni në institucionet politike ndërkombëtare për vërtetësinë e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i financuar nga Akademia? Unë nuk e di. Unë nuk di as fëmijës tim çfarë t'i them që ka botuar Akademia e

Shkencave të Kosovës sot si vlerë dhe për këtë arsye ne e kemi një situatë të tillë, kur sot flitet gjithçka, e nuk thirremi në referenca. Prandaj, ne nuk duhet ta votojmë këtë ligj. Unë mendoj që duhet të kthehet ky ligj, nuk është as komisioni këtu dhe nuk bëhet nëmi. Është dashur t'i sillni, zoti ministër, një pesë universitete të ndara me ligj më shpejt, e ju nuk e keni në plan t'i sillni ato pesë universitete.

Sot Universiteti i Republikës së Kosovës "Hasan Prishtina" është një gjigant, i cili e ka monopolizuar dhe e ka centralizuar punën shumë të madhe në degë të tjera. Është më mirë të ndahet Fakulteti i Shkencave Mjekësore urgjentisht sesa të bëhet Ligji për Akademinë. Ç'është mirë të bëhet ndarja e Fakultetit të Shkencave Teknike, sepse ata janë duke humbur çdo ditë e më shumë në këtë bashkëjetesë me këtë formë të gjigantit, i cili nuk po i menaxhon as shkencat gjuhësore, e lëre më ato tjerat.

Është mirë të ndahet Akademia e Arteve. Artistëve të Republikës së Kosovës, zoti ministër, u kanë ndenjur në Morinë pikurat me ditë të tëra nga Dogana për shkak se nuk keni mundur të bëni zgjedhjen për ekspozita të cilat janë brenda llojit tonë, që quhemi shqiptarë.

Është mirë që Fakulteti i Bujqësisë me degët e veta të shndërrohet në universitet dhe atëherë duhet të shihet kompetenca dhe rivaliteti intelektual ndërmjet universiteteve dhe të themi se jemi në konkurrencë me botën. Por, jo të krijojmë fantom-organizime, të kërkohen votat me lobime dhe për interesa të disa individëve të bëhen akademikë.

Unë mendoj që asnjëri nga ju profesorët nuk jeni pa rroga e pa bukë. Jeni mirë profesorë, por nuk është mirë edhe të fuqizoheni, që të vijë nesër Isa Mustafa kryetar i Akademisë, ose ti zëvendës, ose dikush tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Bajrami përsëri e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

Dëshiroj t'i falënderoj grupet parlamentare për mbështetje, e natyrisht nuk do të merrem me opinionet e folësit të fundit, por do t'u referohem pak disa propozimeve konstruktive të deputetit Konjufca, sepse dha disa propozime që vlejné të shpjegohen këtu, e që mund të jenë bazë për punën e mëtejshme në leximin e dytë.

Vlerësimet për Akademinë e për Universitetin janë vlerësime madhore, kështu duhet lënë njerëzve që janë kompetentë për t'i dhënë ato, sepse sa më shumë që të flitet në Parlament për Akademinë dhe për Universitetin, aq më ulët do të jenë ato, dhe duhet një kod moral që ta kemi një kulturë të sjelljes, sepse janë institucione prestigjioze dhe duhet lënë pak një masë kritike që të ekzistojë në Kosovë ende pa e shkatërruar.

Dëshiroj t'i jap disa sqarime, sepse pati disa propozime shumë interesante nga deputeti Konjufca, dhe e pashë që ai e ka lexua me shumë vëmendje dhe pati edhe vërejtje konkrete, të cilat me siguri do të merren nga Komisioni për Arsim, i cili e ka përkrahur në parim dhe i cili do të punojë bashkë me ne në përmirësimin e kualitetit të këtij ligji.

Çështja e parë, si ta krijojmë balancën ndërmjet asaj çfarë rregullon ligji dhe çka rregullon statuti. Kjo është shumë me rëndësi, sepse ju për një muaj do ta keni Ligjin për Universitetin, për arsimin e lartë, dhe qysh tani ju premtoj se do ta keni ndër ligjet më të mira në Evropë, sepse kemi angazhuar ekspertë prestigjiozë dhe absolutisht nuk do ta lëmë tash tendencën e krijimit të problemeve në Universitet me kërkesa për hapjen e disa universiteteve. Njëherë këto që i kemi ndërtuar duhet t'i mbajmë me standarde. Duhet ndërtuar standardet, sepse nuk është problem për ta hapur një universitet, por unë e di se çfarë probleme kemi për t'i mbajtur këto me standarde, sepse ne mund t'i hapim edhe 10 të tilla, por edhe këto që i kemi s'po mund t'i mbajmë me standarde evropiane, me standarde të cilësisë.

Kështu që duhet të jemi shumë të kujdesshëm, që duke e riorganizuar Universitetin e Prishtinës, për çka është një projekt nga koha kur unë kam qenë rektor, të mos e shkatërrojmë Universitetin e Prishtinës dhe ka filluar dialogu i brendshëm në Universitetin e Prishtinës. E kemi filluar me të gjithë rektorët, me gjithë dekanët, që ne vetë jemi të vetëdijshëm që duhet të riorganizohet Universiteti i Prishtinës, por ky proces nuk do të zhvillohet në Parlament, por duhet të bëhet në Universitet, duhet t'i lihet atij që ta zhvillojë.

Te çështja që e shtroi deputeti Konjufca, është shumë me rëndësi që ligji t'i rregullojë çështjet parimore, çështjet esenciale, çështjet që rregullohen me të gjitha ligjet për akademinë në Evropë. Mirëpo, duke qenë që Akademia është institucion i mëvetësishëm, edhe më i mëvetësishëm se Universiteti, atëherë nuk do të kishte kuptim mëvetësia dhe autonomia në qoftë se nuk i njihet që me statutin e saj t'i rregullojë çështjet e zgjedhjeve të brendshme.

Sepse, po ju tregoj nga përvoja, nuk ka proces më të komplikuar të zgjedhjeve se sa në Akademi. Nuk mund askush të hyjë pa pesë votime. Ka këtu shumë profesorë të Universitetit që i dinë këto. Duhet pesë votime për të trokitur në derën e Akademisë, e dera e parë është katedra e fakultetit. Katedra duhet të të propozojë. Dera e dytë është fakulteti, apo Këshilli Shkencor i Fakultetit. Pra, fillimisht duhet të vish nga fakulteti, reputacioni yt - ke apo s'ke reputacion, vjen nga politika apo nga shkenca, e vlerëson mjedisi ku punon. Dhe, askush nuk mund të hyjë në Akademi, në qoftë se nuk përkrahet nga katedra ku punon. Kur ta kalosh katedrën duhet nga Këshilli i Fakultetit, e kur ta kalosh atë, duhet nga seksioni i Akademisë. Duhet ta kalosh pastaj tekstin e kritikës. Një muaj ditë çdo kandidat është i hapur për kritikë. Dhe, votimi i pestë është në Kuvendin e Akademisë. Nuk ka zgjidhje më të komplikime se sa në Akademi. Nuk ka zgjedhje më të gjatë dhe më transparente.

Ne dëshirojmë që këto zgjedhje t'i rrisim sa më shumë me standarde. Është e vërtetë se mund të ketë gabime terminologjike, që ju i përmendët, po ju siguroj se në hartimin e këtij ligji kanë punuar gjuhëtarët më të mirë që ka Kosova, gjuhëtarët më të mirë që i ka Kosova dhe që kanë ndërtua emër në shkencën e albanologjisë, doajenët e albanologjisë, por unë do ta kërkoj sërish edhe një herë mendimin prej tyre, nëse këto shprehje janë më të mirat të mundshme. Por, kur përmendët shprehjen 'drejtor', mendohet për drejtorët e instituteve që do të themelohen, sepse Akademia do të ketë institute shkencore në fusha bujqësore, në fusha teknike, në fusha aplikative dhe është krejt normale çdo kund në botë institutet kanë drejtorë. Nuk kanë as shef, as rektor, por ata janë drejtorë.

Jam i sigurt se ka vend për përmirësime, jam i sigurt se bashkë me të gjitha partitë politike mund t'i bëjmë edhe disa përmirësime, në mënyrë që ky ligj vërtet të jetë një ligj që do t'u qëndrojë, jo viteve, por ndoshta edhe dekadave, por edhe që do të kërkojë më shumë nga Akademia. Do të kërkojë që ajo të jetë më produktive dhe më e begatë në punën e vet shkencore.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muja, e kërkon fjalën, por nuk e di pse, se nuk të ka përmendur. Urdhëro!

SHAIP MUJA: Zoti Bajrami, unë quhem Shaip Muja, nëse parafolësit nuk ia përmende emrin. Unë t'i shtrova disa pyetje, në të cilat nuk u përgjigje, dhe normalisht që nuk mund të përgjigjesh, sepse derisa mbron interesat personale nuk mund t'i përfaqësoni interesat kolektive të Republikës së Kosovës. Këtë e kam thënë publikisht. Ju e keni tërhequr një ligj, i cili saktëson shumë pika të cilat nuk lajnë mundësi për abuzime. Ju po e sillni një ligj, për të cilin shumica e deputetëve, këtu po më vjen keq që po them, por nuk janë të fokusuar, sepse nuk u ka ardhur koha të bëhen akademikë. Fatkeqësisht, po bëhen akademikë edhe profesorë dhe ju po thoni 'jemi me prestigj të lartë si Universitet'.

Universiteti i Kosovës është dashur të ndahet. Akademia është dashur të prodhojë çdo vit së paku nga një qëndrim institucional për rrjedhat politike, zhvillimore e ekonomike dhe të gjitha politikat të cilat janë në interes të publikut të Republikës së Kosovës.

Ju thoni për shpërblimet, nuk e dimë, por ka ligj, e ju jeni thirrur në ligj, në nene brenda, por nuk quhen shpërblime. Quhet financim. Raportimi bëhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe auditimit i shtohet i shtohet si rregull, kurse ju paraqiteni sikur po u afroheni standardeve të Bashkimit Evropian. S'ka standarde për akademitë. Është e dëshirueshme dhe e aplikueshme sipas shteteve, por nuk ka ligj në Bashkimin Evropian për akademinë. Ne nuk po i shohim akademikët ku janë duke marrë pjesë nëpër akademi për tema të veçanta e shkencore në nivel evropian. Mua s'më ka rënë të shoh, përveç sportistëve, siç është Majlinda deri sot më e mira. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministri e ka sërish fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Vërtet nuk kisha dashur fare të polemizoj dhe asnjëherë nuk do të polemizoj për çështje për të cilat nuk jam kompetent, për shembull kurrë nuk e marrë të drejtën të flas për mjekësi.

Arsyeja pse është tërhequr ligji i mëparshëm është nuk ka pasur reforma, s'ka pasur kufizime. Vërejtjet e opinionit kanë qenë që akademia jonë, ose është e mplakur, ose e politizuar, dhe tash i kemi tri kufizime shumë të rëndësishme, që do të mundësojnë që në akademi të kemi 40-vjeçarë, njerëz të rinj që do të jenë produktivë.

Mos mendoni që akademikët duhet të marrin rrogë. Në momentin kur dikush zgjidhet akademik në krejt botën, ai merr çmim shtetëror, që quhet shpërblim. Në krejt botën është kështu. Kur e merr thirrjen 'akademik', ai nuk merr vend pune, por ai e merr një mirënjohje për karrierën e vet akademike dhe vetëm në Bashkimin Sovjetik, në kohën e Stalinit, kanë marrë rroga. Kurse në të gjitha akademitë e botës këta marrin shpërblime, që janë çmime.

Sa i përket Universitetit, unë si ministër sa herë kam dalë para jush, kam thënë se gjendja e cilësisë në Universitet është e dobët dhe asnjëherë nuk jam lavdëruar, duke thënë që ne jemi të parët me cilësi. Nga dita e parë kam qenë i sigurtë dhe ju kam thënë që ne duhet të punojmë shumë në ngritjen e cilësisë në krejt sektorin e arsimit, e sidomos të universiteteve. Por, këtë do ta bëjmë me një qasje shumë profesionale, shumë të përgjegjshme dhe shumë serioze, e kjo është duke ndodhur.

Ne kemi fituar besim tek Universiteti. Kemi fituar besim edhe te ata që kanë kërkuar ndarje për të fituar poenë dhe u kemi thënë po, do të ketë ndarje, por do të ketë kur të ketë konsensus akademik, kur për këtë vendos Universiteti, e jo Parlamenti i Kosovës. Ka fillua ky proces dhe Kuvendi do të jetë i njoftuar në detaje kur ky proces të finalizohet në Universitet. Nuk do të ndërhyjmë ne si deputetë tash në krijimin e universiteteve të reja të mjekësisë e teknikut, por këtë çështje do t'ua lëmë njerëzve të Universitetit, dekanëve, që ata ta zgjidhin këtë çështje dhe unë e kamë çuar debatin në Universitet.

Nuk është korrekt që ne këtu prej zyrave tona këtu në Parlament dhe në Qeveri të involvohemi në krijimin e universiteteve. Kjo çështje duhet të vendoset dhe ky proces ka filluar.

Unë i kam takuar të gjithë propozuesit e projektit për krijimin e Universitetit Mjekësor, Teknik, të Arteve, dhe çdo ditë jam në kontakt me ta dhe e kemi ndërtuar një dialog të përditshëm. E kemi caktuar agjendën dhe të jeni të sigurt se të parët që do të njoftohen me këtë strategji që unë kërkoj - miratimi në Parlament, do të jetë Kuvendi i Kosovës, sepse ky është një projekt i madh, por absolutisht nuk do të lejojmë që këto çështje të improvizohen. Nuk do të lejojmë që duke e rregulluar ta shkatërrojmë gjendjen, edhe ashtu jo të mirë nëpër universitete, sepse këta 6 muaj mezi kemi arritur t'i stabilizojmë trendet në universitete.

E dini që ne para 8 muajve këtu kemi diskutuar dy ditë për universitetet. Ka pasur protesta, ka pasur demonstrata, ka pasur gjithçka. Tani e 6 muaj e keni parë një trendë të stabilizimit, e keni parë që është kthyer një besim, që mund të reformohet arsimi i lartë dhe do të punojmë bashkë me ju që këtë ta bëjmë. Por, kurrsesi tash që ne me dëshirat tona të ndërhyjmë në ato procese atje, sepse proceset janë krejtësisht akademike dhe duhet të zhvillohen sipas standardeve akademike.

KRYETARI: Faleminderit! Diskutimet kanë përfunduar. Do të duhej që edhe këtë ta votojmë në parim në orën 17:30-18:00, kur të bëhet kuorumi.

Shefat e grupeve parlamentare, në qoftë se ka mundësi, t'i thërrasin deputetët, pasi nuk kemi kuorum. Aktualisht jemi 53 veta.

11. Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për shqyrtim.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media e ka shqyrtuar raportin e rregullt të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dëshiroj të theksoj që si Kuvend kemi pasur edhe debat paraprak, të kërkuar para se të shqyrtohet raporti, e ky kuvend për çështje të ngjashme ka debatuar edhe kohë më parë.

Pavarësisht se ka pasur dallime sa i përket trajtimit të këtij raporti, komisioni ka vendosur që t'i kërkojë për aprovim Kuvendit raportin e rregullt të Radiotelevizionit të Kosovës.

Po ashtu, dëshiroj të them që në mandatin e kaluar, ose për vitin paraprak, raporti i Kuvendit ka mbetur në Kuvend pa mundësinë që të trajtohet, pra e kemi një mungesë të një raporti, një raport tjetër po ashtu i paaprovuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Përveç tjerash, dëshiroj të theksoj që debati më i madh ka qenë rreth çështjeve financiare, kemi kërkuar që edhe Komisioni për Buxhet edhe Financa ta trajtojë dhe është trajtuar me kompetencë më të madhe nga ky komision.

Po ashtu, dëshiroj të them që para vetes tash e kemi edhe një raport tjetër me interes - raportin e Auditorit Gjeneral. Dëshiroj të theksoj që ky raport ka nxjerrë një rekomandim edhe për Kuvendin e Kosovës. Përveç atyre rekomandimeve që i ka nxjerrë për çështje të ndryshme menaxheriale dhe të tjera të Radiotelevizionit, edhe ky rekomandim është që Kuvendi i Kosovës duhet më shumë t'i ushtrojë kompetencat e veta në mbikëqyrjen e këtij institucioni.

Para se ta mbyll fjalën time si kryetar i komisionit, janë dy çështje të rëndësishme për këtë vit sa i përket Radiotelevizionit të Kosovës. Është fjala për amendamentimin e Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës. Është shumë me rëndësi që ne si Kuvend të vendosim se si do të financohet, sepse aktualisht e dimë që ka skaduar ligjërisht mënyra e financimit. Ne këtë vit, këta muaj që po i kalojmë, Radiotelevizioni i Kosovës është pa përzgjedhje ligjore të mënyrës së financimit.

Ne duhet ta kryejmë amendamentimin e ligjit gjatë këtij viti. Ne e kemi filluar këtë proces, si komision e kemi marrë nismën ligjore, e prej javës tjetër kemi aktivitetin e parë.

Dhe, e dyta, është një çështje tjetër e rëndësishme për sa i përket Radiotelevizionit të Kosovës - ndryshimi ose plotësimi i anëtarëve të Bordit, sepse ligjërisht pesë anëtarëve të tij u skadon mandati dhe po ashtu ka filluar procesi i përzgjedhjes së tyre.

Këto janë dy ngjarjet kryesore që dukshëm do ta përmirësojnë performansën e këtij institucioni të rëndësishëm të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Siç e dimë të gjithë, Radiotelevizioni i Kosovës është mediumi të cilin e ka themeluar Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe me këtë dua të them se Kuvendi i ka obligimet e veta, por njëkohësisht edhe ky medium i ka obligimet e veta.

Ne sot po e shqyrtojmë raportin e këtij mediumi, pra të RTK-së dhe Radiotelevizioni i Kosovës, në pajtim me ligjin, e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2014 për shqyrtim. Buxheti i ndarë i RTK-së, sipas Ligjit të buxhetit, ka qenë 8 milionë e 848 mijë euro.

Ndërsa në bazë të vendimit të Qeverisë për rishpërndarjen e buxhetit, Radiotelevizionit të Kosovës i janë ndarë edhe 500 mijë euro shtesë dhe buxheti përfundimtar për të ka qenë 9 milionë e 348 mijë euro. Dhe, gjithsej me të hyrat e tjera është 11 milionë e 248 mijë euro, kurse janë shpenzuar 12 milionë e 110 mijë e 363 euro. Pra, ka një tejkalim 108%. Në total, shpenzimet në krahasim me planifikim janë tejkaluar për 862 mijë e 363 euro, apo 8% mbi buxhetin e planifikuar.

Tejkalim të shpenzimeve, në krahasim me planifikimin, ka pasur edhe në kategoritë kryesore ekonomike. Për paga dhe mëditje, tejkalimi i shpenzimeve ka qenë për 869 mijë e 864 euro, apo 14,5%.

Ky tejkalim ka ndodhur me gjithë faktin që 7 punëtorë kanë qenë në pushim pa pagesë dhe 9 punëtorë kanë dalë në pension. RTK-ja ka vazhduar me punësime të reja dhe me avancimin e 22 të punësuarve.

Në mallra dhe shërbime, tejkalimi i shpenzimeve ka qenë për 349 mijë e 542 euro, apo 9%. Ndërkaq për shpenzimet komunale, buxheti është tejkaluar për 19 mijë e 869 euro, apo 8%.

Shpenzimet kapitale janë realizuar vetëm 62%. Në këtë kategori ka pasur ngecje në realizimin e buxhetit, në krahasim me planifikim.

Nga një milion euro të planifikuara, janë shpenzuar vetëm 623 mijë e 88 euro. Sipas shpjegimeve të përfaqësuesve të RTK-së, një pjesë e shumës nga kjo kategori është bartur në paga dhe mëditje dhe pjesa tjetër në kategori tjera.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2015, me rastin e shqyrtimit të raportit financiar të RTK-së për vitin 2014, shtroi disa çështje rreth mënyrës së realizimit të buxhetit dhe menaxhimit të shpenzimeve, respektivisht për tejkalimin e shpenzimeve pothuajse në të gjitha kategoritë ekonomike, për shpenzime të mëdha, për udhëtime jashtë vendit, 286 mijë e 906 euro, për shpenzime për mëditjet e Bordit në shumën prej 153 mijë euro, si dhe shpenzime të telefonisë mobile në shumën për 140 mijë euro.

Ndërkaq, përgjegjësi nga përfaqësuesit e RTK-së për tejkalimin e shpenzimeve nuk ka pasur. Tejkalimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin nga përfaqësuesit e RTK-së është arsyetuar me obligimet ligjore që 10% e buxhetit të RTK-së dedikohen për Kanalin RTK-2.

Hapja e kanalit të ri e ka shtruar nevojën për punësim shtesë dhe si rezultat gjatë vitit 2014 është rritur numri i të punësuarve për rreth 100 veta.

Disa nga këta janë në detyra specifike, me kontrata mbi vepër, gjë që e ka ngritur edhe nivelin e pagave.

Po ashtu, hapja e RTK3 dhe RTK4 ka ndikuar te shpenzimet për paga dhe mëditje.

Ndërkaq tejkallimet për mallra dhe shërbime janë arsyetuar me nevojën dhe obligimet ligjore për transmetimin e Kampionatit Botëror të Futbollit.

Një problem shqetësues ishte edhe çështje e borxheve të RTK-së, që përcillet tash e disa vite. RTK-ja nuk ka sqaruar në raport se sa është borxhi total i akumuluar.

Në lidhje me borxhin, komisioni në vitet e kaluara ka dhënë disa rekomandime për dërgimin e një raporti të detajuar për borxhin e akumuluar, për mënyrën e fshirjes së tij dhe afatet kohore për shtyrjen e borxhit, por RTK-ja nuk u është përgjigjur kërkesave të komisionit.

Çështja më shqetësuese që nuk ka gjetur zgjedhje deri më tani është mënyra e financimit afatgjatë për Radiotelevizionin e Kosovës.

Në bazë të ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, financimi i RTK-së nga Buxheti i Kosovës ka përfunduar në muajin maj të këtij viti. Në rast se brenda këtij viti nuk gjendet një zgjedhje afatgjate e financimit, RTK-ja nga viti i ardhshëm do të mbetet pa financim, duke pasur parasysh faktin se financimi i RTK-së nga Buxheti i Kosovës nuk është paparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2016-2018.

Të dhënat e prezantuara në raport dhe arsyetimet e përfaqësuesve të RTK-së kanë qenë të pamjaftueshme për çështjet dhe shqetësimet e ngrehura, sidomos për tejkallimet e shpenzimeve pa kërkuar miratim nga Kuvendi, si dhe për mosadresimin e borxhit të akumuluar.

Pra, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit Kuvendit për shqyrtim të raportit financiar dhe kërkon nga deputetët që në bazë të raportimit nga komisioni të vendosë vetë për miratim apo jo të këtij raporti, pasi është i paarsyeshëm për t'u votuar.

Andaj, me këtë rast kërkoj, pasi ne e morëm këtë qëndrim që të votojmë në orën 18:00, që të na e jepni mundësinë edhe një herë, kur gjithë deputetët të jenë këtu, që t'i ftojme dhe të reflektojnë që ky raport nuk mund të kalojë. Nuk mund të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani i kemi përfaqësuesit ose kryetarët e grupeve parlamentare. Xhevahire Izmaqu, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar me kohë raportin e Radiotelevizionit të Kosovës, transmetuesit publik, për vitin 2014, dhe sigurisht që pas kompletimit të raporteve që kanë ardhur

nga Bordi dhe nga Auditori i Përgjithshëm ne e kemi krijuar një përshtypje të përgjithshme, ku i kemi anët pozitive dhe anët negative.

Ne i kemi anët pozitive, duke e parë që raporti këtë herë, me ndryshim prej raporteve të vitit të kaluar, që kemi pasur raste së paku 5 vjet pra t'i shohim, ka detaje të mjaftueshme të punës, mirëpo në pjesën e raportit ku vihen re të gjitha të arriturat nuk i shohim të çështja e Bordit kur raporton, nuk i shohim pra ngecjet dhe sfidat.

Me përjashtim që Bordi kërkon që sa më parë të arrihet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit dhe çështja e pronës, nuk i shohim sfidat tjera.

Megjithatë, menaxhmenti më poshtë përmend edhe sfidat dhe mosrealizimet, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij funksionimi të transmetuesit publik.

Pavarësisht presioneve të vazhdueshme për shkak të kësaj gjendjeje financiare dhe përmbushjes së obligimeve, RTK-ja gjatë vitit 2014 ka arritur që t'i krijojë dy kanale televizive për të cilat ka pasur nevojë opinionit publik. Pra, kemi RTK3 dhe RTK4, të cilat janë krijuar pa një shtesë financiare. Mirëpo, kemi edhe funksionalizimin e RTK2, i cili ka obligime që të përmbushë përqindjen e vet prej 15% të përmbajtjes programore për minoritetet tjera, të cilën ende nuk ka arritur ta përmbushë.

Transmetuesi publik gjendet në një fazë të vështirë për shkak të mungesës së plotësimit të ligjit për çështje të financimit. Mirëpo, ka arritur që po ashtu të realizojë shpenzime shtesë, edhe master-plani për digjitalizim është ndër transmetuesit apo operatorët e parë që ka arritur ta krijojë rrjetin pa shtesë financiare, pa ndihmë prej Kuvendit.

Këto janë vlerësime të cilat dalin si pjesë e vlerësimeve edhe të Bordit, edhe të Grupit tonë Parlamentar, mirëpo e kemi pastaj një vlerësim tjetër, i cili na vjen nga Auditori, i cili në përgjithësi e reflekton edhe mënyrën se si ka komunikuar edhe Kuvendi në raport me Radiotelevizionin e Kosovës, duke paraqitur mosfunksionim të zinxhirit komandues dhe sigurisht edhe mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin si përgjegjësi nga ne ndaj tyre dhe atyre ndaj nesh.

Auditori në rekomandimet e përgjithshme gjen vërejtje edhe në menaxhimin dhe funksionimin e Bordit, por edhe të Kuvendit të Kosovës. Me të drejtë konstaton se problemet në RTK fillojnë që nga viti 2011, kur Kuvendi i Kosovës e shkurton buxhetin e RTK-së për 2,7 milionë, ndërsa e detyron që në vitin 2013 ta plotësojë kriterin ndërkombëtarë për themelimin e Kanalit 2.

Ne e shohim mungesën e objekteve, të cilat vazhdimisht i përmendin menaxhmenti dhe Bordi i RTK-së si pjesë e asaj që ata nuk arrijnë ta kenë një kualitet më të mirë në programe për shkak të kushteve të këqija.

Mirëpo, po ashtu në raportin e Auditorit e shohim edhe mungesën e përgjegjësive të disa redaktorëve, të cilët në punë në RTK shkojnë vetëm një herë në javë.

Pra, ne si deputetë, dhe unë si anëtare e Grupit Parlamentar të PDK-së, e ftoj menaxhmentin që t'i respektojë me përpikëri të gjitha të dhënat, të cilat dalin nga Auditori.

Me të gjitha vërejtjet dhe me dëshirën për t'i dhënë mundësi që të ketë një kualitet shumë më të madh, Grupi Parlamentar do t'i mbështesë rekomandimet e komisionit, të cilat thonë që ne duhet të votojmë për dhe t'i hapim mundësi transmetuesit publik të ecën përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sadri Ferati, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe këtë herë, Grupi Parlamentar i LDK-së, pas diskutimeve të shqyrtimit të raportit, vërtet shpreh çudinë e vet, habinë tonë që ky raport është vetëm përshkrues dhe më tepër e reflekton një gjendje të keqe, që është në RTK.

I kuptojmë rrethanat objektive, shqetësimet rreth pronës së RTK-së, paqëndrueshmërinë ose moszgjidhjen e financimit të qëndrueshëm të RTK-së. Po ashtu, e komplimentojmë rritjen e skemës programore, por kjo assesi nuk e arsyeton mosadresimin e të gjitha të gjeturave, të gjitha dyshimeve dhe të gjitha shqetësimeve që janë ngrehur gjatë debateve viteve të kaluara ku për arsye të njëjta nuk është aprovuar raporti i RTK-së.

Dhe, në raportin e këtij viti pothuajse nuk kemi arsye fare që të jemi optimistë, ngase në këtë raport nuk e kemi të adresuar pothuajse asnjërin nga shqetësimet që i kemi pasur.

Në debatin që është zhvilluar rreth RTK-së, ani pse ka pasur edhe shumë gjëra që lidhen me vitin 2015, por së paku të ishte adresuar në këtë raport masa, veprimet, idetë se si të dilet nga kjo gjendje në RTK, por është mjaftuar me shpjegime dhe me paralajmërime se të njëjtat gjëra që tash po ndodhin do të vazhdojnë të ndodhin edhe më tutje.

Është shqetësuese se sa inferior paraqitet Bordi në raport dhe realisht aty nuk shihet se kush kujt i përgjigjet, Bordi menaxhmentit, apo menaxhmenti Bordit?

Bordi, përveçse është treguar inferior, nuk ka qenë në nivelin e detyrës edhe në raste të veçanta, as atëherë kur ka nxjerrë sugjerime apo vendime që lidhen me punësimet dhe, kur të njëjtat kanë vazhduar, Bordi më nuk është pa sa çfarë veprimesh ka bërë, ose thënë më mirë nuk ka qenë në nivelin e detyrës dhe nuk i ka ushtruar në plotësi përgjegjësitë e veta, sepse është dashur që dikush të japë përgjegjësi dhe llogari për mosrespektimin e vendimit të tij.

Apo edhe këtë vit, atëherë kur janë larguar punëtorët nga RTK-ja, reagimi i Bordit ka qenë një herë në pritje, e pastaj me fjalë të tjera kurrfare, kur është parë se ai largim është bërë në mënyrë jo të ligjshme, siç e ka parë e gjithë Kosova me vendimin e menaxhmentit, pa procedurat paraprake të komisionit, e të tjera.

Gjithë Kosova e ka parë se ajo është jo e ligjshme, veç Bordi i RTK-së nuk e ka parë! E unë në këtë rast, edhe pse është ngjarje e vitit 2015, pra nuk është pjesë e ngushtë e raportit, por unë tash po shpjegoj se cili është trendi në RTK. Dua edhe një herë pra ta shpreh indinjatën, shqetësimin

tim, që derisa ne këtu kemi bërë debat për RTK-në, menaxhmenti i saj ka nxjerrë vendim për largimin nga puna të dy punëtorëve. Ata rastësisht kanë qenë kryetari dhe nënkryetari i Sindikatës, e mua po më duket kemi harruar se ku dhe në cilin sistem janë larguar kryetari e nënkryetari i Sindikatës me vendim urgjent të menaxhmentit, bile duke e paraqitur që është rrezik po t'u ofrohen telave, ose oborrit të RTK-së.

Pastaj, u tha edhe nga raportimet, edhe nga komisioni, ka shqetësime të mëdha në aspektin e menaxhimit financiar. Si në vetë shpenzimet, si në planifikimet, e është interesant vit pas viti investimet kapitale bien, ndërsa një pjesë e atyre mjeteve shfrytëzohen për paga dhe e kemi një stagnim të plotë të RTK-ja, posaçërisht tani kur pritet që të kalohej në sistemin digjital, edhe pse RTK-ja i ka 12 milionë buxhet, në krahasim me disa medime që kanë 3 milionë buxhet, shihet që ka ngecur, e unë nuk di se çfarë do të bënte në rast se tash do të kalohej në sistemin digjital të transmetimeve, s'di çfarë do të ndodhte me RTK-në.

Edhe cila ka qenë politika dhe prioriteti i RTK-së i menaxhmentit, në rend të parë i Bordit, të vazhdojë të shpenzojë, të vazhdojë të punësojë edhe atë jashtë. Kemi edhe dyshime se sa është respektuar edhe ligji, kur kemi punësimin, pastaj gjithë ai numër i madh i personave me kontrata mbi vepër në periudha aq të gjata, gjithë kjo tregon se aty më së paku është pasur kujdes se si do të menaxhohet para, si do të duket RTK-ja dhe kah do të shkojnë ato mjete dhe ato shpenzime. Pra, kemi një moskujdesje në shfrytëzimin racional të mjeteve dhe në strukturë.

Pastaj, kemi shumë shqetësime që lidhen me avancimin e të punësuarve përbrenda, së paku nuk është demantuar thënia se kemi ish-redaktorë që rrinë dhe kemi avancimin e të tjerëve, dhe pastaj punësimin, sepse kanë mbetur vende të lira dhe një pjesë e tyre të cilët dikujt nuk i pëlqejnë, vazhdojnë të qëndrojnë 8 orë, ndërsa vazhdon punësimi urgjent i të punësuarve me kontrata mbi vepër.

Pastaj, përkeqësimi i raporteve ndërnjerëzore në shkallë alarmante dhe aty më tepër kemi përshtypje se kemi të bëjmë me një armiqësi, e cila thellohet dita-ditës se sa të një rregullative e të një menaxhimi të një shtate, do të thotë ndërmjet atyre pra që menaxhojnë dhe atyre që shërbejnë edhe punojnë, dhe është vërtet për shqetësim.

E di që tani ne ndodhemi para një vendimi vërtet çfarë të bëjmë, si do t'i ndihmojmë RTK-së. Unë para se ta them mendimin tim dhe të Grupit Parlamentar se si do të mund t'i ndihmojmë RTK-së, do ta bëj një konstatim me plotësisht të drejtë se Kuvendi i Kosovës po tregon se nuk është i aftë t'i menaxhojë institucionet e pavarura, të cilat i ka krijuar me numër shumë të madh, por që nuk i ushtrojnë përgjegjësitë e veta, as në kuptimin e ndihmës, të bashkëpunimit e të ngritjes së këtyre institucioneve dhe aq më parë obligimin ligjor që kjo duhet të monitorojë dhe të veprojë konform ligjit në bazë të situatave që krijohen.

Kemi raste kur nuk votohet në raportet dhe ajo duket që kurrëgjë hiç, sikur kjo puna e raportit, si e votove, si s'e votove! Çka ndryshon situata?! Kemi vite të tëra që nuk votohet një raport dhe as që ngrihet një procedurë bile formale për t'u parë se çfarë po ndodh më tutje. Dhe, meqenëse është kështu, unë mendoj se para se të flasim për raportin, duhet të flasim se cili duhet të jetë Kuvendi i Kosovës në raport me institucionet që i ka themeluar vetë dhe për të cilat jep llogari para qytetarëve për pjesën e vet se si funksionojnë ato.

Prandaj, unë mendoj që pikërisht në interes të qytetarëve, në interes të të punësuarve, dhe të vetë mediumit, pra të RTK-së, që ne i bëjmë mirë nëse nuk e votojmë këtë raport, që është edhe qëndrim i Grupit Parlamentar të LDK-së, ngase me këtë edhe një herë do të azhurojmë dhe do ta detyrojmë Kryesinë e Kuvendit, komisionet dhe komplet Kuvendin, që me një përkushtim të plotë ta vendosë në rend dite si ta ndryshojë këtë gjendje të keqe në RTK.

Fatmirësisht, shumë shpejt pritet që ne do të diskutojmë për Bordin e RTK-së dhe në rast se ne prapë emërojmë borde dhe anëtarë të bordeve më tepër për motive krejt tjera sesa për motive që ne të dërgojmë profesionistë, njerëz me karakter të dinjitetshëm, të cilët e dinë se e kanë një mision, e ai mision është funksionimi i mirë i një institucioni kaq të rëndësishëm për shtetin e qytetarët, siç është mediumi publik, RTK-ja.

Sa i përket financimit, Kuvendi duhet ta thotë fjalën e vet. Fundja e fundit, duhet ta marrë një vendim të përhershëm, të thotë “e financoj RTK-në” dhe vazhdon dhe nuk ka nevojë që dikush të detyrohet të sillet si në raport të poltronit, ose të gjendet një formulë e qëndrueshme se di do të financohet RTK-ja, por jo të financohet ad hoc me muaj e me muaj edhe më tutje.

Ndërsa, për RTK-në, deri në zgjedhjen e Bordit të ri, unë edhe njëherë do ta kisha lutur që ta bëjë një analizë dhe t’i shpjegojmë më në fund njëherë e përgjithmonë këtij vendi, këtyre qytetarëve si lindi borxhi i RTK-së, a u habit dikush, a fjeti e si doli gjumi, çka ndodhi, si është e mundur që të harxhohet më shumë se që ke?! Si është e mundur që vit pas viti të thuhet që po kursejmë, e në fund të vitit bilanci tregon që RTK-ja është në borxhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën!

SADRI FERATI: Faleminderit se është hera e parë që po e vazhdoj kohën, por po besoj që me arsye. Pra, ne e kemi rastin kur thuhet se gjithë këtë borxh e ka krijuar menaxhmenti i kaluar. Nga menaxhmenti i kaluar sot e kemi drejtorin dhe këshilltarin e drejtorit.

Çështje e vërteta unë tash s’dua të them, por ai drejtor e ka pagën aq të mirë, sa nuk ka nevojë t’i ketë 10 këshilltarë me pagë nga 1 000 euro, e gjysmën s’i sheh kurrë. E, në anën tjetër, tërë kohën thotë më jepni ende para se unë di t’i harxhoj. Për të harxhuar, unë ta harxhoj buxhetin e Amerikës, po duhet parë se ky vend po financon aq sa ka mundësi dhe po e kërkon atë kualitet që ia lejon ai kapacitet.

Prandaj, unë mendoj që ne sot nuk do të marrim vendim për shkarkimin e menaxhmentit, që do të kishte qenë më meritori, jam shumë i vetëdijshtë, por ne sot do t’i themi “jo” këtij raporti për një bord profesional dhe të vendosur për ndryshimin e kësaj gjendjeje, ndërsa ai bord do t’i bëjë të gjitha veprimet brenda ligjit, gjithmonë me një qëllim e një synim - për një RTK më ndryshe, për një RTK më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kam tre të paraqitur nga “Vetëvendosja”. Shqipe Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit! Po më vjen mirë që po i dëgjoj edhe shqetësimet e ngritura edhe nga kolegët tjerë, por nuk është hera e parë që deputetët po ngrenë shqetësimet e veta për RTK-në dhe mënyrën se si po funksionon dhe se si po menaxhohet, bile në mars të këtij viti ne kemi debatuar goxha gjatë dhe në fund me unanimitet do të thotë pa asnjë votë kundër i kemi miratuar edhe disa rekomandime, të cilat, mes tjerash, janë drejtuar edhe RTK-së.

Po ashtu, edhe në komision e tha edhe zoti Pajaziti kemi diskutuar disa herë dhe kemi ngritur jo vetëm shqetësimet tona, por edhe shumë pyetje për mënyrën në veçanti se si po harxhohet paraja publike nga RTK-ja, por edhe për mënyrën se si po funksionon. Do të them të drejtën unë kam pritur që kësaj here RTK-ja ta marrë më seriozisht edhe punën e raportit dhe ta përdorë të gjithë kapacitetin dhe dijen e tyre si menaxhmenti ashtu edhe bordi që të hartojë të paktën një raport solid. Tani nuk po e di a po ju mungon kapaciteti apo dija për të hartuar një raport apo fare nuk tentojnë të japin llogari themeluesit dhe financuesit e tij, e që është Kuvendi i Kosovës, apo të dyja bashkë.

Por raporti që na është prezantuar vërtetë është tejet i dobët, është e papranueshme në fakt mënyra qysh e injorjnë Kuvendin RTK-ja, domethënë themeluesin e vetë duke mos tentuar të paktën të përfillë vërejtjet dhe komentet e deputetëve, të cilat në fakt kanë qenë jo vetëm të një grupi parlamentar.

E sa i përket këtij raporti, fillimisht hartuesit e tij nuk i kanë marrë parasysh as kërkesat minimale ligjore për hartimin e raportit. RTK-ja nuk ka organizuar debat publik për raportin siç kërkohet me nenin 38, pika 3 e ligjit. Bordi i drejtorëve nuk e ka dhënë mendimin e vetë për raportin, siç e kërkon neni 38, pika 4. Raporti nuk përmban informata për skemën programore vjetore, e cila miratohet nga Bordi, kështu që ne shpesh shohim në RTK, herë i japin lajmet në orën 11:00, herë i heqin fare dhe vendosin në baza ad hoc ditore për skemën programore.

Po ashtu, ne kemi kërkuar që të gjitha vendimet e bordit t'i bashkëngjiten këtij raporti dhe asnjë nga këto në fakt nuk është bërë. Por, shqetësimi kryesor që u ngre edhe sot vazhdon të mbetet çështja e borxheve të RTK-së, të cilat janë të pashpjeguara, por në fakt shpesh edhe të pashpjegueshme. Ndaj kujt dhe si u krijuan këto borxhe, sa është shuma e tyre, si është e mundur në fakt bordi të ketë miratuar buxhet i cili i tejkalon të hyrat. Gjitha këto janë pyetje se disa herë janë shtruar RTK-së, por asnjëherë nuk ka dhënë përgjigje për to bile as për në këtë raport.

Në fakt, jo çka raportohet bile edhe sot në media dhe shqetësimet që janë ngritur nga sindikata e RTK-së janë për borxhe të tjera të krijuara nga ky institucion. Borxhe ndaj ujësjellësit, borxhe ndaj kompanisë së pastrimit, do të thotë RTK-së i është ndalur uji, plehrat nuk grumbullohen para RTK-së, RTK-ja ka borxhe në tatimin në pronë e për disa prej tyre në fakt RTK-ja në raportin e tyre financiar ka raportuar se i ka paguar. Është një mos përputhje mes asaj çka ka deklaruar RTK-ja dhe faturave të prezantuara nga sindikata.

Kjo, të nderuar deputetë, për mua është vepër penale me të cilën fakt duhet të merret prokuroria e shtetit. Shqetësim tjetër i cili u përmend po ashtu edhe këtu është numri i punëtorëve, i cili përveçse është rritur në fakt është bërë pa asnjë lloj analize paraprake për nevojën e angazhimit të tyre. Por, ajo çka kemi është se në njërën anë është rritur numri i punëtorëve dhe në të njëjtën kohë është rritur numri i programeve, të cilat RTK i blen nga producentët tjerë, për të cilat po

ashtu RTK-ja nuk ka dhënë asnjëherë asnjë informatë se cilat janë këto programe, sa para paguan RTK për secilën prej këtij programi, cila ka qenë mënyra e përzgjedhjes apo si është vendosur se cila nga këto programe do të transmetohen në RTK.

E tha edhe zoti Ferati, në njërën anë ne kemi punëtorë të RTK-së të cilët gjatë gjithë ditës pinë kafe në bufetë e RTK-së, gjë që e kanë dëshmuar vetë ata dhe në anën tjetër koha më e shikuar në RTK mbulohet me programe, të cilat nuk janë prodhim i RTK-së dhe shpeshherë ndoshta as nuk përputhen me politikat editoriale të mediumit publik.

Duke qenë që RTK është mbytur në borxhe në fakt në vend se ata që ulin shpenzimet, sidomos ato të panevojshme menaxhmenti i RTK-së vetëm sa ka rrit luksin për veti. Sipas një raporti të publikuar sot në media vetëm një udhëtim në SHBA në Amerikë i drejtorit gjeneral dhe i një punëtoreje tjetër ka kushtuar 40 mijë euro. Përveç kësaj nuk ka asnjë informatë për tabelën e trajnimeve dhe udhëtimeve zyrtare për të cilat RTK ka paguar. Kush nga punëtorët e RTK-së ka marrë pjesë në këto trajnime, cilat kanë qenë temat për të cilat stafi i RTK-së ka pranuar trajnime, cili ka qenë përfitimi i RTK-së nga pjesëmarrja në këto trajnime, po asnjë informatë po ashtu nuk është ofruar për vizitat që drejtuesit e RTK-së i kanë kryer jashtë vendit. Kush ka shkuar në këto vizita, cili ka qenë qëllimi, çfarë ka përfituar RTK-ja, e kështu me radhë.

Në fakt, e gjithë mënyra e shpenzimit të buxhetit është e dhimbshme të shikohet se si bëhet, kur dihet se ato para janë të taksapaguesve mjaft të varfër të Kosovës. Tejkallimet e buxhetit kemi te pagat, mëditjet dhe shpenzimet tjera përderisa nuk kanë arritur t'i shpenzojnë investimet kapitale dhe në fund prapë e ngremë çështjen se kujt i jep llogari RTK-ja. Publikut jo, sepse asnjëherë nuk ka themeluar grupin këshillues të publikut siç parashihet me nenin 36, të Ligjit për RTK-në. Punëtorëve të vetë natyrisht jo, sepse në vazhdimësi sindikata ka ngritur shqetësime për mënyrën e menaxhimit dhe funksionimit të këtij institucioni dhe si pasojë drejtori i përgjithshëm i pati përjashtuar kryetarin dhe nënkryetarin e Sindikatës.

Edhe më pak RTK-ja i jep llogari këtij Kuvendi dhe kjo po shihet edhe me këtë raport, por edhe me raportet sidomos të tri vjetëve të fundit të cilat nuk janë miratuar nga ky Kuvend për shumicën e arsyeve të cilat u përmendën edhe më herët. Por, a është faji i vetëm i drejtuesve të RTK-së për nivelin e degradimit ku ka rënë. Përgjigjen pjesërisht e ka dhënë raporti i auditorit të performansës së RTK-së, ku mes tjerash me të drejtë e fajëson edhe Kuvendin për mungesë të ushtrimit të kontrollit mbi këtë institucion.

Në fakt, ju përkujtoj se sipas ligjit RTK-ja është dashur që çdo tre muaj të raportojë para Kuvendit, gjë të cilën asnjëherë nuk e ka bërë të paktën për këtë vit, por edhe në vitin që kaloi. Në fakt nuk është se Kuvendi ose deputetët e caktuar nuk kanë ushtruar kontroll mbi RTK-në, shpeshherë bile ky kontroll ka qenë i tepërt jo vetëm që kontrolli është bërë për t'i treguar se si të sidomos për programet e informimit, por shpeshherë edhe për mënyrën dhe punësimin e njerëzve, të cilët janë bërë pa konkurs dhe të cilët kanë qenë kryesisht miqtë dhe familjarë të deputetëve.

Dhe, në vend që të RTK-së të i kërkohet të jetë institucion i profesionalistëve dhe lajmet që ata i japin të jenë për publikun, të jenë të sakta dhe të paanshme në fakt atyre u është kërkuar në mbledhje të komisionit që të ndërrohen prezantuesit, sepse janë pleq dhe ata duhet të

zëvendësohen me fytyra të reja dhe të bukura e që kjo në fakt përveç që është ndërhyrje e drejtpërdrejtë është edhe në kundërshtim me ligjin kundër diskriminimit. Kolegë deputetë, më 27 mars ne kemi miratuar disa rekomandime për RTK-në, ndërmjet tjerash edhe mundësinë e krijimit të Komisionit Hetimor Parlamentar për RTK-në. Krijimi i këtij komisioni është më së i domosdoshëm, por për më shumë do të duhej që prokurori i Shtetit t'i fillonte menjëherë hetimet për të gjitha keqpërdorimet dhe korrupsionin që ka ndodhur në RTK, në mënyrë që ky institucion të shpëtohet nga falimentimi i plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Më fal, Shqipe, por pasi jemi në transmetim publik, a ke ti si deputete një denoncim që ta bësh tash, pasi ka korrupsion. Bëja publikisht, thirrë kryeprokurorin menjëherë!

SHQIPE PANTINA: E para, vetëm sot i ke të publikuara faturat e papaguara për bërlllok dhe për ujë, përderisa në raportin që ata na e kanë dorëzuar thuhet se janë komplet shuma tjera, për të cilat RTK-ja thotë që i ka paguar.

Kjo për mua është më se e mjaftueshme që prokurori t'i fillojë hetimet. Unë po e ngre vetëm një problem, e të mos themi për problemet tjera, të cilat i kanë ngrehur vetë punëtorët e RTK-së. Unë jam deputete për të ngrehur shqetësime, më tutje le të merret Prokuroria. Edhe një çështje tjetër, pasi ma dhatë fjalën, RTK e ka transmetuar takimin e komisionit çuditërisht të gjithin, përveç pjesës kur unë kam folur, e ku komplet e kanë ulur zërin, sepse me siguri nuk u kanë pëlqyer ato që ua pata thënë dhe për këtë s'kanë dashur ta marrë vesh publiku. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tjetrën herë, deputetët që kanë të punësuar në RTK është mirë të përmenden. Për hir të transparencës, nuk ishte komunikim ndërmjet nesh. Për publikun e bëra këtë.

Atëherë, nga Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt ky raport është diskutuar dhe stërdiskutuar edhe në opinion, por veçanërisht me orë të tëra edhe në Komisionin Parlamentar. Thënë të drejtën, këtë që e tha në fund Shqipja ka qenë për çudi se një mbledhje bukur të gjatë prej disa orëve RTK-ja ka gjetur hapësirë ta transmetojë, por sipas gjasave me mendimin se kanë qenë superiorë në raport me reagimet tona e kanë dhënë, por aty është parë arroganca e Bordit dhe Menaxhmentit të RTK-së, dhe unë që në fillim, pa dashur t'i përsëris kolegët, mund të them me përgjegjësinë më të lartë, se ky raport e tregon rastin më eklatant të keqpërdorimit të parasë publike dhe rastin më të papërgjegjshëm, që një institucion bën në raport me shpenzimet e Buxhetit të Kosovës, sepse kur ndalemi te tabelat e shpenzimeve hapur shihet se Menaxhmenti i RTK-së është pasqyrë e institucioneve tjera të Kosovës në raport me transparencën karshi qytetarëve, e unë do ta përmend një fakt, siç thashë, pa i përsërit kolegët, kemi në tabelat e shpenzimeve për shembull rreth 90 mijë euro detaje të shpenzimeve, ndërsa për 3 milionë e gjysmë euro nuk kemi kurrfarë detaji.

Kjo është e mjaftueshme për ta kuptuar se ky menaxhment, përpos që keqpërdor, e fshi edhe të vërtetën rreth asaj se çka është duke ndodhur me RTK-në. Dhe, RTK-ja nuk është rastësisht këtu ku është, sepse ata që menaxhojnë me RTK-në, siç thotë një fjalë popullore, “i kanë shtrirë këmbët më shumë sesa e kanë pasur jorganin” dhe në forma të ndryshme e thanë edhe kolegët se

kanë bërë shpenzime jashtë asaj që ka qenë e planifikuar, shpenzime të cilat shpesh nuk i argumentojnë dhe për çudi e kemi rritje të numrit të punëtorëve në mënyrë enorme, por në të njëjtën kohë kemi edhe blerjen e produkteve të jashtme, gjë që bie ndesh me rritjen e punëtorëve.

Faktikisht, Kuvendi, përpos që nuk duhet ta miratojë këtë, unë mendoj se duhet të gjejë forma për t'i thirrur në përgjegjësi ata që për vite të tëra dhe veçanërisht bazuar në raportin e fundit të keqpërdorimit të parasë publike, në të kundërtën në rast se ky raport miratohet këssoj, Kuvendi bëhet hisedar në legalizimin e krimit dhe korrupsionit nëpër agjencitë buxhetore që e shfrytëzojnë Buxhetin e Kosovës, në këtë rast të RTK-së.

Ne kemi pasur raporte të agjencive nga më të ndryshmet që kanë pasur defekte e lëshime të ndryshme, mirëpo ky është rasti më i paprecedent, sepse faktikisht sipas raportit del se në këtë institucion, që e financon Buxheti i Kosovës dhe që i raporton Kuvendit, organit më të lartë të shtetit, thjesht menaxhojnë njerëzit shumë të papërgjegjshëm për mendimin tim dhe Kuvendi, duke mos e votuar këtë raport, mendoj se duhet të sinjalizojë dhe të japë simptoma se në të ardhmen ata që e keqpërdorin paranë publike nuk do ta kenë mbështetjen e Kuvendit. Jo vetëm që nuk do ta kenë mbështetjen e Kuvendit, por raportet e fundit që janë diskutuar, edhe të agjencive të tjera, na nxjerrin para një përgjegjësie që në Rregulloren e ardhshme të Kuvendit, për raportet që nuk miratohen nga Kuvendi të sanksionohen me bordet, të cilave nuk u kalojnë raportet dhe në të kundërtën ata përsëri vazhdojnë të menaxhojnë në vazhdimësi.

Prandaj, edhe një herë për fund, unë po e them, pa u futur në detaje, kisha kërkuar nga kolegët që këtë raport të mos e miratojnë, ta kundërshtojnë dhe besoj se në një të ardhme të afërt ne do të përballemi edhe me Bordin e RTK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Zafir! E kemi Rregulloren e re, ndoshta aty duhet të koncentrohemi të gjithë, edhe te çështja e përgjegjësive, kur raporti nuk kalon.

Vazhdojmë atëherë me deputetët, që janë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës. Adem Salihaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Të nderuar deputetë,

Pak kohë më parë ne e patëm një debat të veçantë për RTK-në, kemi debatuar shumë dhe kemi nxjerr disa konkluzione. Për fatin tonë të keq gjendja është e njëjtë me atë për të cilën kemi diskutuar dhe mund të themi që edhe ky raport vetëm është një pasqyrë e gjithë asaj që kemi thënë për RTK-në.

Në fakt, problemet kryesore atje janë të menaxhimi i financave, por ka probleme në të gjithë sektorët dhe në të gjitha segmentet e RTK-së. Së pari, dëshiroj të them që përkundër faktit që Kuvendi i Kosovës nga taksat e qytetarëve ndan shuma të mëdha për RTK-në atje mendoj që ka një abuzim të vazhdueshëm të parasë publike për faktin e thjeshtë se për paga janë shpenzuar më tepër se gjysma e atyre 12 milionëve, më saktësisht 57% e buxhetit të RTK-së është shpenzuar për paga ose thënë në shifra 6 milionë e 869 mijë euro.

Në fakt, ka tejkalim edhe për mallra dhe shërbime, kurse për investime ka mungesë të realizimit të buxhetit. Pra, aty ku për të cilat ka nevojë më së shumti RTK ka vetëm 62% të realizimit të

buxhetit. Është shumë shqetësues fakti që paga mesatare e stafit udhëheqës në RTK është rreth 1 mijë e 860 euro, pra është një pagë më e madhe se mos të flasim për deputetët e për ministra, pra është një pagë tepër e paarsyeshme dhe thjeshtë është një keqpërdorim i madh i parasë publike.

Stafi profesional dhe përcjellës, pra që s'është menaxhues, e ka një pagë mesatare rreth 800 euro, që është përsëri shumë e paarsyeshme. Nuk ka planifikim të mirëfilltë buxhetor, pra RTK kishte obligim ligjor që të bënte një plan për inkasimin e një takse për RTK-në, pra një lloj parapagimi që s'e ka bërë asnjëherë këtë plan. Pra, kishte obligim dhe natyrisht që s'i duhet një plan i tillë për arsyen e thjeshtë se ka mundësi të marrë me bollëk pare nga Buxheti i Kosovës.

Borxhi i RTK-së, pra borxhi absurd i paarsyeshëm që s'është dashur të jetë vitin e kaluar ka qenë 3 milionë e 300 mijë euro, sivjet është 4 milionë e 300 mijë euro. Pra, është rritur borxhi si pasojë e shpenzimit pa kriter të parasë publike. Punësimi me kontratë në vepër siç po quhet këtu e që në fakt është punësim për punë dhe detyra specifike, pra është një punësim që mund të kenë nevojë ndërmarrjet e ndryshme ose administrata publike në raste të caktuara paraqitet një nevojë për 2-3 muaj që të punësohet një person për t'i kryer disa punë dhe detyra specifike, por ky numër i të punësuarve në fakt është dhe duhet të jetë shumë i kufizuar, shumë i vogël në RTK bëhen punësime masive me kontrata të tilla për punë dhe detyra specifike dhe ne kemi një përshtypje që atje punësohen njerëz vetëm për të marrë paga, jo pse ka nevojë RTK-ja, por pse dikujt i nevojitet ta punësojë dikë për ta marrë një pagë të caktuar. Pra, në përgjithësi në të gjitha aspektet mendoj që në RTK shkon puna keq, të mos flasim për ndikimet në program, të mos flasim për blerjen e programeve ndryshme bëhet një biznes shumë biznes profitabil, pra prodhohen programe të dobëta nga kompani të themi fiktive dhe i shiten RTK-së për para të majme, ka shpenzime tepër të mëdha për udhëtime jashtë pra 286 mijë euro për udhëtime jashtë të stafit të RTK-së, janë shpenzime tepër të çuditshme, të pa arsyetueshme dhe unë mendoj që Kuvendi ka arsye të merret shumë seriozisht me gjitha këto çështje.

Fakti është se Kuvendi nuk ka pasur dhe mendoj se as sot nuk ka fuqi të ndërmarrë diçka serioze lidhur me RTK-në, po edhe me institucionet tjera publike që ne i quajmë të pavarura, nuk ka vullnet që ne të bëjmë diçka serioze dhe unë mendoj që realisht pavarësisht faktit që ndoshta sot nuk e aprovojmë këtë raport megjithatë nuk jemi optimist dhe s'mund të kemi një besim se gjendja në RTK mund të ndryshojë edhe në të ardhmen. Pra, është një pafuqi e Kuvendit të Kosovës që të bëjë diçka serioze, është një përgjegjësi që ne e kemi nga ligji, nga Kushtetuta, nga vota e qytetarit, të cilën përgjegjësi ne në fakt nuk po e ushtrojmë. Mendoj se gjendja s'është e mirë, nuk do të ketë një përmirësim serioz pavarësisht faktit që ne debatojmë këtu, aprovojmë apo nuk aprovojmë raporte gjendja vazhdon të jetë njësoj siç ka qenë edhe më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

RTK-ja e ka ndaluar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancës në kanal RTK1, për çka ata janë të obliguar me ligj, dhe e kanë bartur transmetimin e seancës në RTK3, i cili nuk është rrjet tokësor, por kabllor, dhe të cilin nuk e sheh gjysma e popullatës të qytetarëve të Kosovës.

Dhen kjo është shkelja, të cilën RTK-ja si institucion publik ia bën Kuvendit, e Kuvendi e mbikëqyr punën e tyre dhe kur e shohim njëjtë dhe raportimin skandaloz financiar konkludojmë dhe mund të konkludojmë se RTK-ja është institucioni më i papërgjegjshëm publik sa i përket shpenzimit të parasë publike dhe këtu ka papërgjegjësi maksimale dhe kjo papërgjegjësi maksimale vjen për shkak të arrogancës të udhëheqësve të RTK-së të cilët besojnë se janë të mbrojtur nga pushteti në Kosovë, konkretisht ata të gjithë mendojnë se janë të mbrojtur nga Partia Demokratike e Kosovës.

Përpos konkludimeve sa e sa vjet që financimi i RTK-së është i papërshtatshëm çka edhe e bën këtë institucion publik institucion partiak të kontrolluar maksimalisht nga një parti politike ne mund të shohim që edhe formula buxhetore e RTK-së 0,7% i Buxhetit të Kosovës është një formulë paushalle, nuk ka racionalitet ekonomik pse 0,7% i buxhetit i shkojnë RTK-së dhe njëjtë shohim se nuk ka planifikim të hollësishëm buxhetor. Kjo mungesa e planifikimit të mirëfilltë dhe të hollësishëm buxhetor dhe papërgjegjësia në shpenzim të parasë publike e ka zhytur RTK-në në borxh prej 4,3 milionë euro. Ata i kanë borxh kompanive publike, kanë tejkallime të shpenzimeve, nuk e paguajnë tatimin në pronë, i kanë borxh ish punëtorëve, nuk i paguajnë shërbimet me kohë, si është kjo e mundur, si është e mundur që ne të lejojmë një lloj raportimi të tillë skandaloz të na vije në Kuvend për shqyrtim duke menduar se vetëm po raportojnë formalisht.

Për më tepër RTK me një buxhet jashtëzakonisht të madh prej 11,2 milionë eurosh e tejkalon për gati 900 mijë euro i tejkalon shpenzimet e veta pa një arsye të mirëfilltë pse janë tejkalluar këto shpenzime. Për më tepër 57% i buxhetit të RTK-së e cila është për paga, staf të punonjësve apo 708 të punësuarve e ne nuk e dimë pse i duhet RTK-së, pse i duhen 708 punësuar. Kemi edhe këtu tejkallim prej gati 870 mijë euro më shumë, domethënë në vend se t'i paguajë 6 milionë euro, i kanë paguar 6 milionë e 870 mijë euro.

Edhe këto tejkallime buxhetore njëjtë kemi edhe shërbime kontraktuese tjera për program, të cilat janë në vlerë prej 3,5 milionë eurosh askush nuk e di ku kanë shkuar këto 3,5 milionë euro parave të qytetarëve të Kosovës dhe këto janë të gjitha shkelje të Ligjit të RTK-së. Kjo është shkelje e përgjegjësive të bordit të RTK-së, e bordi i RTK-së me Ligjin për RTK-në saktësisht pika 2.9 e nenit 29 ka obligim sigurimin që shpenzimet e RTK-së të mos i kalojnë burimet financiare.

Dhe, pse tash kjo po na ndodh kështu? Sepse RTK-ja është shndërruar në strofull të rehatimit të njerëzve, të rehatimit të rretheve të të ashtuquajturve “njerëz të fortë në politikën e Kosovës”, dhe me diskutimin e kolegëve deri tash po duket se RTK-ja sot do ta marrë ndëshkimin e parë. Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta votojë raportin e RTK-së dhe duhet të ketë ndëshkim drejt papërgjegjshmërisë të shpenzimit të parave publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Të nderuara deputete,

Sot po diskutojmë raportin prej 135 faqesh të RTK-së për vitin 2014. Raporti të krijon përshtypjen e një storie shumë të suksesshme të një institucioni publik. Në tërësinë e tij ai

paraqet gjithë skemën programore të RTK-së duke përfshirë kanalet, emisionit, pra të gjitha ato që ne i shohim çdo ditë.

Të gjithë ata që e kanë lexuar raportin e auditorit të përgjithshëm për vitin 2014 për RTK-në nuk kanë asnjë arsye të mos krenohen me punën e madhe të këtij institucioni publik, sepse ky raport ngjall pikërisht këtë përshtypje pavarësisht që realiteti është krejt tjetër. Interesant është fakti që raporti i RTK-së për vitin 2014 dhe raporti i auditorit të përgjithshëm lë përshtypje sikur po flitet për dy institucione krejtësisht të ndryshme të cilat rastësisht kanë të njëjtin emër.

RTK me buxhet më të madh se Kuvendi i Kosovës, për të cilin mund vetëm të ëndërrojë secili institucion i ngjashëm privat në vend, vepron faktikisht pa plan financiar. Në fakt, RTK ka një plan financiar por ky është vetëm formal dhe nuk zbatohet asnjëherë si është planifikuar për shkak të mungesës së bashkëpunimit të planifikimit ndërmjet Bordit të Drejtorëve dhe drejtorit të RTK-së. Kjo ka si reflektim veprimet ad hoc, të cilat dëmtojnë buxhetin dhe ecurinë sipas planit të një institucioni të madh i cili ka nevojë për një jetë të organizuar dhe të planifikuar.

Një prej problemeve tjera me të cilat nuk merret raporti është mungesa e punës së mekanizmave kontrollues, të cilat do të pengonin mbi punësimin dhe implementimin e projekteve, të cilat e rrezikojnë RTK-në. Përkundër faktit që RTK ka një borxh prej 4,3 milionësh, ky borxh nuk është trajtuar asnjëherë në mënyrë serioze dhe RTK nuk ka asnjë plan për kthimin e tij. Menaxhimi i burimeve njerëzore, mungesa e përshkrimit të pozitave tregon që RTK është kthyer në një zhvatës të parasë publike nëpërmjet punësimit dhe korrupsionit. RTK ka blerë vepra audio-vizuale në kundërshtim me Ligjin e prokurimit në vitin 2012, në vlerë prej 287 mijë euro në emër të produksioneve të pavarura, ndërsa vitin e kaluar mbi 223 mijë euro. Të gjitha këto veprime janë bërë në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik dhe lë shumë vend për dyshime për korrupsion.

Edhe pse formalisht ekziston auditori i brendshëm i RTK-së ai nuk ka kryer asnjëherë punën e tij, faktikisht RTK në kundërshtim me ligjin është pa auditor të brendshëm. Një prej problemeve më të mëdha që ka RTK është drejtimi i institucionit si tërësi. Në mungesë të politikave konkrete, kompetencave dhe përgjegjësi të qarta për organet drejtuese, por edhe për shkak të vështirësive në zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve në mungesë të transparencës dhe mekanizmave të kontrollit, ky institucion në formën që vepron është i padrejtueshëm. Situata është kjo, Kuvendi nuk arrin t'i implementojë rekomandimet e veta për drejtorët e bordit, drejtorët e bordit nuk e detyrojnë dot drejtorin e RTK-së t'i implementojë udhëzimet dhe vendimet e tij, ndërsa drejtori i përgjithshëm nuk është transparent ndaj bordit të drejtorëve, nuk i përfill rekomandimet e tij dhe nuk i zbaton politikat që kërkohen prej tij.

Aktualisht, RTK-ja është pa udhëheqje. Në fakt ky institucion ka organet legjitime, por këto organe me problemet me të cilat ballafaqohen nuk mund të merren për arsye se aty ekziston një anarki e paparë ku askush askujt nuk i jep përgjegjësi. Ajo që raporti i RTK-së nuk e thotë është fakti që ky institucion publik është kthyer në një anije të uzurpuar me një kapiten legjitim, por që nuk ndjek kursin e përcaktuar nga pronari, që nuk jep përgjegjësi për shpenzimet, që nuk ka plan lundrimi, që nuk ndjek qëllimet e qarta, që nuk ka sistem të shfrytëzimit racional për resurset materiale dhe njerëzore.

RTK-ja në mënyrën e funksionimit të vet është në njëfarë mënyre një pasqyrë, është në njëfarë mënyre një shembull se si funksionon edhe vetë Qeveria e Kosovës.

RTK është Titaniku i Kosovës. Ky institucion publik, njëri prej më të mëdhave në vend nëse vazhdon edhe më tutje kështu me këtë kurs do të përjetojë fatin e kësaj anije. Unë ju ftoj gjithashtu që të mos e miratoni këtë raport, kërkoj gjithashtu që nga Kuvendi të tregojë konkretisht se çka kërkon prej RTK-së mendoj që është e rëndësishme që nga RTK-ja të kërkohet të raportojë jo vetëm për sukseset, por të raportojë për gjendjen reale në të cilën ndodhet ky institucion, të raportojë në raportin vjetor për problemet e drejtimit, për problemet ndërmjet drejtorit dhe Bordit të Drejtorëve, të tregojë cila është zgjidhja sipas RTK-së, sa është numri real i punonjësve që ky institucion publik ka nevojë për të.

Pra, po mendoj që Kuvendi duhet të kërkojë gjëra kryesore, të cilat duhet të futen në raportin, i cili do të duhej të plotësohej nga RTK-ja për vitin 2014. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur për diskutim. I kisha lut grupet parlamentare, shefat e grupeve parlamentare, që deputetët, në qoftë se kanë mundësi, t'i thërrasin për arsye se nuk kemi kuorum. S'janë as shefat, i ka rrokur agjërimi.

Për korrektësi, kjo pikë e rendit të ditës ka qenë pas dy pikave të rendit të ditës, e kemi bartur më herët për shkak për ta zënë pjesën e transmetimit publik, meqë na transmetojnë deri në orën 17:00. Është e zakonshme kjo, ta kemi parasysh, është rregull që pas orës 17:00 zakonisht mbyllet transmetimi publik i seancës. Realisht, për këtë arsye unë e barta, prandaj i kërkoj falje veçanërisht ministrit të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit, i cili është atje lart, se kjo ka qenë arsyeja pse e sollëm më përpara këtë pikë të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Ta kini parasysh kjo është pika e 9-të, pastaj Avokati i Popullit është pika e 10-të, e 11-ta ka qenë RTK-ja. E kisha ftuar në ndërkohë ministrin e Drejtësisë që të futet në sallë.

Komisioni për Legjislacion ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit për Legjislacion, deputeten Selvije Halimi, që ta bëjë arsyetimin e raportit me rekomandime.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pajtim me nenin 73 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 maj 2015, e shqyrtoi raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/ L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin që të shqyrtohet dhe të miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për

Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë.

Komisioni për Legjislacion e ka përmbushur obligimin e tij të përcaktuar me nenin 73 të Rregullores së Kuvendit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nga fusha e përgjegjësisë së tij, ka ushtruar mbikëqyrjen e Ligjit 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale. Për ta realizuar këtë mbikëqyrje, komisioni ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe Lipjan dhe e hartoi raportin me rekomandime, i cili është para jush.

Rekomandimet për institucionet:

- Të merret nisma për nxjerrjen e Ligjit për amnisti nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Drejtësisë;
- Të rishikohen dispozitat e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale që kanë të bëjnë me përbërjen e Panelit për Lirim me Kusht, të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor jashtë institucionit korrektues, si dhe nxjerrja e udhëzimeve administrative në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale që kanë të bëjnë me rendin shtëpiak dhe beneficionet;
- Sigurimi i objekteve të ndara për të paraburgosurit;
- Trajtim më serioz në raport me kërkesat për falje nga Presidentja;
- Funksionim i mirëfilltë i shërbimit social në raport me trajtimin e kërkesave të të burgosurve;
- Të rishikohen dispozitat e Ligjit për Kodin e Drejtësisë për të Mitur, që ka të bëjë me paraburgimin dhe shqiptimin e dyfishtë i masave për të mitur nga gjykatat;
- Organizim dhe kontroll i stafit në institucionet korrektuese dhe
- Të rishikohet memorandum i lidhur ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, që kanë të bëjë me trajtimin shëndetësor të të burgosurve jashtë qendrës korrektuese.

Të nderuar deputetë,

Komisioni bashkë me rekomandimet e ka sjellë edhe raportin i cili është hartuar në bazë të të gjeturave faktike. Andaj, si komision dhe në emër të komisionit kërkoj nga ju që ta miratoni, dhe rekomandimet e komisionit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04 /L – 149 për ekzekutimin e sanksioneve penale. Grupi parlamentar rekomandon deputetët që të miratohet ky raport dhe u jep mbështetje, sidomos përfundimeve dhe rekomandimeve për institucionet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ademaj e ka fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe kolegët deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe rekomandimin e komisionit të ligjeve për aprovimin e këtij raporti. Ne si grup parlamentar mendojmë se raporti i komisionit të ligjeve e jep një pasqyrë reale të gjendjes në shtëpitë ndëshkuese korrektuese nëpërmjet vizitave që ky komision ka realizuar atje.

Raporti nxjerr diku 16 përfundime dhe nga to 8 rekomandime, të cilat mendojmë që duhet të merren në konsideratë nga institucionet kompetente. Problemi kyç që këto rekomandime vënë në pah është nxjerrja e Ligjit për amnisti dhe funksionalizimi i institucionit të faljes, normalisht duke e mos nënçmuar rekomandimet tjera. Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin me përfundime dhe rekomandime të komisionit të ligjeve dhe të njëjtin do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosje”, zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë,

Kryesi e Kuvendit,

Së pari e përgëzoj komisionin për punën e bërë, por më duhet të theksoj që është evidente që raporti i Komisionit për Legjislacion nuk përmban të gjitha problemet me të cilën ballafaqohen të burgosurit. Të burgosurit që kanë kryer vepra penale po e kryejnë dënimin për krimin, por edhe këta edhe të paraburgosurit i kanë të drejtat e tyre, të cilat janë të njohura me konventat ndërkombëtare e që aplikohen me ligjet tona.

Personat e privuar nga liria kanë ndikim shumë të kufizuar në fatin e tyre dhe tërësisht varen nga autoritetet për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre. Mirëpo, këto autoritete jo që nuk i mbrojnë të drejtat, por janë shkelësit më të mëdhenj të këtyre të drejtave.

Institucioni i burgut duhet të jetë institucion për risocializim, pra aty të burgosurve duhet t’u jepen aftësi dhe shkathtësi të reja, ashtu që kur të dalin nga burgu të kenë mundësi të gjejnë punë. Por, raporti nuk ka treguar se çfarë ndodh me ata që kryejnë dënimin se sa prej tyre kthehen përsëri në burg. Raporti nuk e adreson çështjen kyçe të sistemit atë të risocializimit. A i aftëson burgu të dënuarit për një jetë më të mirë dhe një jetë të re, apo i kriminalizon ata edhe më shumë? Raporti vetëm konstaton që ka mungesa të programeve të risocializimit, për çdo Qeveri kjo do të duhej të ishte prioritet.

Është shqetësuese rasti në rritje i vetëvrasjeve në Burgun e Dubravës. Autoritetet shtetërore në këtë rast në institucionet korrektuese të Kosovës kanë përgjegjësi për ofrimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe mirëqenies sociale të personave të dënuar derisa janë nën autoritetin e tyre. Burgu në Dubravë vuan nga mbipopullimi i theksuar, gjatë viteve të fundit dhe në këto kushte sistemimi i duhur i të dënuarve është sfidues, sepse shpesh vendosen në të njëjtën qeli një i burgosur që e ka kryer një vepër të rëndë penale dhe një i burgosur tjetër, i cili i ka shkelur rregullat e komunikacionit, gjë e cila ka përfunduar me fatalitet në kohën e fundit kur në rastin e një të riu, i cili kishte kryer vetëvrasje, pasi ishte dhunuar seksualisht në qeli.

Pra, nuk po respektohen as kriteret bazë të vendosjes në mënyrë që këto raste të parandalohen e për këtë dikush duhet të jep llogari. Në çdo vend normal, së paku drejtori do të duhej të jepte dorëheqje, por në do vende edhe ministri do të jepte dorëheqje për këto raste. Të burgosurit për veprat e kryera tashmë po e vuajnë dënimin, janë të privuar nga liria dhe është e padrejtë dhe çnjerëzore që këta persona ta marrin edhe një dënim të dytë jo të shqiptuar nga drejtësia, por nga papërgjegjësia e institucioneve përgjegjëse.

Nëse i shikojmë rekomandimet e Komisionit të Legjislacionit, nevoja për nxjerrjen e Ligjit amnisti, të gjithë sot jemi dëshmitarë se me vite të tëra të burgosurit në Kosovë e kanë kërkuar të drejtën e tyre për amnisti, ashtu siç e parasheh edhe konventat ndërkombëtare, as më pak, e as më shumë. Ata janë mashtruar në vazhdimësi nga ministri i Drejtësisë se kinse së shpejti do të ndodhë një gjë e tillë, këto gënjeshtra bëheshin vetëm për të ndaluar protestat e të burgosurve për një kërkesë krejt legjitime të kësaj kategorie të shoqërisë.

Pra, gjersa ende sot ministri i Drejtësisë nuk e ka sjellë në Kuvend Ligjin për amnisti dhe e kemi në kohë një vonesë të pashpjegueshme të pushtetit në këtë çështje, në vitin 2013 ndodhi po ashtu një nguti e pashpjegueshme, një projektligj për amnisti u soll në Kuvend, por kjo nuk ishte për të burgosurit që tashmë i vuanin dënimet e tyre, por ishte amnisti për strukturat paralele serbe në veri, të cilët dogjën shtëpitë dhe pikat doganore, vranë policët qytetarë, të cilët e luftuan dhe po vazhdojnë ta luftojnë aktivisht shtetin e Kosovës.

Më tej, në po këto rekomandime thuhet se nuk funksionon paneli për lirinë me kusht, i cili deri më tani nuk ka siguruar korrektësi dhe drejtësi për të dënuarit. Ata që kanë pasur ndonjë lidhje me zyrtarë të lartë kanë përfunduar me lirim me kusht, ndërsa të tjerët, ndonëse i kanë plotësuar këto kushte, nuk janë liruar. Pra, Paneli për Lirim me Kusht është për keqardhje, pasi, edhe pse të burgosurit i plotësojnë kushtet për lirim me kusht, të njëjtëve u refuzohen kërkesat e tyre, madje refuzimin e kanë shabllon, vetëm se ndryshohet emri dhe mbiemri i të burgosurve. Pra, është tejet e nevojshme që të rishikohet ky panel, në mënyrë që të garantohen të drejtat e të burgosurve.

Gjithashtu, problem shqetësues mbetet fakti i mbajtjes në paraburgim për një kohë të gjatë. Anëtarët e Komisionit të Legjislacionit gjatë vizitës në Burgun e Dubravës, kanë raportuar që janë takuar me persona që janë 7, 6, 5 vjet në paraburgim. Kjo është në shpërputhje të plotë me Kodin e Procedurës Penale. Gjithashtu, mosfunksionimi i institucionit të faljes, ne jemi të vetëdijshëm që në të kaluarën ky institucion është keqpërdorur, por kjo nuk është arsyeja të mos shfrytëzohet një e drejtë në Kushtetutë dhe në rrethanat, të cilat janë të njohura me ligj.

Disa probleme të tjera janë: mosllogaritja e paraburgimit në rastin e shqiptimit të dënimit nga ana e gjyqtarëve për të mitur dhe shqiptimi i dyfishtë i masave për të mitur nga ana e gjykatave. Shqetësim tjetër paraqet edhe trajtimin apo diskriminimin ndaj të burgosurve, sa u përket të drejtave të tyre për pushime, vikende, apo në afat kohor të përfundimit të paraburgimit. Ka raste kur të burgosurit lirohen më herët se sa masat e parapara për paraburgim dhe raste kur mbahen më shumë se sa janë shqiptuar masat e paraburgimit.

Dukuria e nepotizmit po ashtu, është e stërtheksuar në Qendrën e Dubravës. Vetë drejtori, sipas raportimit, ka pohuar se aq shumë ka nepotizëm, sa që as deri të axha nuk mbërrin. Domethënë

pra, janë të punësuar: babai, nëna, gruaja, motra, vëllai, djali, e kështu me radhë. Kjo është tejet shqetësuese, sepse qendrat korrektuese nuk janë biznese private.

Në përgjithësi, ne do të mbështesim raportin, por besojmë edhe këto çështjet tjera duhet të shqyrtohen në të ardhmen.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Zoti Shala, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi i “Nismës” e ka shqyrtuar këtë raport të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitet dhe Rregulloren e Mbikëqyrjes së Kuvendit.

Besoj se të gjitha rekomandimet që i dhanë parafolësit tonë, të mos i përsërisim ne si grup. Jemi në dakord me atë që janë thënë. Janë disa të gjetura, që i përmendi edhe parafolësi nga Lëvizja “Vetëvendosje”, kështu që ne si grup do ta mbështesim këtë raport të legjislacionit në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Të nderuara deputete,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pas kërkesës së një grupi të burgosurish ka mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, duke vizituar qendrat korrektuese në Dubravë dhe Lipjan.

Ajo që nga raporti bie në sy, sidomos pjesa që ka të bëjë me përfundimet dhe rekomandimet, është që Komisioni, mbase kjo ka të bëjë edhe me kërkesën e të burgosurve, është përqendruar kryesisht në ato pika që përbëjnë shkelje të drejtave të burgosurve, ose përpjekje për t’i rregulluar çështjet e beneficioneve, çka unë e konsideroj të arsyeshme.

Pjesa që pjesërisht mungon në raport, me të cilin Komisioni është marrë më pak, është neni 4 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ky nen përcakton si qëllime kryesore risocializimin dhe reintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë, si dhe për sjellje të përgjegjshme dhe mbrojtjen e shoqërisë përmes parandalimit dhe veprave të tjera penale, duka ia shtuar kësaj edhe pjesën e prevencionit.

Derisa pjesa e dytë e qëllimit sipas nenit 4 realizohet automatikisht, kur një qytetar dënohet dhe futet në burg për fajin që ka bërë, pjesa e parë e këtij neni, respektivisht realizimi i qëllimit varet kryesisht nga fakti nëse institucionet tona kryejnë si duhet punën që u takon, pra për t’i përgatitur të burgosurit për një jetë normale dhe të përgjegjshme, karshi të tjerëve jashtë rrethojave të burgut.

Kjo edhe është pika kryesore me të cilën është dashur të merret Komisioni gjatë kontrollit që ka bërë në Qendrën e Korrektimit në Dubravë dhe Lipjan. Vuajtja e privimit nga liria nuk është hakmarrje e shoqërisë për të dënuarin, por një mundësi që një shoqëri e përparuar i jep një të

burgosurit për t'u kthyer në binarët e jetës, pavarësisht nga arsyet që personin e dënua e kanë shtyrë për ta bërë një veprim të dënueshëm.

Privimi nga liria është një masë bukur e kushtueshme, për të cilën paguan shoqëria. Pra, i burgosuri i kushton shoqërisë dhe ky çmim nuk është për t'u nënvlerësuar. Një, për shkak të obligimit ligjor dhe dy, për shkak të çmimit të lartë, kjo masë do të duhej të shfrytëzohej në formën më të mirë të mundshme, që të jetë e efektshme. Se sa kjo masë do të jetë e efektshme varet, para së gjithash nga ato që ofron shteti brenda institucioneve të tij, për t'i mbështetur këta qytetarë që të kthehen në shoqëri dhe të vazhdojnë jetën.

Raporti i Komisionit thotë, për të gjithë ata që e kanë lexuar me kujdes, që njohin ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, se ky ligj zbaton vetëm pjesërisht, do të thotë zbatohet vetëm pjesërisht, vetëm në pjesën që ka të bëjë me izolimin e qytetarëve të dënua nga shoqëria, por shumë më pak me pjesën që ka të bëjë me integrimin e tyre në shoqëri. Këtë përfundim e nxjerr nga pjesa e raportit, pika 8 e përfundimeve, që flet për mungesën e programeve të risocializimit.

Neni 4 i ligjit në fjalë ka të bëjë me secilin prej të burgosurve me dënim të prerë. Institucionet e Kosovës janë të obliguara me ligj për secilin të burgosur të ofrojnë programe risocializimi, që u përshtaten nevojave të burgosurit konkret. Përndryshe, ne harxhojmë kot milionë euro dhe në fund nuk arrijmë të realizojmë atë që kemi planifikuar dhe atë që parasheh ligji, respektivisht pika 4 e këtij neni.

Unë i propozoj Komisionit, duke u mbështetur në përfundimet që sjellë ky komision tek rekomandimet, pra thuhet që një prej përfundimeve është që mungojnë programet e risocializimit, ndërsa te rekomandimet kjo pikë nuk është futur, pra propozoj që si pikë, nen, të shtohet, të rritet numri i programeve të risocializimit dhe të sigurohet që secili i burgosur të marrë pjesë në to.

Për shkak se Kuvendi i Kosovës ka sjellë një varg rekomandimesh, që kurrë nuk janë implementuar nga Qeveria, tek rekomandimet të futet edhe kjo pikë: "Qeveria në afat prej tre muajsh i paraqet një raport me shkrim Komisionit për secilin program të risocializimit veç e veç, duke e përshkruar në mënyrë të detajuar programin, qëllimet, ndikimin e programit në realizimin e qëllimeve dhe për numrin e pjesëmarrësve në programet e risocializimit. Raporti përshkruan se cilat programe të reja janë paraparë, raporton për kohën e fillimit të implementimit, qëllimet e tyre dhe masat që ka ndërmarrë Qeveria që të sigurojë për secilin të burgosur implementimin e ligjit sipas nenit 4." Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, e dëshironi fjalën? Zoti Kuçi, ministër i Drejtësisë, e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të falënderoj Komisionin për Legjislacion për punën e bërë në monitorimin e këtij ligji dhe dua të besoj që monitorimi i zbatimit të ligjeve është puna kryesore, që me kënaqësi do të bashkëpunoja me Komisionin, në cilindo rast, jo vetëm në këtë ligj, por edhe në ligjet tjera.

Po ashtu, me lejoni të them se kam qenë i përkushtuar në tërësi për anëtarët e Komisionit, që të kenë qasje të plotë në të gjitha institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës, kontakte të drejtpërdrejta me të burgosurit, por edhe me stafin tjetër. Pra, ta marrim informatën dhe të vërtetën e dyanshme dhe jo vetëm atë që përfaqësojmë.

Në anën tjetër, rekomandimet që kanë ardhur tetë sosh dhe unë pajtohem edhe me atë që tha zoti Topalli, në veçanti për risocializimin, se ne shpeshherë e shohim dënimin si hakmarrje e jo si diçka që ai duhet të kthehet në jetën e tij, unë kam bërë një program të veçantë për risocializimin e tyre dhe kam tentuar që edhe në Kodin Penal të bëhen dënimet alternative, ku qytetarët e Republikës së Kosovës, për veprat e imta, po them, apo të vogla, të jenë me dënime alternative dhe më shumë të bartin një evidencë për ata.

Më lejoni të them, që në momente të caktuara, sidomos me të miturit, kemi qenë të kujdesshëm që ata të risocializohen, të trajnohen, por edhe të kryejnë shkollime adekuate gjatë kohës kur ata janë në shërbimet korrektuese.

Është e vërtetë që kemi disa telashe lidhur me qendrat e paraburgimit dhe kjo për nga numri i madh i të paraburgosurve, por ajo që dua të them, ne nuk e marrim vendimin për ata që janë në paraburgim apo që duhet të jenë, po ne jemi të kujdesshëm që vendimet e tilla të zbatohen. Po ashtu, më lejoni të them, që do t'i bëja ftesë edhe Komisionit, që disa rekomandime që dalin nga ky ligj e që nuk janë kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë, t'ua dërgojmë edhe të tjerëve.

Po e marr shembull Panelin për Lirim me Kusht, e dini që me iniciativën time ka shkuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Po ashtu, më lejoni të them që edhe çështjet që kanë të bëjnë me dhomat e paraburgimit, se ne kemi filluar më herët qendrat e paraburgimit, besoj se brenda këtij viti do ta përfundojmë në Prishtinë dhe në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, që në Prishtinë do të shtohet. Tani është rreth 70 vende, do të shtohet në 300 vende, po ashtu edhe në Gjilan dhe do të krijohet një hapësirë përafërsisht e mjaftueshme, por kjo varet nga njerëzit që mund të shkojnë aty.

Më lejoni t'i përmend edhe dy çështje dhe besoj, që duhet ta përfundojë, duke i pranuar rekomandimet në tërësi dhe duke tentuar, që ato që janë në kompetencë timen edhe t'i implementoj.

U përmend çështja lidhur me nepotizmin këtu. Në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe në Lipjan, asnjë gardian, po e përsëris, asnjë, nuk është pranuar në mandatin tim, por as nuk kam qitur prej pune. Dhe e dyta, unë e kam pranuar, ose ne kemi pranuar, vetëm në Qendrën e Burgut të Sigurisë së Lartë në Dyz. Dhe po ashtu, po e përmend edhe një fakt, se po përmendni fjalorë të ndryshëm, jo rrenë, jo tjetër, po ju them publikisht, për aq sa jam ministër, kurrë në jetë s'e kam ndërmend t'i përgjigjem fjalorit joparlamentar. Kërkesave tuaja politike, juridike, për punën time, 24 orë do të jem i gatshëm t'u përgjigjem. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe këtë e lëmë për në orën 18:00 kur e kemi lënë votimin. Edhe dy minuta? Bjerini ziles regjia, në qoftë se ka deputetë të mjaftueshëm jashtë... Sonte e kryejmë, sonde krejt... pse jo?

10. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014

Komisioni Funkcional për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj Avokatin e Popullit, zotin Sami Kurteshi, që para Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin vjetor. Sa për sqarim, mbështetur në nenin 27, paragrafi 2, të Ligjit të Avokatit të Popullit, parashihet që Avokati i Popullit t'ia paraqesë Kuvendit të Kosovës raportin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues. Avokati i Popullit e paraqet raportin në seancë plenare, në të cilën diskutohet. Zoti Kurteshi, e keni fjalën.

AVOKATI I POPULLIT, SAMI KURTESHI: I nderuar zoti kryesues i seancës, faleminderit për fjalën e dhënë!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, unë paraqes raportin e 14-të vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Raportimi vjetor i Avokatit të Popullit ofron një mundësi të mirë për të gjitha institucionet shtetërore për t'ua kujtuar se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet dhe ushtron autoritetin e saj, bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj. Kjo është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 1.

Kjo normë kushtetuese rikujton, se respektimi i të drejtave të njeriut nuk është thjesht një qëllim, në mes tjerash, por se respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut sipas Kushtetutës, përbën themelin e shtetit tonë. Ky raport jep një pasqyrë të gjithë punës së institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 dhe ofron dëshmi të hollësishme për gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës gjatë kësaj periudhe.

Pak statistikë për krijimin e një pasqyre kuantitative. Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2014, nga mbi 3000 njerëz të ndryshëm janë parashtruar 2224 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike nga qytetarët e Kosovës dhe janë nxjerrë 141 rekomandime të ndryshme për institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës, duke shënuar një rritje diku rreth 10% nga viti 2013, përgjatë të cilit janë trajtuar 2047 raste dhe ka pasur 127 rekomandime të pashqyrtuara nga ana e autoriteteve publike, meqenëse raporti i vitit 2013 nuk është shqyrtuar në Kuvend.

Një trend i përafërt i rritjes së numrit të ankesave të paraqitura në institucion vazhdon edhe në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2015. Megjithatë rreth 75% të rasteve apo 1687 raste të paraqitura tek institucioni janë shpallur si të papranueshme, Avokati i Popullit dhe stafi i tij janë të ndërgjegjshëm se individët që vijnë në dyer të institucionit, qofshin edhe me ankesa të bazuara

apo të pabazuara, shpeshherë e shohin Avokatin e Popullit si mundësinë e fundit për t'i zgjidhur problemet e tyre, por edhe si instancën e fundit për t'i paraqitur pakënaqësitë e tyre për mospunën e institucioneve shtetërore.

Mirëpo, edhe në rastet në të cilat institucionit i mungon kompetenca ligjore për të vepruar, madje sidomos në këto raste, Avokati i Popullit i dëgjon të gjithë ata që ndjejnë nevojën për t'u shprehur dhe për t'u dëgjuar për problemet e tyre, pa asnjë dallim. Çdokush pritet, dëgjohe me kujdes dhe ndihmohet, aty ku është e mundur apo këshillohet aty ku është e nevojshme. Çdonjëri në territorin e Republikës së Kosovës është prioritet i Avokatit të Popullit.

Ky raport ndahet në 4 kapituj. Kapitulli i parë paraqet një prezantim të kompetencave, përgjegjësiave dhe mandatit të institucionit. Gjithashtu, kapitulli i parë përsërit një rekomandim, që Kushtetuta të amendamentohet për t'i përfshirë tri instrumente ndërkombëtare në listën e instrumenteve ndërkombëtare, që zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, e këto janë: Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të OKB-së; Karta Sociale Evropiane dhe Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Rekomandimi për dy instrumentet e para i përsëritur disa vite me radhë nga Avokati i Popullit, deri më tani është shpërfillur plotësisht nga autoritetet kompetente për amendamentimin e Kushtetutës.

Kapitulli i dytë ofron një përmbledhje të hollësishme të punës së Avokatit të Popullit lidhur me të gjitha të drejtat dhe liritë themelore, të përcaktuara në Kushtetutë.

Kapitulli ndahet në tri pjesë dhe ky është kapitulli kryesor. Pjesa e parë përfshin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas radhitjes në kapitullin e dytë të Kushtetutës, pjesa e dytë trajton temën e diskriminimit si formë e veçantë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, ndërsa pjesa e tretë trajton tërë problematikën e gjyqësorit në mënyrë të hollësishme.

Pas raportimit të hollësishëm të secilës të drejtë, kapitulli i tretë i këtij raporti jep disa informacione lidhur me veprimtaritë e zhvilluara nga sektorët e ndryshëm të institucionit, duke përfshirë bashkëpunimin e tij me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Kapitulli i katërt përfundon raportin me një përmbledhje statistikore të ankesave të pranuar në institucion gjatë vitit 2014.

Siç dëshmohet qartë në këtë raport, si në aspektin narrativ ashtu edhe në atë statistikor, në Republikën e Kosovës dështimet e njëpasnjëshme të institucioneve shtetërore për përmbushjen e obligimeve të tyre lidhur me të drejtat e njeriut, janë paraqitur si qindra pllakëza të vogla, të cilat kur bashkohen e formojnë një mozaik të pafund të mospërfilljes dhe papërgjegjshmërisë institucionale.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është për të nxjerrë para publikut, pa asnjë rezervim a zbutje artificiale, gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Kjo gjendje që ndonëse nuk mund të dallohet, duke analizuar secilin dështim të izoluar prej të tjerave, bëhet e qartë vetëm duke i shikuar të gjitha dështimet bashkë, madje edhe më keq, duke vërejtur modele të përsëritura të

shkeljeve të ndryshme, të kryera nga një varg institucionesh shtetërore lidhur me një rang të gjerë të drejtash dhe lirive të njeriut.

Në fushën legislative ky raport jep shembuj të dështimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për t'i shqyrtuar rekomandimet e Avokatit të Popullit, për miratimin e ligjeve të reja, ose për ndryshimin e ligjeve aktuale, që ndikojnë në të drejtat dhe liritë e njeriut. Kjo bëhet edhe më shqetësuese, nëse vërejmë faktin se vitin e kaluar raporti i Avokatit të Popullit nuk është diskutuar fare në Kuvend, në seancë plenare.

Një dështim tjetër përbën zvarritja e zgjedhjes së Avokatit të ri të Popullit, që nga qershori i vitit 2014. Natyrisht, pozitivisht, sa i përket legjislativit, duhet theksuar edhe një falënderim publik, që meriton angazhimi i Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut i legjislaturës së kaluar dhe i kësaj legjislature, për bashkëpunim me institucionin. Një nismë të mirë tani e ka bërë edhe Komisioni Parlamentar për Legjislacion.

Po ashtu, nuk mund të lehet pa përmendur fakti, se gjithë këto dështime ndërlidhen ngushtë me krizën politike në vend pas zgjedhjeve të qershorit 2014, për të konstituuar legjislaturën e re të Kuvendit. Ky raport tregon, se ngërçi politik gjashtëmujor nuk ka qenë vetëm farsë, por ka qenë një goditje e rëndë për të drejtat dhe liritë e njeriut, duke lënë të pashqyrtuara një serë reformash legislative të propozuara dhe rekomandimesh të bëra nga Avokati i Popullit. Në disa raste këto rekomandime janë përsëritur me vite.

Pas një viti të tillë, Avokati i Popullit pret që reformat e propozuara dhe rekomandimet e bëra, të cilat shtjellohen sipas temave të ndryshme në këtë raport, të shqyrtohen dhe të zbatohen pa vonesë nga legjislatura e re e Kuvendit.

Dukshëm më i rëndë në vitin 2014 ka qenë dështimi i ekzekutivit, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në nivelin komunal. Të dhënat e këtij raporti dëshmojnë se në vitin 2014, si në vitet e mëparshme, refuzimi ose dështimi i plotë për t'u përgjigjur në kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, vazhdon të jetë një sëmundje kronike e përhapur midis autoriteteve më të larta të shtetit, duke përfshirë presidenten, ish-kryeministrin, kryeministrin aktual, ministrin të ndryshëm të Qeverisë së re dhe të vjetër, përfshirë edhe ministrin aktual të Arsimit dhe ministrin aktual të Punës dhe Mirëqenies Sociale, sidomos.

Këtyre dy ministrave, si dhe kryeministrit Mustafa, Institucioni i Avokatit të Popullit u ka dhënë disa herë mundësinë për t'u përgjigjur në raportet e dërguara, bashkë me rekomandimet e dhëna. Deri më tani, të dy ministrat i kanë shpërfillur plotësisht këto raporte me rekomandime. Megjithatë, po shpresoj se kryeministri Mustafa dhe ministrat Bajrami dhe Abrashi do të përfitojnë nga kjo seancë plenare për t'u përgjigjur, meqenëse ata nuk janë këtu, nuk kam çka u bëj këtyre... me rekomandime para gjithë publikut, si dhe për t'u përgjigjur për dështimin e tyre për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit.

Duhet theksuar këtu se bashkëpunimi me Avokatin e Popullit nuk është çështje e vullnetit të lirë, por është detyrim ligjor. Dështimi ose refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila përcakton qartë se çdo organ, institucion, ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e

Kosovës është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij, ose asaj të gjitha dokumentet, informacionet e kërkuara, në pajtim me ligj. Ndërsa, sipas ligjit për Avokatin e Popullit dështimi ose refuzimi për t'u përgjigjur konsiderohet pengim i punës së tij.

Në bazë të këtij standardi pengimi i hetimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet më të larta ekzekutive në Republikën e Kosovës është jashtëzakonisht shqetësues dhe i pashpjegueshëm për një shoqëri demokratike. Premtimi shpresëdhënës dhe i ligjshëm në fjalimin inaugurues i zotit Mustafa, si i dominuar për postin e kryeministrit, se Qeveria do t'i vendosë të drejtat e njeriut lartë në agjendën e saj politike dhe do të sigurojë, që rekomandimet e Avokatit të Popullit të adresohen në mënyrë adekuate mbetet të shihet se sa do të zbatohet në praktikë.

Përvoja disamujshke nuk ka dhënë shpresa, por ka nëpërkëmbur ndjeshëm këto shpresa. Në këtë fushë, kryeministri Mustafa dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, vlerësohen me notë jo kaluese, së paku deri tani. Megjithatë, Avokati i Popullit ligjërisht pret bashkëpunim më të frytshëm në të ardhmen, si nga presidentja, ashtu edhe nga kryeministri, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas detyrimit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Gjendja e gjyqësorit sa i përket të drejtave të njeriut, fatkeqësisht vazhdon të jetë jashtëzakonisht shqetësuese dhe me shpresa të pakta për përmirësim në një të ardhme të afërt. Në gjendjen e tanishme gjyqësori është duke u shndërruar nga mbrojtës, në shkelës të drejtave dhe lirive të njeriut, duke rezultuar në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë për sundimin e ligjit.

Probleme të shumta që kanë pllakosur gjyqësorin e Republikës së Kosovës përfshijnë: mosfunksionimin e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, zvarritjen në vendosjen e lëndëve civile dhe penale, numrin në rritje të lëndëve të pazgjidhura nga vitet paraprake, shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, parashkrimin e lëndëve gjyqësore, vendime dhe procese gjyqësore ndaj gjyqtarëve për korrupsion, vendime moszbatimi në praktikë të normave të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe mos interpretimin e vendimeve gjyqësore sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pavarësisht nga këto dështime të gjyqësorit, të dëshmuara edhe në vitet e mëparshme, në vitin 2014 kemi parë edhe një dështim të jashtëzakonshëm nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Aktvendimet e Gjykatës, në raste të caktuara, përveçse nuk përmbushin as standardet minimale intelektuale, juridike dhe profesionale, ka dëshmi objektive për falsifikim të dokumenteve zyrtare, si dhe fshehje të dokumenteve dhe dëshmive zyrtare. Në këtë periudhë tranzicionale për Gjykatën, kur po zëvendësohet kryetari i vjetër me një kryetare të re, që të dy gjenden nën hetim penal nga Prokuroria Speciale dhe në vend se të jenë transparent me gjithë faktet para publikut, që të dy po mundohen t'u shmangen të gjitha pyetjeve legjitime për veprimet e tyre, duke u fshehur prapa imunitetit.

Këto janë zhvillime shqetësuese, si për shoqërinë, ashtu edhe për vetë Gjykatën, e cila është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës, për interpretimin e Kushtetutës.

Të gjitha këto mangësi objektive e subjektive të gjyqësorit dhe të gjykatësve, kanë bërë që njerëzit të humbin plotësisht besimin në drejtësinë institucionale, në gjyqësorin dhe jo vetëm po

përcillen, por po thellohen nga viti në vit. Avokati i Popullit më shumë se një herë ua ka tërhequr vërejtjen institucioneve publike përgjegjëse, madje edhe nga kjo foltore, për këtë dukuri të rrezikshme.

Pikërisht kjo humbje e besimit në shumë raste ka bërë që njerëzit të marrin drejtësinë në duart e veta, duke i zgjidhur kontestet e tyre jashtë sistemit gjyqësor, shpeshherë në mënyrë tragjike. Në këtë mënyrë kemi edhe raste të kalimit nga kontestet civile në ato penale. Për këto raste kemi paraqitur dëshmi konkrete në këtë raport.

Besimi ndërmjet qytetarëve dhe shtetit, që përfshin të gjitha format e mundshme të komunikimit, bazohet vetëm në respektimin e normave të kodifikuara shoqërore të ligjeve. Ky besim është në përpjesëtim të drejtpërdrejtë me integritetin e zyrtarëve të shtetit të autoriteteve publike. Besimi ka të bëjë me respektimin e ligjeve dhe krijimin e mekanizmave të brendshëm veprues efektiv të autoriteteve publike për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.

Kur, fjala vjen, për administratën shtetërore, shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, shkelja e parimeve themelore të një administrate publike moderne, si mos diskriminimi dhe proporcionaliteti, përveç shkeljeve ligjore përbëjnë edhe shkelje të rënda të veprimit etik. Shkelja e ligjit nga vetë autoritetet publike dhe sidomos veprimi jo etik, qoftë edhe në një rast të vetëm individual, kur mbetet i pa sanksionuar shlyen tërësisht çfarëdo besimi në shtetin dhe përbëjnë dëshminë kyçe të keqadministrimit dhe dështimin e një sistemi të administratës.

Një administratë publike me kulturë demokratike në një shtet të së drejtës nuk guxon të vuajë, as nga aktivizmi juridik i politikës dhe as nga aktivizmi politik i gjyqësorit. Këto skajshmëri veprimi ofensiv të pushteteve të ndara domosdo duhet të shkrihen në një kulturë demokratike të ndërveprimit ligjor, ndërinstitutional, ku kufiri i ndarjes është normë e legjitimuar në mënyrë demokratike që duhet respektuar pa përjashtim.

Vetëm një shkrirje e tillë, ku shqyrtimi gjyqësor bëhet pjesë e veprimit administrativ si proces publik, garanton rolin plotësues apo komplementar të gjyqësorit dhe administratës në një shoqëri demokratike si drejtësi e normuar, shoqërisht e pranueshme dhe institucionalisht e zbatueshme. Vetëm në shoqëri të tilla, ku shqyrtimi gjyqësor i veprimeve të administratës publike nuk kuptohet si përzierje në procedurën administrative, por si pjesë e pandashme e saj, mund të flasim për siguri ligjore për respektim të drejtave dhe lirive të njeriut në procesin administrativ. Për të arritur këtë kërkohet jo vetëm ndërtimi i një kulture politike i mosndërhyrjes dhe ndikimit të çfarëdo forme në gjyqësor dhe tek gjykatësit si individë, por edhe një politikë kulturore e të kuptuarit se ndarja gjyqësore e drejtësisë nuk është gjë tjetër veçse vazhdimësi e veprimit administrativ shtetëror. Ky është obligim që kërkohet nga ne sot, nesër dhe në të ardhmen edhe nga Evropa, pjesë e së cilës ne pretendojmë të jemi. Kjo është edhe kërkesë shprehimore e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nëse duam të jemi pjesë e drejtësisë institucionale të Evropës.

Në raportin vjetor të vitit 2013, Avokati i Popullit ka theksuar se respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qeverisja e mirë janë obligim i autoriteteve publike. Prandaj, Avokati i Popullit fton të gjithë personat përgjegjës...

KRYESUESI: Sami, je i ftuar që të raportosh dhe jo të luash rolin, herë të prokurorit të përgjithshëm, herë të “babait të kombit”, të lutem!

AVOKATI I POPULLIT, SAMI KURTESHI: Zoti kryesues, Unë e kam edhe gjysmë minute, një. Dhe, e dyta, kjo është përmbledhje e një raporti prej 200 faqesh të detajuar.

KRYESUESI: Vazhdo, vazhdo, vetëm po të tregoj që këtu je për të raportuar, e jo për të na këshilluar.

AVOKATI I POPULLIT, SAMI KURTESHI: Mund ta ndërpres kur të doni, nuk e kam ndonjë problem.

Prandaj, Avokati i Popullit i fton të gjithë personat përgjegjës në institucionet publike, që të mos i injorojnë ankesat e qytetarëve. Po ashtu, fton autoritetet publike që rekomandimet e Avokatit të Popullit t’i marrin seriozisht dhe t’i trajtojnë si kontribut konstruktiv, sepse paraqesin një mundësi të mirë për të mësuar nga gabimet dhe lëshimet dhe rrjedhimisht për përmirësimin e administratës shtetërore në përgjithësi. Fatkeqësisht, siç dëshmohet edhe në këtë raport, një pjesë e madhe e institucioneve publike, sidomos autoritetet më të larta të shtetit, nuk e kanë pranuar këtë ftesë.

Megjithatë, Avokati i Popullit përzemërsisht i falënderon të gjithë ata zyrtarë, që në vitin 2014 janë treguar të përgjegjshëm dhe të gatshëm për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit, në përputhje me obligimet e tyre ligjore dhe kushtetuese. Institucioni i Avokatit të Popullit mirëpret bashkëpunim të vazhdueshëm me këta zyrtarë, si dhe fton të gjithë zyrtarët tjerë, sidomos ata në krye, që t’i ndjekin shembujt e mirë në këtë drejtim, në mënyrë që të hapin rrugë për avancimin sa më të shpejtë... dhe lirive themelore në Republikën e Kosovës.

Faleminderit për dëgjimin dhe më vjen keq që është tepruar koha. Unë jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e deputetëve.

KRYESUESI: Unë nuk di në këtë raport, çka kemi për të bërë pyetje ne, s’po kuptoj. Po sidoqoftë, fjala është e deputetëve. Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar, zonja Mjaku-Topalli.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Ministër i Drejtësisë,

Avokat i Popullit,

A të flasë kryetarja e komisionit, apo ta vazhdoj fjalën? Atëherë, kryetarja e komisionit e ka fjalën.

KRYESUESI: Mirë de, kryetarja e komisionit, merre fjalën. Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

S’e kam prej merakut, e kam prej obligimit. Faleminderit për fjalën!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues, po vërehet lodhja te ju.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2015, ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia rekomandojë për miratim.

Interesimi i shtuar i qytetarëve të Republikës së Kosovës, flet për rolin, që gjithnjë e më shumë po e zë institucioni i Avokatit të Popullit në jetën e qytetarëve të saj dhe përgjigjet që u ofrohen atyre dhe si shenjë e demokratizimit të shoqërisë sonë.

Raporti i Avokatit të Popullit prezanton një progres në fushën e të drejtave të njeriut, por një pjesë e madhe e tij prezanton edhe sfidat në këtë drejtim. Sigurisht, edhe ju, të nderuar deputetë, gjatë leximit dhe dëgjimit të Avokatit të Popullit këtu sot, kenë vëmendjen tek rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, i cili kërkon zgjidhje në institucionet e shtetit për qytetarët e Republikës, për kualitetin e jetës dhe për më shumë drejtësi për qytetarët e saj.

Një numër i konsiderueshëm i ankesave ka të bëjë edhe me pamundësinë e gjertanishme të përgjigjes shtetërore, për mbrojtjen në përgjithësi duke theksuar mbrojtjen shëndetësore, sociale, të drejtën për punë, të drejtën e personave me nevoja të veçanta, e tjera. Kërkesat për disa plotësim-ndryshime ligjore dhe përfshirja e disa konventave ndërkombëtare në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ngrit standardet e jetës dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Gjatë shqyrtimit të raportit të institucionit të Avokatit të Popullit, Komisioni i të Drejtave të Njeriut, mendon se është e paarsyeshme që ky institucion të vazhdojë edhe më tutje punën në objekte me qira, kur besoj se mundësitë institucionale janë më të mira për të ofruar kushte pune për këtë institucion.

Dhe, për fund, të nderuar deputetë, Komisioni për të Drejtat e Njeriut i rekomandon Kuvendit për miratim raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 dhe natyrisht, më shumë vëmendje në rekomandime të cilat ka nxjerrë ai dhe, mbi të gjitha, më lejoni ta mbyll me lutjen, që sa më shpejt të procedohet në zgjedhjen e avokatit të ri, duke e falënderuar për punë avokatin e gjertanishëm.

KRYESUESI: Zonja Mjaku e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit, raport ky i ardhur me vonesë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Për këtë raport, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson se është gjithëpërfshirës dhe se është punuar me metodologji profesionale, duke pasqyruar me sukses dhe në mënyrë tejet reale punën e këtij institucioni shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Po ashtu, konstaton progresin e pamohueshëm në fushën e të drejtave të njeriut, por edhe sfidat dhe lëshimet dhe këto në funksion të progresit të ardhshëm.

Paraqitja e gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe kahet e zhvillimeve të kësaj gjendjeje, bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të arkivuara në institucionin e Avokatit të Popullit, por edhe në informatat dhe dëshmitë e mbledhura nga burime të tjera, është postulati kryesor që e shpërfaq ky raport.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Drejtësia ligjore e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike për të gjithë individët, pa asnjë dallim, në gjithë territorin e shtetit përbën bazën e shtetit ligjor. Avokati i Popullit evidenton dhe nxjerr në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për ta forcuar rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin, se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Vlen të përmendet që ky institucion ka për synim që të jetë institucion demokratik dhe se secili qytetar i Republikës së Kosovës, të jetë prioritet i Avokatit të Popullit. Në përmbledhjen e raportit vjetor të vitit 2013, Avokati i Popullit ka theksuar se respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qeverisja e mirë, janë obligim i autoriteteve publike, si dhe ka ftuar dhe sot ftoi që të gjithë personat përgjegjës të mos injorojnë ankesat dhe kërkesat e qytetarëve.

Andaj në fund, mund të them se autoritetet publike kanë marrë seriozisht dhe kanë trajtuar disa nga rekomandimet e dala nga ky institucion, si dhe puna e këtij institucioni është vlerësuar si kontribut konstruktiv, sepse është një mundësi e mirë për përmbushjen e obligimeve ligjore dhe kushtetuese të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sigurisht se ne si grup parlamentar dhe deputetë, kemi shqyrtuar këtë raport, që është një raport voluminoz dhe një pasqyrë brenda mundësive të asaj se çfarë është bërë, edhe pse ne si institucion normalisht, gjithmonë kemi bërë dhe bëjmë përpjekje që të përkrahet si institucion i nevojshëm, i domosdoshëm, veçmas në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Megjithatë, se edhe në këtë drejtim ka pasur mundësi sigurisht, që të bëhet edhe më tepër dhe dorën në zemër, gjatë referimit të avokatit, unë prisja ndoshta edhe më shumë të thotë, edhe pse i përmendi disa sfida, po jo të tërat, edhe sikur nganjëherë rrëshqiti në më shumë në përshkrim, ose më mirë të them, duke bërë përpjekje që krejt fajet t'i hedhë diku tjetër... nuk po e them që tjerët duhet bërë elozhe institucioneve, unë mendoj që megjithatë edhe kjo nuk arsyeton, sepse edhe po qe se punët nuk shkojnë mirë dhe të tjerët nuk i kryejnë e që i kanë obligim t'i kryejnë, është mirë për t' i thënë më herët, është mirë për t' i thënë me kohë, është mirë për të na njoftuar edhe neve për të gjitha këto vështirësi.

Sidoqoftë, nuk po e them këtë për të kritikuar, por ndoshta vetë fakti se këtu kemi probleme të stërzgjatjes, të shpalljes së konkurseve edhe për avokat, ndoshta edhe ndjenja nganjëherë, në vetë atë institucion, jo vetëm te zoti Kurtoshi, që është sot për nesër, ose është kah fundi, nuk e them këtë që ai sillet kësioj, por ndoshta sillen edhe të tjerët, e bën që edhe ky institucion, për mendimin tonë, ka mundur të bëjë edhe më tepër. Sidoqoftë, raporti është ai që është dhe

deputetët tanë e kanë para vetes dhe në fund do ta bëjmë vlerësimin lidhur me këtë raport që e ka bërë, gjegjësisht do të themi fjalën tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë,

Kryesi e Kuvendit,

Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” ne mbështesim raportin e Avokatit të Popullit dhe këtu duam të përgëzojmë institucionin e Avokatit të Popullit për punën që kanë bërë në këtë raport, ngase ashtu siç u cek, është raport narrativ, por jep edhe me raste konkrete, rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë edhe me raste në aspekte statistikore. Domethënë, edhe me statistika ne e kemi të gjithë gjendjen në sektorin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Gjendja faktike e të drejtave të njeriut në Kosovë, si konstatohet në raport, është alarmante dhe me statistika dhe me raste konkrete, domethënë, e shohim këtë. Në atë aspekt ky raport po ashtu, në njëfarë aspekti po na tregon që shteti i Kosovës ka dështuar në respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha shtyllat e qeverisjes demokratike, domethënë edhe në legjislativ, ekzekutiv dhe në gjyqësor. Por, ajo që është shqetësuese dhe që duhet të përmendet është aspekti se raporti po ashtu, konstaton se jo vetëm që institucionet nuk janë në njëfarë aspekti, nuk i respektojnë të drejtat e njeriut, por ato edhe nuk bashkëpunojnë me institucionin e Avokatit të Popullit, në mënyrë që të adresohen çështjet të cilat janë kërkuar nga Avokati i Popullit.

Nga mosbashkëpunimi i presidentes deri tek mosbashkëpunimi i ministrave dhe kryeministrit, domethënë të gjitha këto tregojnë që çështjet problematike me të drejtat e njeriut nuk janë vetëm rastësi, por janë edhe sistematike, në njëfarë aspekti dhe, në atë aspekt përgëzoj për guximin dhe punën e bërë në këtë raport.

Në fund, të theksoj që nëse shikojmë edhe rritjen e ankesave të parashtruesve në krahasim me vitin 2013, në vitin 2014 janë diku rreth 10% e më shumë raste të paraqitura, jo vetëm janë dy aspekte, tregon që problemet me të drejtat e njeriut nuk janë duke u zgjidhur, por në të njëjtën kohë tregon edhe në përgjithësi është rritur besimi i popullatës karshi institucionit të Avokatit të Popullit dhe këtu duhet t'i përgëzojmë për punën që e kanë bërë. Nëse marrim parasysh, se besimi i qytetarëve ndaj të gjitha institucioneve tjera të Kosovës është në rënie edhe me të gjitha raportet e ndryshme, ky konstatim besoj se është shumë relevant.

Edhe njëherë, kanë qenë disa gjëra, që unë desha t'i theksoj edhe më herët, por edhe u thanë më herët edhe gjatë raportimit të Avokatit të Popullit dhe besoj që Avokati i Popullit s'ka pasur edhe mundësi më shumë të raportojë, ngase nga të gjitha këto probleme të cilat janë paraqitur në raport, unë dua të theksoj edhe çështjen e Ligjit për Avokatin e Popullit, ku faktikisht neve na është dhënë edhe si Komision edhe si Kuvend një afat ekstra i shkurtër, duke dhënë pretekstin e liberalizimit të vizave që ka qenë tri vjet i paraparë dhe pastaj, kur vjen momenti, neve na kërkohet në dy javë që të veprojmë për ligje shumë të rëndësishme dhe në atë aspekt ka kaluar, fatkeqësisht, muajin e kaluar Ligji për Avokatin e Popullit, por, ai ligj ka mbetur me shumë mangësi, të cilat nuk janë adresuar në ligj, sidomos nuk janë adresuar çështjet e pavarësisë funksionale të institucionit të Avokatit të Popullit dhe të punëtorëve që punojnë në këtë institucion, të cilat po ashtu kanë qenë edhe çështje të ngritura nga Komisioni Evropian. Pra këtu

faktikisht, bie edhe... është konstatuar edhe në raport, që Kuvendi i Republikës së Kosovës, si zakonisht, nuk i ka shqyrtuar rekomandimet e Avokatit të Popullit për miratimin e ligjeve dhe ndryshimin e ligjeve që ndikojnë në të drejtat e njeriut. Edhe në këtë rast, ne faktikisht edhe nuk i kemi marrë parasysh edhe rekomandimet e Avokatit të Popullit për institucionin e Avokatit të Popullit dhe këtu desha vetëm ta sjell këtë vërejtje edhe njëherë para deputetëve dhe para qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Jasmina Zhivković, në emër të Listës serbe, e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovani kolege,

Ja bih imala jednu primedbu. Zapravo, Institucija Narodnog Advokata je vrlo važna institucija u bilo kom društvenom uređenju i u bilo kom društvu.

Institucija Narodnog Advokata bi trebala da bude uzor ili model za sve ostale institucije u jednom društvenom uređenju. Nažalost, ono što je absurd vezano za Instituciju Narodnog Advokata sada jeste da je Institucija Narodnog Advokata bez srpskog predstavnika već više od godinu dana. Srpski predstavnik je udaljen iz institucije i zabranjen mu je pristup i rad u instituciju već više od godinu dana.

Blago rečeno samim tim je jedan deo stanovništva, zapravo srpski narod koji živi na Kosovu, uskraćen da ima pravo zastupanja svojih interesa iz zaštite ljudskih i osnovnih prava zagarantovanih Ustavom i zakonima Kosova. Iz tog razloga poslanici Srpske Liste neće podržati ovaj izveštaj Narodnog Advokata. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Salihe Mustafa!

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit e kemi shqyrtuar edhe në Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Pagjetur ku kemi vërejtur se është një raport voluminoz dhe se disa nga çështjet e adresuara në raport janë ende të pazgjidhura edhe përkundër vullnetit të gjithë aktorëve relevantë shtetëror.

Në këtë raport janë të paraqitura disa shqetësime e që do t'i veçoja shkeljen e Ligjit të punës apo moszbatimin në tërësi të këtij ligji.

Ne si Kuvend e kemi monitoruar ligjin në fjalë dhe kemi nxjerr rekomandime, dhe një ndër rekomandimet ka qenë plotësim-ndryshimi i Ligjit dhe tani ky ligj është në agjendën legislative për plotësim-ndryshim.

Sipas raportit të Avokatit të Popullit, në vitin 2014 ka pasur 2 224 ankesa prej tyre 587 ankesa janë hapur hetimet, ndërsa 1 637 ankesa janë të papranueshme nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit. Numri i ankesave të papranueshme dhe atyre që janë shqyrtuar tregon nevojën për më shumë fushatë sensibilizuese nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë që qytetarët të jenë më shumë të informuar për kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit, ashtu që ky

institucion në vend që të humbë kohë dhe energji në klasifikim të ankesave, do të merret me shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe zgjedhjen e tyre.

Ky ishte një propozim konkret i imi, që ka qenë edhe në Komision, por edhe tash po e ceku sepse duhet një fushatë sensibilizuese më e madhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Nuk e di, besoj, ndoshta nga lodhja pse në këtë pikë të rendit të ditës u shmang nga Rregullorja. Zakonisht raporton Komisioni funksional dhe Komisioni për Buxhet e Financa, por nuk na u dha fjala deri në fund.

Me këtë rast unë falënderoj zotin Kurteshi për punën dhe angazhimin e tij të çmuar për mandatin e tij, por sot realisht ne po diskutojmë për raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014.

Andaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, referojmë. Institucioni i Avokatit të Popullit ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2014.

Sipas të dhënave të kërkuara, raporti pasqyron të dhëna për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitin paraprak.

Buxheti fillestar i ndarë për institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2014 ka qenë 1 095 610 euro, ndërsa pas ndryshimeve që janë bërë si rezultat i vendimeve të Qeverisë për shkurtimin e buxhetit në mallra dhe shërbime në shumën prej 68 885,85 euro dhe shpenzime komunale në shumën prej 4.500 euro.

Buxheti përfundimtar ka qenë 1 092 574 euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 819 206,45 euro apo në përqindje 80,14%.

Komisioni për Buxhet e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2015, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014, vlerësoi se raporti i përmbush obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

E di që për shkak të lodhjes na intereson më shumë ngutja ndoshta se disa gjëra tjera, por nuk mund pa reaguari në fjalën e kolegut Haskuka, i cili gjatë plotësimit-ndryshimit të Ligjit për Avokatin tha që i kemi lëshuar gjërat. E di që ngutja ka bërë që ndoshta diçka të na ikën, por dua t'ju njoftoj të gjithë juve se ai ka qenë përgjegjës i grupit punues pikërisht për këtë ligj.

Këtë e ka bërë Komisioni nga interesimet e tij të vullnetshme që të punojë në ligj dhe nga interesimet e Komisionit për Legjislacion, që e udhëheq partia e tij e që, siç e patë nga fjala e Avokatit të Popullit, u tha se është për t'u lavdëruar komunikimi i Avokatit me Komisionin për Legjislacion.

Unë mendoj se këto raporte të mira kanë mbetur, qoftë nga e kaluara, për shkak se ligjin më herë e ka nxjerr ky Komision, qoftë nga simpatitë politike në këtë drejtim.

Nëse është kjo, është çështje tjetër, por vërtet e ftoj kolegun që të jetë korrekt në këtë punë se nuk e di, ose le ta thotë këtu se cilin amendament ia kemi refuzuar ne, si përbërje dhe mendoj se Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka qenë shumë kooperues me Avokatin edhe pse na ka munguar një dëgjim publik, Avokatin e kemi pasur tërë kohën prezent gjatë plotësimit-ndryshimit e ligjit. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Haskuka.

MYTAHER HASKUKA: Unë nuk thashë në aspektin e Komisionit, por thashë neve për një javë, faktikisht atë javë kemi pasur vetëm 4 ditë pune, i kemi pasur 3 ligje dhe faktikisht nën pretekstin e liberalizmit të vizave po na kërkohen shumë ligje të rëndësishme të kalojnë shpejt dhe faktikisht ato ligje kanë qenë dhe para 3 viteve dhe është ditur çka është dashur të bëhet për liberalizime dhe pastaj për 3 ditë të kërkohet ajo që s'është bërë për 3 vjet.

Do të thotë kritika ime ka qenë në aspektin e asaj se si po na vijnë ligjet dhe se si nuk po respektohen ato.

Unë kam qenë përgjegjës aty, por unë e kam pasur vetëm një votë dhe në do aspekte, do të thotë, për amendamente s'kam mund me një votë t'i kalojë të gjitha kërkesat e amendamenteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Shumë mirë! Ju të dytë e mbrojtët, dhe s'po ju marr vesh pse po replikoni njëri me tjetrin. Nuk ka tjerë të paraqitur. Atëherë në sallë janë 51 veta. I kemi edhe 3 raporte, a po i kalojmë? Unë mendoj se do të ishte më mirë që t'i kalojmë pasi që jemi këtu më shpejt dhe i votojmë pastaj kur të kemi kuorum, në seancën e ardhshme. Apo, ta mbyllim seancën dhe t'i bartim për seancë tjetër këto 3 pika të rendit të ditës. Pra, janë dy mundësi.

Nëse doni, vazhdojmë edhe nesër, por unë qysh po e shoh atmosferën, është zor të mblidhemi e të votojmë prapë.

Propozimi im është të vazhdojmë me këto 3 pika dhe të votohen në seancën e ardhshme. A jeni dakord?

12. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014

Komisioni funksional për Legjislacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar raportin e punës të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, zonja Haxhiu. S'është këtu. Kush e do fjalën në vend të zonjës Haxhiu? Zonja Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, duke vepruar në pajtim me nenin 72 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015 e shqyrtoi raportin e punës së Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim.

Të miratohet Raporti i punës së Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Osmani. Nuk është këtu. Kush e do fjalën? Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Agjencia Kosovare e Pronës e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2014 brenda afatit ligjor.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar për AKP-në për vitin 2014, të dhëna për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, si dhe krahasime me vitin paraprak.

Raporti po ashtu përmban të dhëna për të hyrat e realizuara si dhe donacionet për vitin 2014.

Buxheti fillestar për Agjencinë Kosovare të Pronës për vitin 2014 ka qenë 1 782 000 euro, ndërkaq, AKP-ja me pëlqim të Ministrisë së Financave ka bërë transfer të mjeteve nga kategoria për shpenzime kapitale në kategorinë për mallra dhe shërbime në vlerë prej 14 000 euro dhe 9 450 euro në kategorinë shpenzime komunale, kurse në kategorinë për paga dhe mëditje, me vendim të Qeverisë është rritur buxheti për 25%.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti përfundimtar për këtë agjenci ka qenë 1 748 856 euro, ndërsa janë shpenzuar 1 690 324 euro, apo 96,65%.

AKP ka pranuar edhe donacionin në shumën prej 1 325 658 euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 15.4.2015, pasi shqyrtimit të raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2014, vlerësoi se raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar, zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014 dhe si të tillë do ta mbështesë.

Raporti është i hartuar mirë sa i përket aspektit përmbajtjesor dhe teknik- statistikor. Në bazë të asaj që është paraqitur në këtë raport kjo Agjenci gjatë vitit raportues vërehet se ka pasur angazhime të ndjeshme në realizmin e detyrave të punës, mirëpo siç shihet dhe dihet është përballur me disa sfida dhe vështirësi të natyrave të ndryshme, siç janë mos kompletimi i bordit mbikëqyrës, mos emërimi i drejtorit, funksionimi i Agjencisë me ushtrues detyre të zëvendës drejtorit për një kohë të gjatë, vështirësitë financiare, e tjera.

Grupi ynë Parlamentar i fton institucionet përkatëse që në një periudhë sa më të shpejtë kohore të plotësohen këto pozita të zbrazëta si dhe njëherë inkurajon stafin e Agjencisë për angazhim edhe më të madh të tyre në realizmin e detyrave të parapara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ademaj e ka fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegët.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe mendojmë se kjo Agjenci ka pasur vështirësi edhe gjatë vitit raportues edhe më herët, e sidomos gjatë vitit 2014 për shkak të mungesës së stafit udhëheqës, të them, dorëheqjeve që atje janë paraqitur dhe problemeve tjera, si dhe vetë natyra e punës së kësaj Agjencie është mjaft e rëndë.

Edhe pse raporti është gjithëpërfshirës, domethënë kalon vitin 2014, përfshin edhe vite tjera të mëhershme, ndoshta përfshin edhe Drejtorinë për Çështje Pronësore atje prej vitit 1999 kur është themeluar së pari, dhe probleme tjera, por si do që të jetë Grupi Parlamentar e përkrah këtë raport të punës dhe sigurisht që edhe do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sa herë që në Kuvend diskutohen dhe trajtohen raportet dhe vlerësimi i punëve të këtyre agjencive të pavarura, është i pamundshëm anashkalimi i kritikës retrospektive të saj.

Edhe pse ne sot shqyrtojmë një raport nga AKP-ja për vitin 2014, rezultatet e paraqitura në këtë raport janë vetëm fragmenti kohor i një vazhdimësie që shënon ky mekanizëm.

Është fatkeqësi që edhe pse kanë kaluar 16 vjet nga përfundimi i luftës, ne ende jemi duke i diskutuar reliket strukturore dhe institucionale të misionit ndërkombëtar të quajtur UNMIK.

AKP-ja, përndryshe, është vazhdim i punës së pjesshme që kishte bërë paraardhësja e saj, Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banësore, që udhëhiqej nga agjencia e specializuar e OKB-së, e quajtur HABITAT.

Ajo është e themeluar si Agjenci e Pavarur me Rregulloren e UNMIK-ut të vitit 2006/10, me qëllim të zgjidhjes së kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë këtu edhe pronën bujqësore dhe komerciale e që këto kërkesa kanë të bëjnë me periudhën në mes të shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999, si pasojë e të ashtuquajturit konflikt të armatosur.

Deri më tani AKP-ja faktikisht më shumë ka shërbyer si ndërmjetësim i pazarllëqeve në mes të pjesëtarëve të etnive të ndryshme lidhur me çështje pronësore dhe transaksione të tyre.

Pra AKP, duke u paraqitur si një mekanizëm shtesë jashtë sistemit gjyqësor në parim ka binarizuar sistemin tonë juridik duke u thirrur në efikasitetin lidhur me çështjet pronësore që ndërlidhen me konfliktin e armatosur siç e njeh kjo Agjenci luftën në Kosovë.

Ky mekanizëm që tani përbën pjesën e veçuar të tërësisë institucionale të Republikës së Kosovës, nuk është tjetër veç se shprehja dhe mendësia e UNMIK-ut gjatë fazës së pavarësisë së mbikëqyrur me ç'rast bëhet përjashtimi i standardit të përgjithshëm ku çështjet e caktuara trajtohen në mënyrë partikulare nga të tjerat.

Sidoqoftë, sa i përket përmbajtjes së raportit vjetor të AKP-së vlen të theksohet se edhe ky raport nuk dallon nga raportet që nga agjencitë e tilla rëndom sillen në Kuvendin e Kosovës.

Nëse shikohet strukturalist, 1/3 e këtij raporti përbëhet nga përshkrimi i njëjtë për çdo vit lidhur me informatat e përgjithshme mbi AKP-në, ndërkaq, edhe pse kjo Agjenci është themeluar me qëllim të zgjidhjes së efektshme dhe efçente të çështjeve pronësore, kjo Agjenci tani e 10 vite përkundër asaj që pranimi i kërkesave ka skaduar në dhjetor të vitit 2007, gjithsej numëron 42 749 kërkesa pronësore. Dhe tani pasi kanë kaluar më shumë se 7 vjet nga përfundimi i afatit për pranimin e kërkesave, ky numër i kërkesave është ende evident.

Sa i përket efektshmërisë së organeve të AKP-së vlen të theksohet se raporti nuk ofron të dhëna të qarta pa i mbuluar ato me frazeologji dhe formalitete të cilat jo domosdoshmërisht do të duhej të futeshin në një dokument të tillë.

Sipas raportit Komisioni për kërkesa pronësore të Kosovës ka vendosur për këtë periudhë për gjithsej 2 577 kërkesa. Pra, sipas këtij trendi, mekanizmi i quajtur AKP do t'i duhej së paku edhe për 20 vite të ardhshme që t'i shqyrtojë të gjitha lëndët.

Sipas raportimit që nga viti 2012, çështjet pronësore të përmbarduara deri më tani janë 2.228 çështje që tani edhe janë evidentuar dhe regjistruar në libra kadastrale.

Po ashtu, AKP-ja është e autorizuar që të vendosë pronat nën administrimin e saj të përkohshëm. Programi i administrimit nga AKP-ja përfshin disa aktivitete që mund t'i ndërmerr AKP sa i përket kompetencave të marra lidhur me administrimin e pronës. Kjo përfshin administrimin e pronës, skemën e qiradhënies vullnetare dhe aktivitetet e debimit.

Sigurisht që shembullin e gatshëm e kemi te rasti i Mitrovicës së veriut. Në raport janë futur të dhënat lidhur me dhënien në administrim të pronës nga AKP-ja për pjesën më të ndjeshme të Kosovës, ku si pasojë e dhunës sistematike që nga lufta dhe pas përfundimit të saj janë dëbuar mijëra shqiptarë, banorë të veriut të Mitrovicës.

Raporti thekson se janë 301 dëbime në pritje, 27 për riposedit, 3 për uzurpim të paligjshëm, 136 për mospagesë të qirasë dhe 135 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qiratë.

Pikërisht është shembulli i Mitrovicës që vërteton se kjo Agjenci nuk është duke e bërë punën në mënyrë të drejtë dhe të paanshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Trendi i përmbarimit tregon më së miri se kjo qasje nuk paraqet fare efikasitet në aspektin e ushtrimit të së drejtës në pronë.

Andaj, meqë ky raport nuk paraqet asgjë tjetër vetëm se një sekuencë nga vazhdueshmëria e AKP-së, nuk duhet të votohet si i vlerësuar në cilësinë e një dokumenti publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim.

Kalojmë në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës, dhe edhe këtë raport e lëmë për votim në seancën e ardhshme.

Para se të fillojë seanca, besoj që do të kemi kuorum.

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014

Komisioni funksional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për shqyrtim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional, zoti Muhamet Mustafa, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka zhvilluar një debat të gjerë rreth këtij raporti, duke e konsideruar veprimtarinë e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale, si shumë të rëndësishme, ne kemi parë se raporti ka prezantuar aktivitetet në detaje, mirëpo disa çështje nuk kanë qenë aq mirë të përfshira dhe kemi kërkuar sqarime të cilat janë dorëzuar dhe i keni edhe ju këtu.

Me këto sqarime, raporti është përmirësuar dukshëm, megjithatë rekomandimet mbesin dhe unë ju propozoj që këto rekomandime të aprovohen bashkë me raportin për arsye se Komisioni i ka përkrahur njëzëri.

Problemi kryesor ka të bëjë me faktin që duhet të ndërmerren masa për certifikimin e rezervave të minierave dhe mineraleve në Kosovë. Ne kemi krijuar një katalog, por ende mungon certifikimi dhe kjo është përgjegjësi e Ministrisë dhe Ministria duhet të jetë aktive në këtë drejtim.

Gjithashtu, gjatë debatit ne kemi vërejtur se përfaqësuesit e këtij Komisioni, edhe anëtarët e bordit, edhe drejtori ekzekutiv, janë shprehur diqysh të pafuqishëm që të ndërprejnë shfrytëzimin ilegal të rërës, deri diku të thëngjillit, të gurëve. Domethënë, shteti dështon që të bëjë të pamundur që uzurpatorët të shfrytëzojnë në mënyrë të paligjshme këto resurse dhe ata thonë- ne u japim vërejtje dhe gjithçka vazhdon. Kjo ka qenë një shqetësim i madh dhe ne kërkojmë që edhe KPM-ja, por edhe organet tjera të tregojnë forcën e shtetit se ligji duhet të zbatohet, nuk mund dikush ta marrë ligjin në dorë dhe t'i keqpërdorë burimet natyrore të Kosovës.

Një çështje tjetër, po ashtu si shqetësim, ka qenë Shpella e Gadimes, e cila po rrezikohet. Sipas disa diskutimeve, është rrezikuar seriozisht, sipas disave jo, dhe ne kemi kërkuar urgjent një komision ndërministror bashkë me KPM-në që të konstatojë gjendjen e kësaj shpelle dhe të marrë masa që një bukuri e tillë natyrore të mos rrezikohet më tutje.

Edhe një çështje që është interesant, dhe duhet ta di Kuvendi, domethënë një ligj është sjellë që një pjesë e stafit të kalojë prej KPM-së në Ministrinë e Zhvillimit dhe gjithçka vazhdon sikur ka mbetur, prandaj një nga rekomandimet është që edhe kjo çështje duhet të kryhet.

Pra, këto kanë qenë rekomandimet dhe unë ju ftoj që bashkë me rekomandimet të aprovohet ky raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa nuk është. Zonja Gaxherri e ka fjalën, në emër të Komisionit.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2014 brenda afatit ligjor.

Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në vitin 2014 i janë ndarë 1 835 064 euro nga Buxheti i Kosovës, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë në shumën prej 1 758 600 euro. Ky ndryshim përfshin rritjen e pagave, sipas vendimit të Qeverisë prej 25% dhe zvogëlimin e buxhetit për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale prej 15%.

Nga buxheti i ndarë KPMM-së, KPMM-ja ka shpenzuar 1 552 998 euro, apo 88,3%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, pasi shqyrtoi raportin vjetor financiar të Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014, vlerësoi se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka menaxhuar mirë shpenzimet.

Megjithatë, vërejtjet e ngrehura nga komisioni kanë të bëjnë me procesin e inkasimit të të hyrave dhe monitorimit të kompanive të licencuara nga KPMM për hulumtim apo shfrytëzim të minierave në Republikën e Kosovës.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në vitin 2014 ka realizuar të hyra në shumë prej 26,9 milionë euro, apo 93% e planit.

Të hyrat sipas mineraleve apo nga tantiemat janë inkasuar 26,5 milionë euro.

Kompanitë më të mëdha kanë paguar të hyra si në vijim: KEK-u ka paguar rreth 21,9 milionë euro, Ferronikeli 2,2 milionë euro, ndërsa “Trepça” ka paguar vetëm 66 619 euro dhe ka mbetur borxh 4,8 milionë euro.

Detyrimet e kompanive ndaj Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale janë rritur krahasuar me vitet e kaluara dhe në total janë 15 320 167,67 euro borxh, apo nga 25 milionë euro të faturuara janë paguar vetëm 10 milionë euro, pra borxh.

Ajo që është shqetësuese nga të dhënat e prezantuara në raport është rasti i shqiptimit të gjobave administrative prej 501 000,92 euro ndaj 85 kompanive ilegale, e që në fakt është detyrim i KPMM-së, që në bashkëpunim me policinë është dashur të ndalonte veprimtarinë e këtyre kompanive ilegale dhe të konfiskonte mjetet.

Pastaj, problemi shumë i madh me numrin e kompanive të licencuara si gurëthyes prej 190, që përveç detyrimeve financiare të pa paguara po shkatërrojnë në vazhdimësi mjedisin e vendit nga gërmimet që i bëjnë pa kriterë dhe pa mbikëqyrje.

Duke pasur parasysh të gjitha këto vërejtje dhe shqetësime të ngritura, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit për shqyrtimin e raportit financiar dhe Kuvendin e fton që të vendosë në bazë të raportimit për miratim apo mosmiratim të këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës!

Përshëndetje kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në mbledhjen e rregullt e ka shqyrtuar raportin, përkatësisht dy raportet e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014.

Normal se ka marrë informacione përmes anëtarëve të Komisionit funksional dhe realisht e mbështet në tërësi këtë raport me rekomandime dhe vërejtje të cilat janë dhënë. Mendojmë se është shumë me rëndësi, meqë është një institucion i pavarur, i cili i përgjigjet Kuvendit dhe do të duhej që ne përmes vërejtjeve, sugjerimeve e propozimeve t’ua lehtësojmë atyre punën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Atë që desha të them, e tha profesor Muhameti. Vërtet që duhet të vazhdohet me punët hulumtuese dhe në forma të ndryshme, qoftë nga mjetet vetjake apo të krijohet fond i veçantë dhe të krijohet harta e pasurive në Kosovë edhe në aspektin kuantitativ.

Pastaj, tek përkujdesja dhe jo vetëm tek shpella, por në përgjithësi të bukurive të natyrës, trashëgimitë e natyrës duhet të kihet parasysh dhe edhe ato arkitektonike si dhe të kihet një kujdes shumë më rigoroz në raport me shfrytëzimet ilegale.

Ajo pse unë u lajmërova për fjalë, posaçërisht motivi kryesor ishte se është e padrejtë që renta minerare merret vetëm në nivel nacional dhe komunave nuk u jepet asgjë. Komunave u mbetet vetëm shkatërrimi, pra të gjithë ajo ndotja akustike, ndotja në pluhur dhe të gjitha ato veprime që ndodhin bëhet shfrytëzimi, edhe pse më herët ka qenë më mirë e rregulluar që 50% ka mbetur në nivelin lokal që ai komunitet aty për të përfituar diçka, jo vetëm shpërthimet, zhurmat, pluhurin, shkatërrimet në ambient dhe mandej kur po përfundojnë punët po mbesin gërmadhat, prandaj Komisioni ishte dashur që nga fillimi të ndalë një sasi, pra në kuadër të rentës, të qirasë, ta ndalë nga një sasi të mjeteve të cilat në fund do të ishin shfrytëzuar detyrimisht për të sanuar gjendjen që pas shfrytëzimit po mbetet sikur gërmadha dhe po rrezikohen jetërat e njerëzve, domethënë çfarë edhe kemi dëgjuar kohëve të fundit.

Prandaj, unë mendoj se urgjentisht duhet të amendmentohet ligji dhe që komunat të jenë bile 50% përfituese nga e gjithë kjo punë, sidomos te gurthyesi, po pse jo edhe nëpër miniera, ndërsa, edhe unë jam për ata që ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Për sa i përket raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ne e kemi diskutuar këtë edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, me një raportim të shkurtër të anëtarëve të bordit të këtij Komisioni. Aty ka qenë një situatë, natyrisht pak sa e pazakontë meqenëse anëtarët e bordit që raportonin, shumica prej tyre ishin anëtarë të zgjedhur rishtazi, pra raportonin për një punë njëvjeçare të një institucioni bordi i të cilit tashmë nuk ishte në vend, por sido qoftë edhe nga raporti edhe nga raportimi vërehen disa gjëra shqetësuese për sa i përket funksionimit të këtij Komisioni dhe përgjegjësi që ai i ka me ligj për ta mbikëqyrur sektorin e minierave dhe mineraleve në përgjithësi në Kosovë, veçanërisht në raport me operatorët ilegalë. Shihet aty në raportin për vitin 2014 që përkundër një trendi pozitiv të reduktimit të operatorëve ilegalë në këtë sektor në Kosovë, gjatë vitit 2014 e kemi një ngritje të ndjeshme të raporteve ose të operatorëve ilegalë që janë shfaqur në këtë sektor në Kosovë, gjë që do të duhej që të sanohej nga Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale.

Në anën tjetër, edhe anëtarët e bordit e thamë, por edhe e kanë raportuar në raportin për vitin 2014, që puna e tyre vështirësohet në këtë drejtim, veçanërisht për shkak të mungesës së mbështetjes nga institucionet tjera përgjegjëse për këtë çështje. Pra duke u nisur nga policia dhe institucionet tjera, e veçanërisht kur vjen puna te Agjencia për makinerinë e sekuestruar që KPMM-ja është e varur nga kjo Agjenci për të marrë, ta zëmë makinerinë, që këta e sekuestrojnë për ta dërguar në vendin ku ajo duhet mbajtur dhe pastaj për ta trajtuar sipas ligjit. Pra, kjo është një prej pengesave, veçanërisht kur kemi të bëjmë me gurthyesit, me përdoruesit ilegalë të rërës,

zhavorrit dhe të tjerave, gjë që bazohet në një makineri të rëndë, qoftë të maunave apo makinerisë tjetër që duhet sekuestruar dhe për të cilën Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk e ka mundësinë që ta organizojë as bartjen e kësaj makinerie e lëre më të merret me të.

Në këtë drejtim, do t'i kisha bërë ftesë edhe institucioneve tjera që natyrisht konform me ligjin të jenë mbështetës të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale, kur vjen puna te masat preventive dhe masat parandaluese, ose ndaluese, më falni, të zhvillimit të aktiviteteve ilegale për sa i përket kësaj çështjeje, gjë që natyrisht të gjithë e dimë ka shkaktuar një dëm të dyfishtë për Republikën e Kosovës dhe dëm në të ardhura financiare, po në anën tjetër edhe dëm në mjedis, sepse kryesisht kanë qenë operatorët ilegale ata që e kanë dëmtuar shumë rënd mjedisin në Kosovë, me shfrytëzimin e resurseve minerale që i ka Kosova.

Në anën tjetër, një pyetje që ia kam shtruar atëherë Komisionit për Miniera e Minerale, gjë që nuk është se kam marrë përgjigje të kënaqshme, është edhe raporti në mes të aktivitetit legal dhe ilegal përbrenda një kompanie të caktuar. Pra, aktiviteti ilegal i shfrytëzimit të mineraleve në Kosovë nuk është vetëm duke u bërë nga operatorët të cilët nuk janë të regjistruar dhe licencuar fare, por ndodh shpesh edhe te operatorët të cilët janë të licencuar, të cilët shfrytëzojnë më shumë resurse se sa që i raportojnë. Pra, shfrytëzojnë më shumë gurë të Kosovës, ta zëmë, për ta shndërruar atë në zhavorr dhe raportojnë më pak, dhe në këtë mënyrë mendoj se edhe ky shfrytëzim ilegal i resurseve të Kosovës duhet domosdoshmërisht të ndalet dhe kjo bëhet natyrisht me shtimin e numrit të inspeksioneve që duhet t'i bëjë Komisioni për Miniera e Minerale edhe te këta operatorë dhe për ta ndalur këtë e për ta sanuar këtë gjendje që mendoj po e dëmton jashtëzakonisht shumë pra në aspektin ekonomik edhe në aspektin mjedisor Republikën e Kosovës.

Si përfundim, ne do ta votojmë raportin e Komisionit për Miniera e Minerale, por duhet që si Kuvend, edhe këtë e kemi diskutuar edhe në Komision, të insistojmë që institucionet tjera të jenë shumë më përkrahëse ndaj kërkesave të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në mënyrë që edhe efektiviteti i tyre i punës në raport me operatorët ilegale të shtohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Prapë po vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë dhe të fundit. Edhe për pikën paraprake, mbetet si pikat tjera që s'patën kuorum të votohen më vonë, respektivisht në seancën e ardhshme.

14. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka trajtuar çështjet je kontesteve biznesore dhe adresimin e tyre në gjykata dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimet për miratim në seancë plenare.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotin Muhamet Mustafa, për arsyetimin e rekomandimeve.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Kjo çështje është adresuar në bazë të planit të punës të Komisionit dhe në bashkëpunim me Komisionin për Legjislacion.

Arsyeja pse jemi marrë me këtë çështje me vetë iniciativë, është fakti se kontestet biznesore zgjasin shumë me vite dhe kjo është një nga çështjet më problematike sa i përket investitorëve vendorë dhe të jashtëm – mbrojtja e kontratave.

Në arsyetimin e këtyre rekomandimeve ju shihni se Kosova, do të thotë, gjendet shumë ulët në mbrojtjen dhe ekzekutimin e kontratave dhe adresimin e këtyre kontratave me gjyq në gjykata dhe është në vendin 138 prej 189 shteteve në botë dhe derisa është kështu ne mund të bëjmë apele, mund të dëshirojmë investime, por investitorët seriozë të investimeve në Kosovë nuk do të ketë.

Duke e marrë parasysh këtë gjendje, ne kemi zhvilluar një aktivitet bashkërisht me Komisionin për Legjislacion, bashkërisht me asociacionet e biznesit dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili në njëfarë mënyre pak ka qenë hezitant, por është përfshirë disi në këtë aktivitet dhe kemi konstatuar se situata është e tillë për shkak, midis të tjerash, se në këto çështje në Kosovë në shkallën e parë merren vetëm 3 gjykatës. Dhe si pasojë e kësaj, numri i këtyre rasteve është rritur prej 203 sa kanë qenë në vitin 2008, në 885 në vitin 2014 dhe ky trend i rritjes vazhdon. Pra, është e çuditshme ne kërkojmë investitorë dhe në tjetrën anën numri i gjyqtarëve që punojnë me këto raste në vend që të rriten zvogëlohen.

Gjithashtu kemi parë se në Kosovë, në përgjithësi numri i gjykatësve në 100 mijë banorë është ndër më të voglit, por të mos thënë më i vogli, 18,5 në krahasim me Bosnjën 25 dhe krejt vendet, Maqedonia i ka 34, Sllovenia 47 gjykatës, ne i kemi 18 në 100 mijë banorë, dhe ne po kërkojmë që këta të jenë supermenë dhe t'i kryejnë punët. Kjo nuk është reale. Ne duhet t'i krijojmë kushtet, t'i dimë normativet sa lëndë duhet t'i kryejë një gjykatës dhe duhet të kërkojmë përgjegjësi prej tyre.

Më duket se edhe ministri i Drejtësisë e ka parë nga pak se sistemi gjyqësor nga pak po trajtohet krejtësisht i shkëputur dhe nuk është i detyruar t'i japë llogari kurrkujt. Më duket se me ato ndryshimet ne që i kemi paraparë sistemi gjyqësor duhet të kërkojë kushte, por një llogaridhënie duhet ta japë diku, në fund të fundit, në këtë Parlament apo diku tjetër për situatën që e kemi për këtë.

Si pasojë e kësaj ne i kemi dhënë rekomandimet që i keni këtu. Fatkeqësisht kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe kishte pasur nevojë që ne të debatojmë shumë seriozisht për këtë çështje, por e kemi lënë si pikë të fundit dhe të lodhur duhet ta kalojmë formalisht dhe sa për ta kaluar formalisht ne s'kemi pasur nevojë t'i bëjmë këto rekomandime hiq, mirëpo shpresoj që këto do të shkojnë tek aktorët të cilëve u janë dedikuar e destinuar dhe ne do ta përcjellim realizimin e tyre. Pra, prej këtyre masave ne kërkojmë që aktorët kryesor, por Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjëse që këto konteste që zgjasin tash me vite t'i bie deri në 6 muaj maksimalisht. Njerëzit e bizneseve nuk mund të presin me vite për t'u trajtuar problemet dhe zbatimi i kontratave.

Për ta bërë këtë, duhet të rritur ndjeshëm numri i gjyqtarëve dhe gjithashtu në pajtim me përvojat e avancuara gjyqtarëve duhet t'u ndihmojnë edhe bashkëpunëtorë profesional, të cilët do t'u ndihmojnë t'i trajtojnë lëndët më shpejt dhe gjykatësit në fund shikojnë bazën ligjore dhe marrin masat e duhura.

Një nga vërejtjet gjithashtu ka qenë që ndodh për një problem të njëjtë, të kësaj natyre, të kemi vendime të gjykatësve të ndryshme, prandaj është kërkuar që të botohet Buletini i rasteve ekonomike, në mënyrë që të shihet kjo pse këta gjykatës të njëjtin problem, me të njëjtat ligje, e vendosin me kritere të ndryshme dhe kute të ndryshme.

Për të mos mbetur këto sende krejt në letër, Komisioni ka propozuar që për 6 muaj ne të shohim çka po ndryshon në këtë drejtim dhe dy komisionet bashkërisht t'i raportojnë Kuvendit. Kolegu Rexhepi e përmendi këtu se në rend të parë ne me këtë konkluzën e pikës 5 duhet të bëjmë riformulim që të obligohet edhe Këshilli Gjyqësor e jo vetëm dy komisionet. Kaq, u mundova t' i bie shkurt, edhe pse këtu është problemi shumë i rëndë dhe shumë aktual për Kosovën.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Mustafa! Unë besoj që ka nevojë për debat në ndonjë seancë të veçantë për këtë punë. Zoti Reçica e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti Haliti dhe të përgëzoj vërtet për qëndrueshmërinë dhe faktikisht këmbëngulësinë që t'i përfundosh të gjitha pikat për sonte. Sinqerisht po them, se je shembull kështu për punë dhe angazhim. Vërtet, nuk ishim të gjithë ne të vazhdojmë, por meqë këmbënguli nënkryetari, u bë mirë që së paku po i përfundojmë.

Grupi Parlamentar i PDK-së realisht i ka shqyrtuar këto 5 rekomandime, të cilat kanë dalë nga puna e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata.

Ne e dimë se edhe programi qeverisës ose qeveritar, po edhe angazhimet e kohëve të fundit janë që të forcohen bizneset dhe t'u lehtësohet puna, dhe një nga format e mira të lehtësimit të punës të bizneseve është edhe kjo, që kontestet e tyre nëpër gjykata të zgjidhen sa më shpejt.

Është e vërtet që ka ndoshta prej krejt sektorit të gjykatave mungesë më e madhe ndjehet pikërisht në këto kontestet edhe të bizneseve edhe të çështjeve civile. Mirëpo, këto 5 rekomandime besoj janë fuqimisht në drejtimin e duhur dhe normal që unë dakordohem, por edhe Grupi Parlamentar, që këto rekomandime t'i kontrollojmë herë pas herë po edhe s'është larg mendsh që të organizojmë edhe ndonjë debat, pasi të marrin konkretisht ato format e veprimt dhe format e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Meqë ne jemi shumë të vetëdijshëm që shteti nuk mund të krijojë vende të reja të punës, po mund të krijojë bizneset, atëherë së paku bizneset mos ta kenë edhe një pengesë shtesë, siç janë kontestet gjyqësore.

Pra, duke u bazuar në këto dhe pa dashtë ta zgjas, ne të gjithë angazhohemi t'i mbështesim, atëherë jam pro asaj dhe jemi shumë fuqishëm të angazhuar në këtë çështje. Faleminderit zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rexhepi, kurse Visari u paraqit tash pas tij.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues!

Unë i përkrah rekomandimet e Komisionit, por arsyeja që e mora fjalën është kjo që e potencoj profesori pak më herët për Kryesinë e Kuvendit, për shefat e grupeve parlamentare që sinjorizoj kur ta bëjnë rendin e ditës pak të vlerësojnë peshën e pikave për të cilat duhet të zhvillohet debati, sepse unë besoj që çdo lider i partisë këtu apo kryeministër, apo kushdo nga deputetët, sa herë që kemi dal në foltore kemi thënë se prioriteti është si ta krijojmë një ambient për zhvillimin ekonomik, e nëse diçka e tregon dhe e cila është barrierë e madhe në zhvillimin të vendit është kjo temë që tani askush nuk e dëgjon dhe kujto që i referohemi sonte, besoj se është tepër vonë.

Prandaj, arsyeja që e mora fjalën, edhe një herë po them janë sugjerimet dhe vërejtjet për Kryesinë dhe jo për t'i mësuar çka me bë, por realisht është më mirë që temat që e kanë këtë peshë të madhe të trajtohen në kohën e duhur dhe sigurisht mesazhi kishte me qenë shumë më i fortë dhe debati shumë më i frytshëm në interesin e asaj për të cilën krejt janë të betuar këtu, po sigurisht nuk po i përmbahemi si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jam dakord me vërejtjen. Zoti Ymeri, e keni fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket rekomandimeve që janë propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe ai për Legjislacion, këto rekomandime natyrisht që synim kryesor e kanë një lloj funksionalizmi dhe përshpejtimi kisha për të thënë të trajtimit të çështjeve që lidhen drejtpërsëdrejti me biznesin nga gjyqësori i Kosovës, që natyrisht është një prej problemeve që është paraqitur vazhdimisht edhe në raporte të ndryshme që janë bërë për këtë çështje, por edhe në ankesat që i kanë në një numër të bizneseve karshi kësaj çështjeje.

Natyrisht se këto rekomandime janë të përqendruara në këtë fushë, pra me idenë e përshpejtimin të trajtimit të këtyre çështjeve dhe i lënë anash pastaj edhe shumë çështje tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejt me këtë raport që e ka biznesi me gjyqësorin në përgjithësi. Nuk po them se këto janë të parëndësishme dhe nuk po them se janë të këqija, natyrisht se janë shumë të rëndësishme si rekomandime, por po që se zbatohen besoj se do ta përfundonim këtë çështje, por ne si Kuvend, jam plotësisht në dakord që e thatë ju më herët që duhet ta trajtojmë këtë problematikë me shumë dimensionalitetin e saj.

Pra, nuk mendoj që kjo problematikë duhet të përfundojë me këtë trajtim dhe nuk mendoj se duhet të mbyllet në dy komisione të Kuvendit, por realisht do të duhej të ishte çështje që shtrihet në një seancë plenare dhe diskutohet pra nga deputetët për atë se çka do të duhej të prisnim ne nga gjyqësori në përgjithësi, nga ekzekutivi po edhe nga legjislativi në këtë rast në mënyrë që ky dimension i ekonomik i gjyqësorit të zgjidhet njëherë e përgjithmonë. Ne e dimë që një problem të madh e kemi këtu për sa i përket ta zëmë raportit që gjyqësori ynë e ka me pronën dhe për çdo ditë dëgjojmë lajme se si gjykatës të veçantë ose hetohen ose arrestohen po edhe dënohen për keqpërdorim prone, falsifikim dokumentesh, shndërrim të pronës publike në private e kështu me radhë e nganjëherë edhe si të them falsifikim të dokumenteve për pronën private duke e bartur atë të një tjetër.

Pra, të gjitha këto mendoj unë bien në këtë dimension për të cilin po diskutojmë dhe e tregojnë një situatë jashtëzakonisht të rëndësishme në të cilën gjendemi ne sot si qytetarë në Republikën e

Kosovës dhe në të cilën kërkohet një intervenim, kisha me thënë rrënjësor në mënyrë që të drejtat e qytetarëve karshi të pronës të tyre, qofshin ata pra si pronarë biznesesh apo vetëm persona privatë, që të sigurohet dhe të mbrohet nga gjyqësori.

Përndryshe, me një situatë të tillë natyrisht se jo vetëm bizneset, por as qytetarët e Republikës së Kosovës nuk mund të ndihen të sigurt në realizimin e të drejtave që ata i kanë karshi pronës dhe në mundësinë që ta përdorin atë pronë për mirëqenien e tyre dhe për zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Pra, Lëvizja “Vetëvendosje” do t’i votojë këto rekomandime dhe kërkojmë që këto rekomandime të trajtohen nga organet përkatëse me seriozitetin që do të duhej të trajtoheshin, sepse po qe se këto rekomandime bëhen pjesë e një vargu të rekomandimeve që i ka nxjerrë ky Kuvend e të cilat nuk janë zbatuar kurrë, atëherë mund të them që e kemi shpenzuar këtë kohë që nuk është shumë e gjatë, pra 25 minuta, kot për të diskutuar për to. Ndërkohë, me këto besoj se do të ndodhte ose do ta përmirësonim sadopak gjendjen në Gjyqësorin e Kosovës për t’i hapur rrugë një rritje dhe një pune më efikase të këtij gjyqësori karshi këtyre çështjeve që po i diskutojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka tjerë që diskutojnë. E përfundojmë seancën e sotme. Votimin e lëmë për seancën e ardhshme, në fillim të seancës, varësisht kur krijohet kuorumi. Faleminderit për durimin! Mirupafshim!

* * *

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 18 qershor
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

Jemi në vazhdimin e seancës plenare, e filluar më 18 qershor. Në sallë janë të pranishëm, në bazë të pranisë elektronike, 85 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Edhe fizikisht jemi 85 veta, tani me Albinin u bëmë 86.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se për tetë pikat në vijim diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 18 qershor 2015, por në mungesë të kuorumit nuk janë proceduar për votim. Andaj, në seancën e sotme procedojmë vetëm me votim.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Kërkoj falje! E kemi një deputet tonin që ka mbajtur shumë vjet burg dhe e kanë dëmtuar në të dëgjuar. Ta kemi parasysh Raifin, për arsye jam duke e pyetur nëse po dëgjohej? Raif, a është mirë? Aktivizoj mikrofonin, se nuk është turp. Aktivizoj!

RAIF QELA: Zoti kryetar i Kuvendit, fjala juaj po dëgjohej dobët, afrojeni mikrofonin, ju lutem! Faleminderit!

KRYETARI: Unë mendova se mos po dëgjohej shumë, e po ju pengoj. Kërkoj falje!

Atëherë, vazhdojmë me votim.

1. Votimi i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Janë 85 vota, 62 janë për, 19 kundër, 4 abstenime, prandaj Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

2. Votimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Procedojmë me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 85 vota të hedhura. 72 janë për, 11 kundër, 2 abstenime. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Votimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Procedojmë me votimin e raportit me rekomandime të Komisionit për Legjislacion. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 88 vota. 88 janë për. Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

4. Votimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014

Procedojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 85 vota. 67 janë për, 11 abstenime, 7 kundër. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014.

5. Votimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014

Procedojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 81 vota, nga të cilat 44 janë kundër, 34 janë për dhe 3 abstenime. Konstatojmë se Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të punës së Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014.

6. Votimi i raportit të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014

Procedojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 82 vota. 58 për, 13 kundër, 11 abstenime. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014.

7. Votimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014

Procedojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014 bashkë me rekomandimet e Komisionit Funksional.

Regjia dhe deputetët përgatitemi për votim. Votojmë tash!

I kemi 81 vota të hedhura. 44 janë për, 25 janë kundër, 12 abstenime. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të punës për vitin 2014 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale bashkë me rekomandimet e Komisionit Funksional.

8. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata

Procedojmë me votimin e rekomandimeve të Komisionit Funksional. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

I kemi 85 vota të hedhura. 81 për, 3 abstenime, 1 kundër. Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me kontestet biznesore dhe adresimin e tyre në gjykata.

Mirupafshim në seancën e rregullt!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*